



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:  
“Marrëdhënie Ndërkombëtare”  
Kolegji Universitar “I Biznesit”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Rudina MITA**

**Prof.Asoc. Elda ZOTAJ**

**Shtator / 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Bachelor në "Marrëdhënie Ndërkombëtare"**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "I Biznesit"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Marrëdhënie Ndërkombëtare"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR nr. 254, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë i Studimeve
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022: 6 PAE / 3 PAK 2022-2023: 12 PAE / 3 PAK 2023-2024: 15 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	21-22: 4 studentë; 22-23: 8 studentë; 23-24: 1 student;
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Kolegji Universitar "I Biznesit" ka marrë akreditimin institucional përfshirë edhe akreditimin e programeve të studimit nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në fund të vitit 2021.

Programi i studimit Bachelor në "Marrëdhënie Ndërkombëtare" është hapur për herë të parë në vitin akademik 2021-2022. Ky program studimi i përket fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike dhe ofrohet nga Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Programi Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare ka 180 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite/ 6 semestra. Programi i studimit Bachelor në "Marrëdhënie Ndërkombëtare", është ofruar në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 418 datë 10.05.2017 "Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkëpunimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", me Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë".

Urdhëri i MAS Nr. 254, datë 19.07.2021 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë të "Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare" në KUB shënoi dhe hapjen e këtij programi studimi. Ky urdhër është bazuar në propozimin e Dekanatit të FDSHP më datë 01.09.2020, në Vendimin e Dekanit të FDSHP, Vendimin e Senatit Akademik të KUB-it dhe Vendimin e Bordit të Administrimit

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga ekspertet **Prof.Dr. Rudina Mita** dhe **Prof.Asoc.dr. Elda Zotaj**. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Koordinatorja teknike e ASCAL Alma Arapi.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në institucion të zhvilluar në datat **1 dhe 2 Shkurt 2024** sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL. Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të mirë Bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, si edhe ofron sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të politologëve të rinj.

## RELACION

**Përgatiti: Prof.Dr. Rudina Mita; Prof.Asoc.Dr. Elda Zotaj**

**GVJ, pasi shqyrtoi me kujdes komentet e IAL-së, evidenton si më poshtë vijon: Më datë 25.07.2024 , përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.14/4 Prot., datë 25.07.2024 , dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 16.08.2024, dhe me shkresë zyrtare Nr. 350 Prot., datë 14.08.2024, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.**

**GVJ, pasi shqyrtoi me kujdes komentet e IAL-së, evidenton si më poshtë:**

### **Fusha 2, Standardi II.1, Kriteri 3 dhe konkluzionet.**

#### **Komenti i IAL-së:**

Në lidhje me Fushën 2, Standardi II.1, Kriteri 3 dhe konkluzionet e GVJ ku sugjerohet që: *“institucioni në vijim të konsiderojë që në kurrikulën e këtij programi studimi, Kategoria C - Lëndë ndërdisiplinore/integruese të plotësohet me 2 kredite. Ky sugjerim mbështetet në faktin e përputhshmërisë së plotë me bazën ligjore në fuqi”*. E vlerësojmë maksimalisht këtë sugjerim dhe do ta mbajmë në konsideratë padiskutim qysh në vitin e ardhshëm akademik, por ju sjellim në vëmendje që ky program studimi është licensuar me këtë kurrikulë dhe plan mësimor me Urdhër të MAS Nr. 254, datë 19.07.2021, dhe akreditohet për herë të parë. Ndaj referuar legjislacionit të arsimit të lartë në vend, institucioni, mund të ndërhyjë në kurrikul vetëm pasi të jetë kryer me sukses procesi i akreditimit për herë të parë i këtij programi studimi. Në përfundim të procesit, ky sugjerim do të meret në konsideratë me seriozitet pasi edhe në rregulloren e programit të studimit Neni 26 *Rishikimi i programit*, parashikohen modalitetet se si dhe kur zhvillohet ky proces.

**Përgjigja e GVJ-së:** GVJ, e ka të qartë faktin që ky program akreditohet për herë të parë dhe se programi është licensuar me këtë kurrikul dhe plan mësimor me Urdhër të MAS nr.254, datë 19.04.2021. Pavarësisht këtij elementi, pasaktësia në shpërndarjen e pikëve të krediteve duhet konsideruar, ndaj sugjerimi i bërë nga GVJ qëndron. GVJ vlerëson se institucioni ti marri në konsideratë pas akreditimit të programit dhe brenda hapësirës së ndryshimeve ligjore që mundëson ligji në masën 20%.

### **Fusha 3, Standardi III.3, Kriteri 5.**



#### **Komenti i IAL-së:**

Në lidhje me Fushën 3, Standardi III.3, Kriteri 5, ku GVJ ka konstatuar se: Për përgatitjen e temave të diplomave, zbatohet udhëzuesi për punimin e diplomës, me të gjitha kerkesat, kriteret dhe standardet e caktuara nga institucioni (ju falënderojmë për këtë konstatim). Më tej GVJ shprehet se: *“Institucioni nuk ka ndonjë program elektronik anti-plagjaturë për të evidentuar dhe garantuar origjinalitetin e punimeve. GVJ sygjeron që në të ardhmen institucioni të planifikojë marrjen e një programi elektronik anti-plagjaturë”*. Ju bëjmë me dije se, të gjithë studentët e diplomuar për herë të parë në këtë program studimi në vitin akademik 2023-2024, kanë zgjedhur të diplomohen referuar edhe rregullores së programit të studimit Nenit 19 *Procedura për punimin e mbrojtjen e diplomës*, pra janë diplomuar duke iu nënshtruar provimit të përgjithshëm të formimit. Ndërkaq institucioni dhe stafi akademik momentalisht për të evidentuar dhe garantuar origjinalitetin e punimeve i'u referohet këtyre website-ve: [www.grammarly.com](http://www.grammarly.com) plagiarism-checker dhe [/plagiarismdetector.net](http://plagiarismdetector.net). Ju bëjmë me dije se KUB do të vlerësojë çdo sugjerim në drejtim të rritjes së origjinalitetit të punimeve të diplomave dhe kërkimit shkencor në IAL.

**Përgjigja e GVJ-së:** GVJ, referuar dhe argumentimit të bërë nga institucioni vleron se pjesa *“Institucioni nuk ka ndonjë program elektronik anti-plagjaturë për të evidentuar dhe garantuar origjinalitetin e punimeve. GVJ sugjeron që në të ardhmen institucioni të planifikojë marrjen e një programi elektronik anti-plagjaturë”*, duhet hequr.

#### **Fusha 4, Standardi IV.2, Kriteri 2.**

#### **Komenti i IAL-së:**

Në lidhje me Fushën 4, Standardi IV.2, Kriteri 2, ku GVJ ka sugjeruar se: *“Nga ana e DMN dhe stafit akademik të tij dhe, më konkretisht, të programit të studimit BMN, nga ana e GVJ sugjerohet një shfrytëzim sa më efikas i mjeteve me bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, në kryerjen më së miri të aktiviteteve mësimore, por dhe atyre me natyrë praktike”*, ju ftojmë të merni në konsideratë faktin ashtu si ju vetë jeni shprehur se institucioni ynë disponon 2 laboratorë informatike të dedikuar për programet e studimi, në FDSHP, si dhe për këtë program studimi. Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve. Studentët kanë akses në internet pa limit dhe në çdo moment mund të lidhen on-line, apo me faqe të ndryshme që mundësojnë qasje të nevojshme për realizimin e detyrave individuale apo projekteve. Ju risjellim në vëmendje dokumentat dhe link si më poshtë:

\*Dok. 49. *Marreveshje bashkëpunimi dhe regjistrimin në Platformën GRADUA*

\*Dok. 52. *Udhëzues institucional për zhvillimin dhe përdorimin e “GOOGLE APPS”, portali KUB*

\*Dok. 53. *Rregullore “Për procedurën e mësimdhënies online, në kushte situatë të jashtëzakonshme dhe fatkeqësie natyrore”*

\*Dok. 90. *Marrëveshje bashkëpunimi JSTOR/e-biblioteka*

\*Dok. 96. *Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom\_KUB*

Link 19: <https://kub.edu.al/kampusi-yne/#labororet-e-informatikes>

Link 20: <https://www.jstor.org/>

Link 21: <https://www.academia.edu/>  
Link 22: <https://www.Gstore.com>  
Link 23: <http://www.ebrary.com/corp/>  
Link 24: <https://www.ebsco.com/public-libraries>  
Link 25: <https://www.thefreelibrary.com/>  
Link 26: <https://www.gutenberg.org/>  
Link 27: <https://www.acm.org/>  
Link 28: <https://al.cobiss.net/>  
Link 29: <http://www.readprint.com>  
Link 30: <https://www.dlib.si/?&language=eng>  
Link 31: <https://catalog.freelibrary.org/Record/254538>  
Link 32: <https://www.bksh.al/search/EKONOMIK>  
Link 33: <https://kub.edu.al/libraria/>  
Link 38: [www.kub.edu.al](http://www.kub.edu.al)

**Përgjigja e GVJ-së:** “Nga ana e DMN dhe stafit akademik të tij dhe, më konkretisht, të programit të studimit BMN, nga ana e GVJ sugjerohet **një shfrytëzim sa më efikas i mjeteve me bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për kryerjen më së miri të aktiviteteve mësimore, por dhe atyre me natyrë praktike.**” Sugjerimi i dhënë nga ana e GVJ-së është veçanërisht i dhënë për studentët e programit të studimit BMN, pas takimit me studentë të këtij programi, por nuk lidhet me infrastrukturën e vënë në dispozicion të studentëve, por efikasitetin me të cilin studentët e shfrytëzojnë këtë infrastrukturë në funksion të procesit mësimor dhe për plotësimin e detyrave të ngarkuara në realizimin e disiplinave të ndryshme.


#### **Fusha 4, Standardi IV.2, Kriteri 3.**

##### **Komenti i IAL-së:**

Në lidhje me Fushën 4, Standardi IV.2, Kriteri 3, ku GVJ ka rekomanduar se: “*Departamenti duhet të vijojë me vendosjen e programeve të caktuara për të ndikuar në cilësinë e mësimdhënies dhe ndërveprimin online në grupet e punës e hulumtimit online*”, e vlerësojmë rekomandimin tuaj dhe ju ftojmë ti referoheni argumentit të paraqitur nga institucioni në pikën më sipër (Ref.argumentit Fusha 4, Standardi 4.2, Kriteri 2).

**Përgjigja e GVJ-së:** “*Departamenti duhet të vijojë me vendosjen e programeve të caktuara të programeve mësimore për të ndikuar në cilësinë e mësimdhënies dhe ndërveprimin online në grupet e punës e hulumtimit online.*” Nëpërmjet këtij sugjerimi nga ana e GVJ-së nuk anashkalohen përpjekjet e bëra nga ana e IAL-së, por në të ardhmen për Departamentin MN që mbulon programin e studimit BMN si sugjerim përcaktohet që të punohet për vendosjen e programeve të caktuara në funksion të këtij disiplinave që përcakton në planin mësimor ky program studimi për efikasitetin e shfrytëzimit të tyre dhe cilësinë e mësimdhënies.

#### **Fusha 4, Standardi IV.2, Kriteri 4.**



### **Komenti i IAL-së:**

Në lidhje me Fushën 4, Standardi IV.2, Kriteri 4, ku GVJ ka rekomanduar se: “Mbështetur në strategjinë e KUB dhe të FDSHP e më konkretisht të DMN, në laboratorin ekzistues duhet të instalohen dhe programet profesionale sipas natyrës së programit të studimit. Është e kuptueshme që në këtë socal8 në kuadër të ndërkombëtarizimit si pjesë e strategjisë së KUB, duhet të hidhen hapa konkretë sidomos në këtë program studimi, I cili I përshtatet kërkesave dhe tregut të punës në nivel socal e më gjerë.”, e vlerësojmë rekomandimin tuaj dhe ju ftojmë ti referoheni argumentit të paraqitur nga institucioni në pikën më sipër (Ref.argumentit Fusha 4, Standardi 4.2, Kriteri 2 si dhe link: <https://kub.edu.al/events/staff-training-in-internationalization-of-the-home-curriculum-current-trends-in-the-context-of-quality-education-from-invited-staff-from-ljubjana-school-of-business/>)

**Përgjigja e GVJ-së:** “Mbështetur në strategjinë e KUB dhe të FDSHP e më konkretisht të DMN, në laboratorin ekzistues duhet të instalohen dhe programet profesionale sipas natyrës së programit të studimit.

### **Fusha 5, Standardi V.4, Kriteri 1.**

#### **Komenti i IAL-së:**

Në lidhje me Fushën 5, Standardi V.4, Kriteri 1, ku GVJ ka rekomanduar se: “Shoh me vend të rekomandoj angazhimin më të madh dhe fushatë më efektive orientuese të stafit akademik të DMN dhe institucionit KUB në lidhje me rritjen përpjekjeve mbi përthithjen e një numri më të madh studentësh që duan të ndjekin këtë program studimi. Këtë e bazoj në faktin se prioriteti i politikave qeveritare në kuadrin e kthimit të vendit tonë në një destinacion turistik shton dhe numrin e kërkesave për specialistë të afirmuar të historisë. Rol të rëndësishëm në arritjen dhe garantimin e suksesshëm të punës në këtë program studimit luan dhe bashkërendimi dhe bashkëpunimi mes universitetesh”, ju falënderojmë maksimalisht për rekomandimin dhe ju bëjmë me dije se i tërë stafi akademik i KUB përfshihet në fushatat e marketimit, përfshirë edhe stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi si psh: pjesëmarrja në panairin work&study. Ju ftojmë të merni në konsideratë:

\*Dok. 110. Program i panairit Work and Study

Link 40: <http://kub.edu.al/panairi-work-study-3/>

Marim angazhimin që tashmë që paraqitet në formën e një rekomandimi prej jush, ne do ta paraqesim me seriozitet para stafit akademik të angazhuar në programin e studimit “Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare” dhe do të na shërbejë ky rekomandim si një nxitje për stafin që të rrisin edhe më tepër përpjekjet për rritjen e numrit të studentëve të angazhuar në këtë program studimi. Përsa i përket marrëveshjeve të bashkëpunimit mes universitetesh ju ftojmë të merni në konsideratë faktin që institucioni ynë e ka konsideruar qysh në themelimin dhe do të vazhdojë ta konsiderojë bashkëpunimin me IAL partnere si një nga pikat më të forta në drejtim të ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor dhe programeve të studimit. Ju ftojmë të merni në konsideratë:

\*Dok. 22. Raport i Përfuturshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara në kuadër të projekteve

\*Dok. 24. Marrëveshje bashkëpunimi KUB-UAMD

\*Dok. 34. Punimi i një studenti nga IAL partnere në Konferencën Studentore

\*Dok. 36. Marrëveshjet me Universitete për diplomat e dyfishta, Webster University, USA

\*Dok. 37. Marrëveshje bashkëpunimi me Alcide de Gasperi University, Poloni.

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



- \*Dok. 76. Raport i planifikimit të zhvillimit të aktiviteve të KUB nga Marrëveshjet Erasmus +  
\*Dok. 77. Raport mbi aktivitetet e zhvilluara me stafin dhe studentët në KUB dhe me përfaqësues të IAL-të partnere në kuadër të veprimtarisë Erasmus+]  
\*Dok 116. Tabela 20 - Të dhëna për Bashkëpunimin Kombëtar dhe Ndërkombëtar të Fakultetit

**Përgjigja e GVJ-së:** “Shohim me vend të rekomandojmë angazhimin më të madh dhe fushatë më efektive orientuese të stafit akademik të DMN dhe institucionit KUB në lidhje me rritjen përpjekjeve mbi përthithjen e një numri më të madh studentësh që duan të ndjekin këtë program studimit. Këtë e bazoj në faktin se prioriteti i politikave qeveritare në kuadrin e kthimit të vendit tonë në një destinacion turistik shton dhe numrin e kërkesave për specialist të afirmuar të historisë. Rol të rëndësishëm në arritjen dhe garantimin e suksesshëm të punës në këtë program studimit luan dhe bashkërendimi dhe bashkëpunimi mes universitetesh në vend.”

#### **Fusha 5, Standardi V.4, Kriteri 5.**

##### **Komenti i IAL-së:**

Në lidhje me Fushën 5, Standardi V.4, Kriteri 5, ku GVJ ka sugjeruar se: “Në funksion të raporteve analitike mund të hartohen edhe analiza të tjera, p. sh., analiza e tregut të punës, etj. Përmes të dhënave të pasqyruara në raportet analitike kryhet dhe vlerësimi i performancës dhe identifikimi i nevojave, në funksion të përmirësimit të punës dhe arritjeve në drejtim të realizimit të objektivave formues të programit të studimit. Kontaktet e vazhdueshme të Departamentit të DSHP dhe Zyrës e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës me studentët e diplomuar mundësojnë përpilimin e tabelave me të dhëna mbi cilësinë e punësimit”, ju ftojmë të merni në konsideratë se institucioni ka hartuar një studim tregu (analizë të tregut të punës) në lidhje me këtë program studimi. Ref. dokumentacionit si më poshtë:

- \*Dok. 32. 11. Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit  
\*Dok. 42. Raporti vjetor i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës  
\*Dok. 44. Studim Tregu për programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”  
\*Dok.116. Tabela 23-Të dhëna për Diplomimin dhe Punësimin e Studentëve (në këtë vit akademik kemi të diplomuar brezin e parë në këtë program studimi).

**Përgjigja e GVJ-së:** “Në funksion të raporteve analitike mund të hartohen edhe analiza të tjera, p. sh., analiza e tregut të punës, etj. Përmes të dhënave të pasqyruara në raportet analitike kryhet dhe vlerësimi i performancës dhe identifikimi i nevojave, në funksion të përmirësimit të punës dhe arritjeve në drejtim të realizimit të objektivave formues të programit të studimit. Kontaktet e vazhdueshme të Departamentit të DSHP dhe Zyrës e studentit dhe Këshillimit të Karrierës me studentët e diplomuar mundësojnë përpilimin e tabelave me të dhëna mbi cilësinë e punësimit, pavarësisht se është një program i ri studimi.” Në lidhje me këtë sugjerim sqarojmë se që në hapje të programit të studimit BMN, departamenti ka hartuar një studim të tregut të punës për hapjen e tij, plotësisht dakord, por studimi i kryer duhet shtrirë për çdo vit akademik në lidhje me vazhdimësinë e tij.

#### **Fusha 5, Standardi V.5, Kriteri 1-4.**

##### **Komenti i IAL-së:**



Në lidhje me Fushën 5, Standardi V.5, Kriteret nga 1-4, ku GVJ ka vlerësuar të gjitha kriteret pozitivisht dhe të përmbushura, në shkallën e përmbushjes së standardit (përmbledhësen) e ka vendosur *pjesërisht*. Ju ftojme me mirëkuptim ta rimerni në konsideratë.

**Përgjigja e GVJ-së:** U reflektua nga ana jonë, duke u vlerësuar përmbushur plotësisht

#### **Fusha 6, Standardi VI.5, Kriteri 4.**

##### **Komenti i IAL-së:**

Në lidhje me Fushën 6, Standardi VI.V, Kriteri 4, ku GVJ ka rekomanduar se: *“Duhet bërë më shumë përpjekje për mbështetjen e kërkimit shkencor për studentët përmes organizimit të konferencave studentore, workshop, start-up etj”*, e vlerësojmë maksimalisht dhe do ta zbatojmë me shumë seriozitet. Ndërkaq ju ftojme të merni në konsideratë faktin se tashmë studentët janë një “zë” i rëndësishëm në jetën institucionale dhe akademike të KUB dhe organizimi i rregullt i konferencave studentore, trajnimeve, work-shop-eve, leksioneve të hapura, pjesëmarrja në trajnime për start-up-et (realizuar nga Agjencia Shtetërore Startup Albania, GIZ etj), apo angazhimi i studentëve si bashkëautorë në konferencat shkencore ndërkombëtare që IAL realizon; tashmë janë një traditë për të cilën jemi krenarë. Ju ftojme tu referoheni dokumentave apo link-ve si më poshtë:

\*Dok. 33. Program i Konferencës Shkencore Studentore

\*Dok. 34. Punimi i një studenti nga IAL partnere në Konferencën Studentore

\*Dok. 50. Plani vjetor i veprimtarive, KUB

\*Dok. 77. Raport mbi aktivitetet e zhvilluara me stafin dhe studentët në KUB dhe me përfaqësues të IAL-të partnere në kuadër të veprimtarisë Erasmus+

-Link 9: <http://kub.edu.al/?s=Leksione%20te%20hapura>

-Link 49: <http://kub.edu.al/?s=Leksione%20te%20hapura>

-Link 55: <https://kub.edu.al/events/zgjedhjet-per-keshillin-studentor-ne-kub/>

-Link 56: <https://kub.edu.al/events/takimi-i-qeverise-studentore/>

-<https://kub.edu.al/lajme/program-startup-tirana-inc/>

-[https://www.linkedin.com/posts/universitetiibiznesit\\_p%C3%ABrfaq%C3%ABsues-nga-agjencia-shtet%C3%ABrore-startup-activity-7175584691729666049-N-UW](https://www.linkedin.com/posts/universitetiibiznesit_p%C3%ABrfaq%C3%ABsues-nga-agjencia-shtet%C3%ABrore-startup-activity-7175584691729666049-N-UW)

-Etj..

**Përgjigja e GVJ-së:** *“Duhet bërë më shumë përpjekje për mbështetjen e kërkimit shkencor për studentët përmes organizimit të konferencave studentore, workshop, start-up etj.” “Duhet bërë më shumë përpjekje nga ana e DMN për përfshirjen e studentëve të programit të studimit BMN, në konferencat studentore, workshopet, si dhe start-up-et që organizohen nga KUB-i etj.”* E theksojmë këtë fakt pasi nga takimi me studentët nuk na rezultoi që në këtë program studimi të kishte studentë pjesëmarrës me punime shkencore në konferencën studentore që organizon KUB-i. Më konkretisht sa studentë të këtij programi studimi kanë marrë pjesë në konferencat studentore gjatë viteve akademike 2021-2024?

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Prof.dr. Rudina Mita

Prof.as.dr. Elda Zotaj

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-13123

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” i ofruar nga Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Politike pjesë e “Kolegjit Universitar i Biznesit” (KUB) është në përmbushje të interesave dhe objektivave strategjike të vendit. Më konkretisht në nenin nr. 4 (pika a) të <i>Statutit të KUB</i> përcaktohet si mision “formimi i specialistëve të lartë dhe shkenctarëve të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standarteve të demokracisë në vend. Në Planin Strategjik të Zhvillimit 2021-2026 përcaktohet se vizioni i KUB është: “ të konsolidojë profilin e tij në tregun e Arsimit të Lartë, si një institucion i Arsimit të lartë që konkuron në këtë treg përmes vlerave që ofron, me standarde të mirë përcaktuara akademike dhe identitetin e një stafi të dalluar në fushën e arsimit dhe shkencës, kryesisht në fushat e ekonomisë, jurisprudencës, shkencave politike, marrëdhënieve ndërkombëtare, në ato profesionale, etj.” Ky vizion kontribuon me arritjen e interesave kombëtare për të kontribuar në ngritjen e kapitalit human në vend përmes përgatitjes së specialistëve dhe ekspertëve në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare si vlerë për administratën publike dhe më gjerë.  <i>(Dok Nr. 2, Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026, fq.4)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit. Programi synon t’ju japë studentëve njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si specialistë në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Referuar objektivave specifik të programit të studimit theksohet formimi multidimensional teorik dhe profesional i studentëve bazuar në njohuritë bashkëkohore dhe praktikat e mira në fushë.

	<i>(Dok Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënieve Ndërkombëtare, fq.2)</i>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Ky program është hartuar në zbatim të akteve që rregullojnë institucionin dhe në përputhje me strategjinë e institucionit (Statutin, Rregulloren e institucionit, njësisë kryesore dhe asaj bazë, etj). Ai është në përputhje me misionin e fushën e veprimtarisë së KUB për të përgatitur specialistë dhe shkencëtarë të rinj. Njësia kryesore që ofron këtë program studimi është: Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike dhe njësia bazë Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ky është një program i cili është hartuar për studentë dhe profesionistë të dëshirojnë të ndjekin studimet bachelor në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Emërtimi, struktura dhe organizimi i programit të studimit bazohet mbi fushat e drejtimit akademik dhe të kërkim zhvillimit të KUB. Në hartimin e programit të ciklit të parë të studimit bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, synohet të formohen studentët me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale nëpërmjet mësimdhënies, aftësimit për përdorimin e arritjeve më të mira të teorisë, praktikës dhe shkencës në lëmin e marrëdhënieve ndërkombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike, përbëhet nga tre departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</li> <li>2. Departamenti i Drejtësisë;</li> <li>3. Departamenti i Shkencave Politike;</li> </ol> <p>Fakulteti dhe njësia bazë në të cilën bën pjesë programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” ka burimet e nevojshme njerëzore, të cilët janë të përfshirë në procesin e realizimit të tij. Në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për vitin akademik <b>2021-2022</b>, <b>Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare</b> në përbërje të tij kishte 7 anëtarë si pjesë e stafit akademik efektiv dhe 4 anëtarë me kohë të pjesëshme. Përsa i përket titujve dhe gradave janë si vijon: 5 (pesë) anëtar me gradën Doktor Shkencash dhe 2 (dy) anëtar me gradën Master Shkencor (në një proces doktorature). Stafit me kohë të pjesëshme përbëhet nga 2 (dy) anëtarë nga kategoria Proesor; 1 (një) me gradën Doktor Shkencash dhe 1 (një) anëtar me gradën Master Shkencor.</li> <li>• Për vitin akademik <b>2022-2023</b>, <b>Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare</b> kishte në përbërje të tij</li> </ul>

	<p>7 anëtarë si pjesë e stafit akademik efektiv dhe 3 anëtar me kohë të pjesëshme. Përsa i përket titujve dhe gradave të stafit akademik efektiv që përbën departamentin janë si vijon: 2 (dy) anëtar të stafit nga kategoria Proesor; 3 (tre) anëtar me gradën Doktor Shkencash dhe 2 (dy) anëtar me gradën Master Shkencor. Stafi me kohë të pjesëshme përbëhet nga 2 (dy) anëtar të stafit me gradën Doktor Shkencash dhe 1 (një) anëtar me gradën Master Shkencor.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për vitin akademik <b>2023-2024 Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare</b> në përbërje të tij ka 7 anëtarë si pjesë e stafit akademik efektiv dhe 3 anëtar me kohë të pjesëshme. Përsa i përket titujve dhe gradave të stafit akademik efektiv që përbën departamentin janë si vijon: 1 (një) anëtar i stafit me titullin Prof.Asoc; 4 (katër) anëtar me gradën Doktor Shkencash dhe 2 (dy) anëtar me gradën Master Shkencor. Stafi me kohë të pjesëshme përbëhet nga 3 (tre) anëtar të stafit me gradën Doktor Shkencash.</li> </ul> <p>Institucioni dëshmon se ka përvojë, kapacitete dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e këtij programi studimi.</p> <p><b><i>Dok Nr.84 Lista e Pedagogëve në KUB për Vitin Akademik 2022-2023, fq.1-2; Dok Nr.116. 2 Lista e Personelit Akademik për Njesisë Bazë, TitujtGradat</i></b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është program i ciklit të parë me 180 kredite i cili realizohet në tre vite akademike, i klasifikuar me Nr. 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij program studimi është Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe është plotësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë dhe asaj kryesore.</p> <p><b><i>(Dok. Nr. 7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënieve Ndërkombëtare)</i></b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë që ofron programin e studimit përmbush plotësisht kriteret e vlerësimit dhe synon ruajtjen e interesave kombëtare, akteve ligjore dhe nënligjore, etj. Në dokumentat ligjore institucionale janë të shprehura qartë</i></p>





	<i>misioni dhe vizioni i institucionit për programe studimi bashkëkohore dhe zhvillimore.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Kolegji Universitar “I Biznesit” në dokumentet strategjike të tij si Statut, Rregullore në nivel institucional, njësie kryesore dhe asaj bazë, ka të përcaktuara qartë strukturat institucionale me karakter akademik dhe administrativ për realizimin e aktiviteteve në përputhje me qëllimet e tij. Institucioni sigurohet që programi i studimit të realizohet nga një staf akademik të kualifikuar si në drejtimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, sikundër dhe staf administrativ apo institucional në mbështetje të programit. Në rregulloren e njësisë kryesore (neni 4; 5; 6 7; 8 etj) dhe atë të njësisë bazë, janë përcaktuar qartë detyrat dhe detyrimet e secilit funksion (<i>Dok. Nr. 5. Rregullore e Njësisë Kryesore FDSHP; Dok. Nr. 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare</i>).</p> <p>Departamenti merr masat që personeli akademik me kohë të plotë (PAE) dhe ai me kohë të pjesshme (PAK) të realizojnë orët mësimore sipas planit mësimor akademik, personeli ndihmës administrativ të jetë në shërbim të vazhdueshëm duke krijuar kushte shumë të mira me qëllim realizimin e programit mësimor dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej tij. Njësi të tilla si: sekretaria, arkiva, shërbimi i informacionit në zyrat e ndryshme, janë në shërbim me kohë të plotë në mënyrë funksionale në realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Çdo strukturë/njësi përgjegjëse ndjek dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programit të studimit dhe informon drejtuesit përkatës.</p> <p><i>(Dok. Nr.20 Organigrama e Kolegjit Universitar “I Biznesit” &amp; Vendimi i Senatit Akademi)</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>KUB në dokumentin e titulluar “Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026” ka si pjesë përbërëse edhe strategjinë e ndërkombëtarizimit të institucionit. Më konkretisht në pikën 6 të këtij dokumenti trajtohen elementët e ndërkombëtarizimit si dhe synimi për të vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit.</p> <p><i>(Dok. Nr.2 Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026, fq.31-34)</i></p> <p>Në funksion të realizimit të programit të studimit, institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda vendit. Institucioni ka rreth 182 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të një spektri të gjërë. Këto marrëveshje janë lidhur për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta, për zhvillimin e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar, bashkëpunim me aktorët e biznesit dhe më gjërë.</p> <p><i>(Dok. Nr.21 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Dokumentet themelore të Kolegjit (Statuti, Rregullorja e Kolegjit dhe Plani Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026) përcaktojnë synimet kryesore dhe objektivat që i korrespondojnë edhe ndërveprimet me institucione, kompani të fushave përkatëse dhe institutive kërkimore për realizimin e praktikave profesionale apo praktikave të punës. Plani Strategjik 2021-2026 <i>(Dok. Nr.2 pika 6.1)</i> përcakton rritjen e numrit të partneriteteve ndërkombëtare me universitete, ambasada, organizata etj si qëllime kryesore të institucionit. Këto partneritete krijojnë mundësi për kontakte dhe bashkëpunim me institucione të ndryshme duke afruar më pranë studentët me punëdhënësit e mundshëm. Në kuadër të realizimit të objektivave të programit të studimit për kryerjen e praktikave profesionale nga studentët institucioni bazohet në një procedurë të miratuar nga Senati Akademik i titulluar “Udhëzuesi i Praktikës Profesionale”. Në varësi të specifikës së programit të studimit këto praktika realizohen në institucione të ndryshme.</p> <p><i>(Dok. Nr.27 Udhëzues për Përgatitjen Praktikës Profesionale).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte</p>	<p>Strukturat e institucionit realizojnë në disa nivele raporte ku përfshihet dhe komponenti i marrëveshjeve të bashkëpunimit. Në nivel institucional, hartohet çdo vit një raport vjetor ku analizohet ecuria dhe përfitueshmërinë edhe nga marrëveshjet</p>

<p>analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>e bashkëpunimit që institucioni ka në funksion të realizimit të programeve të studimi. Më konkretisht në dokumentin “Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022” jepet informacion mbi bashkëpunimin ndërinstitucional dhe pjesëmarrja në projekte <i>(Dok. Nr.28 fq.13-15)</i>.</p> <p>Njësia kryesore gjithashtu realizon raport analitik mbi analizën vjetore të punës së fakultetit. Më konkretisht në rubrikën “Bashkëpunimin ndërinstitucional dhe pjesëmarrja në projekte”, trajton në nivel njësie kryesore arritjet në këtë drejtim. Përgjatë vitit akademik 2022-2023 janë nënshkruar 21 marrëveshje të disa formave. <i>(Dok Nr. 30 Raporti vjetor i veprimtarive FDSHP, Viti Akademik 2022-2023, fq 21-25)</i></p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, harton në mënyrë të rregullt raporte vlerësuese dhe faktike mbi të dhënat e vitit akademik për zhvillimin e programit mësimor, punën e stafit akademik, studentëve dhe aktivitetëve të tjera.</p> <p><i>(Dok. 30. Raporti vjetor i veprimtarive FDSHP, Viti Akademik 2022-2023)</i></p>
--	---

<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni përmes kuadrit ligjor dhe strukturave akademike dhe administrative të tij garanton që programi i studimit të realizohet në përmbushje të plotë të tij. Institucioni ka nënshkruar rreth 182 marrëveshje bashkëpunimi. Ai harton çdo vit një raport vjetor ku analizohet ecuria dhe përfitueshmërinë nga marrëveshjet e bashkëpunimi në funksion të realizimit të programeve të studimi. Pë sa më sipër, KUB siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani e palë të treta, në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i></p>
---------------------------	--

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi bachelor në “Mërrëdhënie Ndërkombëtare”, është i organizuar sipas sistemit Evropian të Transferimit të Kreditit (ECTS) në total 180 ECTS ku. Programi ofrohet në kurse të ndara në tre vite akademike (çdo vit akademik ka 60 kredite) bazuar në plotësimin e nevojave të studentëve që ndjekin këtë program dhe natyrës së lëndëve. Gjatë vitit të parë dhe të dytë akademik studenti realizon 11 lëndë, ndërsa në vitin e tretë 8 lëndë plus praktikën dhe diplomën. Ky program studimi zhvillohet në gjuhën shqipe.</p> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënieve Ndërkombëtare, neni 4 “Organizimi i studimeve”)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” synon përgatitjen e specialistëve të nivelit universitar në MN, të aftë të njohin fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në tërësi. Programi ka si synim, formimin dhe përgatitjen e studentëve për të ofruar shërbimin e tyre në institucionet politike, në administratën publike dhe sektorët e saj, në organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, etj. Nëpërmjet kurrikulës, programeve lëndore synohet formimi i studentëve me terminologjinë e duhur që i duhet në aftësimin e tyre profesional përmes integritit të teorisë dhe praktikës. <i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit).</i></p> <p>Lëndë të tilla si: Shkrim Akademik, Metodatat e Kërkimit Shkencor, Histori e Shtetit Shqiptar, Histori Bashkëkohore, Ekonomiks (makro-mikro) apo Sociologji/Psikologji plotësojnë formimin bazë të studentit.</p> <p>Gjithashtu 16 lëndët karakterizuese e pajisin studentin me njohuri të thelluara dhe multidimensional të fushës së Marrëdhënieve ndërkombëtare. Lëndë të tilla si: Teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Organizatat dhe Institucionet Ndërkombëtare; Hyrje në Gjeopolitikë; Bazat e Diplomacisë etj janë disa nga lëndët e kësaj kategorie.</p> <p>Gjithashtu, në syllabuset e lëndëve shprehen qartë metodikat për rezultatet e të nxëniet dhe konceptet kryesore që përfitojnë</p>



	<p>studentët në fund të çdo lënde (<i>Dok. Nr. 32.4 Syllabus-et e Lëndëve/Moduleve</i>).</p> <p>Kontrolli i dijeve realizohet me shkrim, me gojë ose në mënyrë të kombinuar. Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë nga 0-100 pikë, dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë, nga 4 (katër) në 10 (dhjetë), sipas tabelës së mëposhtme. Notat nga 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë) janë kaluese. Aftësitë shprehimore teorike i lejojnë studentët për t'u integruar në specializime profesionale në punë të kualifikuara ku nevojiten njohuritë që lidhen me këtë program studimi. (<i>Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit, neni 13</i>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi është në përputhje me kriteret e përcaktuar në VKM Nr. 41/2018 (i ndryshuar). <i>Lëndët e këtij programi janë kategorizuar në kategoritë A-E, dhe përveç kategorisë C që duhen dhe 2 kredite, pjesa tjetër është në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kategoria A:</b> Lëndë bazë - përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme ka 36 kredite;</li> <li>• <b>Kategoria B:</b> Lëndë karakterizuese - përgatitje për disiplinën shkencore ka 98 kredite;</li> <li>• <b>Kategoria C:</b> Lëndë ndërdisiplinore/integruese - grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje ka 20 kredite; (<i>kjo kategori ka një mungesë prej 2 kreditesh. Marzhi i krediteve është 22-27 kredite për këtë kategori</i>)</li> <li>• <b>Kategoria D:</b> Lëndë plotësuese - gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale ka 20 kredite;</li> <li>• <b>Kategoria E:</b> Detyrime përmbyllëse - punimi i diplomës ka 6 kredite.</li> </ul> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, neni 4 “Organizimi i studimeve”; neni 7; 8 dhe 9)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Konkretisht, praktika mësimore është e shtrirë përgjatë semestrit të dytë të vitit të tretë akademik dhe ka 8 kredite. Punimi i diplomës ka 6 kredite dhe realizohet në përfundim të programit mësimor.</p> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit, neni 9)</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>KUB nuk ka patur studentë me status të veçantë në këtë program studimi gjatë këtyre viteve.</p> <p><i>(001. RVB_Programi i ciklit te pare Bachelor ne Marredhenie Nderkombetare, fq.14)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe RVB-ja, institucioni nuk paraqet të dhëna për këtë kriter. Në RVB thuhet se: KUB nuk ofron programe studimi të tjera të ngjashme me programin e studimit Bachelor në MN.</p> <p><i>(001. RVB_Programi i ciklit te pare Bachelor ne Marredhenie Nderkombetare, fq.14)</i></p> <p>Gjithsesi, GVJ, shqyrtoi programet e ofruara nga IAL të tjera në vend, dhe pjesa me e madhe e tyre kishin emërtime të përafërta me këtë program të tilla si: “Marrëdhënie dhe institucione ndërkombëtare”, “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”, “Marrëdhënie ndërkombëtare dhe Studime Evropiane”, “Marrëdhënie ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes” etj. Nga kërkimi ynë rezultoi se me të njëjtin emërtimi kishte vetëm një IAL e cila ofronte program me emërtim të njëjtë por me profile. Nga analiza e kurrikulës realizuar për këto programe ka një ngashmëri të konsiderueshme.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në dokumentin me Nr.283prot, datë 30.06.2023, institucioni ka realizuar kodifikimin e programit të studimit dhe e ka dërguar për miratim në MAS. Bazuar në këtë document, për këtë program studimi ka kodin “63BA0302S”.</p> <p><i>(Dok. Nr.35 Shkresa dërguar në MAS për kodifikimin e programeve të studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve</p>	<p><b>Nuk aplikohet për këtë program studimi.</b> Gjithsesi, institucioni ka ndërmarrë një proces për të realizuar marrëveshje për programe të njëjta dhe diploma të dyfishta.</p>

të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	<i>(001. RVB_Programi i ciklit te pare Bachelor ne Marredhenie Nderkombetare, fq.14; Dok. Nr.35 Shkresa dërguar në MAS për kodifikimin e programeve të studimit)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ evidenton se programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni në vijim të konsiderojë që në kurrikulën e këtij programi studimi, Kategoria C -Lëndë ndërdisiplinore/integruese të plotësohet me 2 kredite. Ky sygjërim mbështetet në faktin e përputhshmërisë së plotë me bazën ligjore në fuqi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike përbëhet nga tre departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Drejtësisë;</li> <li>2. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare;</li> <li>3. Departamenti i Shkencave Politike;</li> </ol> <p>Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” ofrohet nga Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Veprimtaria e njësisë kryesore dhe asaj bazë mbështetet në aktet rregullatore të KUB dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e parashikuara në këto akte. Për organizimin e punës krahas akteve në nivel institucional si rregullore Universiteti, Fakulteti dhe Departamenti, (departamenti) ka miratuar dhe një rregullore të dedikuar për programin e studimit bachelor në “Marrëdhënieve Ndërkombëtare” (Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënieve Ndërkombëtare). Në këtë dokument janë të përcaktuara detajet dhe specifikimet e programit, qëllimet dhe objektivat e tij, mënyra e organizimit të studimeve, plani mësimor etj. Departamenti përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin, strukturën dhe stafet</p>

	<p>akademike. Departamenti përbëhet nga Përgjegjësi (i cili drejton departamentin), stafin akademik dhe sekretaria e njësive kryesore (neni 4). <i>(Dok. Nr.6 Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare)</i></p> <p><b>Përbërja e Departamentit paraqitet si në vijim:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Viti akademik 2021-2022: 7 PAE (5 Dr; 2 Msc.) dhe 4 PAK (2 Prof.Asoc; 1 Dr; dhe 1 Msc);</li> <li>- Viti akademik 2022-2203: 7 PAE (2 Prof.As., 3 Dr. dhe 2 Msc.) dhe 3 PAK (2 Dr; 1 Msc).</li> <li>- Viti akademik 2023-2024: 7 PAE (1 Prof.As., 4 Dr. dhe 2 Msc.) dhe 3 PAK (3 Dr).</li> </ul> <p><i>(Dok Nr.84 Lista e Pedagogëve në KUB për Vitin Akademik 2022-2023, fq.1-2; Dok Nr.116. 2 Lista e Personelit Akademik për Njësine Bazë, Titujt Gradat)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Stafi i brendshëm i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Njësia bazë përbëhet nga 7 anëtarë me kohë të plotë. Për realizimin e programit të studimit, krahas stafit të departamentit angazhohen në mësimdhënie edhe pedagogë nga njësi bazë të tjera të FDSHP.</p> <p>Në planin mësimor është përcaktuar që në vitin e tretë të studimeve të realizohet praktika mësimore. Neni 14 i Rregullores së programit të studimit titullohet “Procedura për zhvillimin e praktikës”. Ky nen përcakton procedurën hap pas hapi të realizimit të praktikës mësimore. Në pikën dy të këtij neni përcaktohet se: “Zhvillimi i praktikës realizohet nën drejtimin e një pedagogu me eksperiencë të përcaktuar me urdhër të dekanit, i cili ndjek nga afër çdo student për angazhimin dhe mënyrën e trajtimit të problemeve që lidhet me institucionin ku kryhet praktika.” Rregullorja përcakton se për realizimin e praktikës mësimore caktohet një anëtar i departamentit pra staf akademik dhe jo një anëtar i personelit ndihmës akademik/administrativ. Ky element është një plus për cilësinë e procesit të praktikës mësimore.</p> <p><i>(Dok.Nr.116 Tabela 6.1 &amp; 6.2 - Personeli Akademik për Programin e Studimit).</i></p> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Dok. Nr.32.3 Planet Mësimore të programit të studimit)</i></p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Kuadri ligjor i institucionit përcakton funksionet dhe detyrat e drejtuesit të Departamentit. (Statuti, Rregulloret) Drejtuesi i Departamentit është hallka lidhëse midis departamentit dhe dekanit duke përcjell propozimet e njësisë bazë. Ai mbikqyr veprimtaritë mësimore shkencore, monitoron procesin e përgatitjes në përputhje me planin mësimor të stafit dhe realizimit të programeve të studimit të departamentit etj. <i>(Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, neni 9, fq.5-6)</i></p> <p>Gjithashtu neni 9 i Rregullores së njësisë bazë përcakton në pikën 2 gërma c që: “Kur e gjykon të nevojshme Drejtuesi i Departamentit, cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori informon vazhdimisht drejtuesin e njësisë përkatëse, për ecurinë e programit të studimit”.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër në lidhje me respektimin e kuadrit legjislativ si dhe kornizën e brendshme rregulative me rregulloren e KUB, rregulloren e njësisë kryesore, njësisë bazë dhe atë të programit të studimit. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike si njësia kryesore dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare si njësia bazë ku ofrohet programi i studimit, përmbushin detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik dhe funksionojnë duke përmbushur detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Stafet akademike dhe administrative janë të përshtatshëm në drejtim të arritjes së objektivave të programit të studimit. Pozicioni i koordinatorit është i përcaktuar në aktet rregullatore të institucionit dhe mbart detyra për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. GVJ konkludon se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Programi i studimit është organizuar sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 <i>“Për elementët e programit të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë”</i> , i ndryshuar. GVJ konstaton se programi i studimit është i organizuar në lëndë, aktivitete formuese dhe punim diplome të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), të cilat zhvillohen në tre vite akademik, të ndarë në dy semestra. <b><i>(Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare)</i></b> . Grupi i ekspertëve të jashtëm thekson se Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare disponon informacionin dhe teknikalitetet e nevojshme lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. <b><i>(Dok.Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit)</i></b>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është i ndërtuar mbi bazën e planit mësimor, i cili jep informacion të detajuar në lidhje me llojin e veprimtarisë, numrin total të krediteve për çdo lëndë, ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit.  Ky program studimi është i organizuar në 3 vite akademike (6 semestra) me një total kreditesh 180 ECTS. Çdo vit akademik përmban 60 ECTS me nëndarje të lëndëve të tipologjisë A, B, C, D dhe E <b><i>(Dok.Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit)</i></b> . Gjuha e programit të studimit është shqip. Në aktet rregullatore të institucionit si dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohen rregullat për frekuentimin e mësimit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe	Institucioni ka një kuadër të plotë rregullator që lidhet me përcaktimin e kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Aktet bazë të KUB si Rregullorja e institucionit <b><i>(Neni 61 “Pranimet në programet e ciklit të parë të studimit”;</i></b> <b><i>Neni 75 “Transferimet dhe programet e dyta”;</i></b> <b><i>76 “Transferimi nga KUB”)</i></b> dhe të Rregullores së programit të studimit janë të përcaktuara kriteret e pranimit, të transferimit dhe të ekuivalentimit, rregulla të cilat i bëhen të ditur studentit nga

<p>ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>strukturat përkatëse. <i>(Dok.Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit).</i></p> <p>Në programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, pranohen të gjithë kandidatët që kanë përfunduar arsimin parauniversitar të përgjithshëm ose profesional, si dhe ata që zotërojnë një diplomë të fituar jashtë RSh dhe të njohur në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Nota mesatare për regjistrimet e reja i referohet VKM-së. Në bazë të Statutit dhe rregulloreve të KUB si dhe procedurave të parashikuara në rregulloren për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, njësia kryesore, ofron mundësinë për njohjen dhe transferimin e studimeve ndërmjet programeve të njëjta ose të ngjashme dhe në të njëjtin cikël studimi brenda KUB ose institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë <i>(Dok. Nr.4 Rregullore e KUB, Neni 75 “Transferimet dhe programet e dyta”; 76 “Transferimi nga KUB”).</i></p> <p>Njohja dhe transefrimi i studimeve kryhet në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga studenti, verifikimit të realizuar nga sekretaria mësimore, vendimit të komisionit të njohjes dhe ekuivalentimit nga komisioni Ad-Hoc ngritur për këtë qëllim pranë fakultetit përkatës <i>(Dok. Nr.39 Rregullore për Ekuivalentimin e Studimeve).</i> Studentët janë të informuar për procedurën që ndiqet nga regjistrimi deri në përfundimin e ciklit të studimit <i>(Dok. Nr.40 Paketa e Regjistrimit të studentit).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, janë hartuar në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe janë të strukturuar sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni. Në to paraqitet informacion i detajuar në lidhje me objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. <i>(Dok. Nr.32. 4 Syllabus-et e LëndëveModuleve të programit të studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në</p>	<p>Bazuar në aktet rregullative të institucionit në çdo fillim viti akademik plotësohet dosja e plotë e programit me elementët e kurrikulës, syllabuset, ngarkesën e stafit akademik etj <i>(Dok. Nr.4 Rregullore e KUB; Dok. Nr.6 Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Dok. Nr.7</i></p>



<p>fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p><b>Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënieve Ndërkombëtare).</b></p> <p>Gjithashtu si pjesë e këtij procesi në çdo fillim viti akademik rishikohet përmbajtja e programeve lëndore të programit të studimit. Referuar kërkesave të VKM Nr. 41/2018, (i ndryshuar) Syllabusi përmban gjithë informacionin e nevojshëm për lëndën respektive në çdo semestër studimi dhe për çdo vit akademik që ofron program i studimit.</p> <p><i>(Dok. Nr.32. 4 Syllabus-et e LëndëveModuleve të programit të studimit)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në institucion, GVJ konkludon se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë të studimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi i programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” synon të pajisë me njohuri dhe formim të thelluar specialistë të kësaj fushe. Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve sipas legjislacionit në fuqi dhe realizimi i praktikës dhe punimi i diplomës, mundëson njohuri dhe aftësim për vijimin e studimeve të mëtejshme apo edhe për punësimin e mundëshëm të studentëve të diplomuar. Ky program studimi është i përshtatshëm për të pajisur studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të vijuar më tej në programet e studimit Master i Shkencave apo programe të tjera të ciklit të dytë me përmbajtje dhe disiplinë të njëjtë e të afërt.</p> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënieve Ndërkombëtare)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet,</p>	<p>Programi i studimit bachelor në ‘Marrëdhënie Ndërkombëtare’ ka 180 kredite dhe organizohet në 6 semestra për 3 vite</p>




<p>shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>akademike. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore. Bazuar në kurrikulën e programit të studimit klasifikimi i veprimtarive formuese në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse mundëson më së miri arritje dhe përmbushje efikase të objektivave formuese të programit të studimit duke i aftësuar studentët me njohuri që reflektojnë zhvillimet më të fundit në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënieve Ndërkombëtare)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është i strukturuar duke mbajtur në konsideratë lëndët, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë dhe është në përshtatje të plotë me bazën ligjore që kërkon një program i ciklit të parë të studimeve si në nivelin kombëtar dhe atë rajonal për studentët brenda dhe jashtë vendit. Syllabuset dhe planet mësimore përcaktojnë qartë dhe në mënyrë eksplicite emërtimi, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë të lëndës apo modulit.</p> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Dok. Nr.32. 4 Syllabus-et e LëndëveModuleve të programit të studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit si rregullore programi studimi, kurrikula, plani mësimor, syllabuse rezulton se ka raport mes formimit teorik dhe atij praktik në programin e studimit bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”. Ndërtimi i programit mundëson transferimin e studimeve, mobilitetin e studentëve, sikurse dhe punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik në përfundim të studimeve i shërben arritjes së objektivave të zhvillimit profesional dhe aftësimit për tregun e punës.</p> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Dok. 116. 8_9_10_Plani Mësimor i Ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E);</i></p> <p><i>(Dok. Nr.32. 4 Syllabus-et e LëndëveModuleve të programit të studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare përditëson në mënyrë të vazhdueshme programet e lëndëve duke përfshirë literaturën bazë dhe/apo literaturën ndihmëse me publikime studimore të disiplinës në</p>

<p>vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>lidhje me lëndët përkatëse të programit të studimit. <b>(Dok. Nr.32 .7 Rifreskim i literaturës. Model Syllabusi; Dok. Nr.48 Lista e teksteve të reja për programin e studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare).</b> Njësia bazë merr në konsideratë dhe trajton sugjerimet apo rekomandimet e ndryshme që vijnë nga plani vjetor i veprimtarisë dhe raportet e hartuara nga NJSBC në lidhje me programet apo procesin mësimor akademik. <b>(Dok. Nr.45 Plani vjetor i NJSBC Viti Akademik 2023-2024; Dok. Nr.46 Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023)</b></p> <p>Tëresia e kompetencave që kërkohet nga tregu i punës për të diplomuarit e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është përcaktuar në mënyrë të plotë në Rregulloren e Programit të Studimit në nenin 3 të saj ku përcaktohen objektivat specifike formuese të programit të studimit.</p> <p><b>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare).</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje të plotë dhe garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e secilës lëndë të këtij programi (sipas Kategorive A-E, raporti midis komponentëve teorik dhe atyre praktik).</p> <p><b>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare;</b></p> <p><b>(Dok. Nr.32. 4 Syllabus-et e LëndëveModuleve të programit të studimit)</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është përgatitur për të pajisur studentët me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme që do t’i mundësojnë ata të jenë konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe të formojnë baza për studime të mëtejshme akademike në ciklin e dytë. Përmbajtja e programit të studimit “Marrëdhëniet Ndërkombëtare” është në përputhje me përcaktimet e bëra në vizionin dhe misionin e KUB, si një institucion i konsoliduar arsimor dhe kërkimor etj. <b>(Statuti; Rregullorja e institucionit).</b> Programi i studimit, mbështetur edhe në fushën e veprimtarisë së institucionit, përgatit e aftëson profesionistë të marrëdhëniet ndërkombëtare të denjë për tu përfshirë në administratën publike si në nivel qendror dhe atë lokal, në organizata të shoqërisë civile dhe organizata e institucione ndërkombëtare etj. <b>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare)</b></p>

	<p><b>Ndërkombëtare; Dok. Nr.32. 4 Syllabus-et e Lëndëve Moduleve të programit të studimit)</b></p> <p>Gjithashtu element plus për institucionin është dhe platforma GRADUA e cila është financuar nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, dhe ofron një model të integruar kërkesë-ofertë punësimi në mbështetje të universiteteve shqiptare përmes databazës së të diplomuarve dhe mbledhjes së të dhënave lidhur me performancën e tyre; lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet IAL-ve dhe bizneseve; lehtësimin e pozicionimit të të diplomuarve në tregun e punës.</p> <p><b>(Dok. Nr.49 Marreveshje bashkëpunimi dhe regjistrimi në Platformën GRADUA)</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konkludon se struktura, përmbajtja dhe organizimi i programit të studimit Bachelor në "Marrëdhënie Ndërkombëtare" është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve si dhe të kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të</p>	<p>Institucioni bazohet në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve të tij nënligjore si dhe ka një kuadër të plotë dokumentacioni si statut, rregullore, strategji, etj që orientojnë procesin e krijimit apo përmirësimit të përmbajtjes së programeve të studimit <b>(Dok. Nr.1 Statuti i KUB; Rregullore; Dok. 4. Rregullore e KUB; Dok. Nr.2 Planit Strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2026)</b>. Programi është një program i ri dhe si i tillë është hera e parë që është në proces akreditimi. Gjithsesi, instrumentat dhe baza ligjore ku funksionon departamenti e përcakton atë si njësi përgjegjëse për nisjen e këtij procesi për realizimin e përmirësimit të përmbajtjes së programit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës. Institucioni ka infrastrukturën dhe strukturat përgjegjëse që të asistojnë departamentin për ndërmarrjen e një procesi të tillë. Raportet dhe analizat</p>

<p>diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>periodike që realizojnë njësitë e garantimit të cilësisë dhe sigurisë së mësimdhënies shërbejnë gjithashtu për këtë proces. Të gjitha ndryshimet dhe përmirësimet e kurrikulave propozohen nga departamenti dhe Zyra e Kurrikulave dhe miratohen në Senatin Akademik.</p> <p><b><i>(Dok. Nr.116 Tabela 11- Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me 1 19 programin e licencuar)</i></b></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka si praktikë realizimin e takimeve periodike me studentët ALUMNI me qëllim matjen dhe ndjekjen e arritjeve dhe ecuritë e tyre profesionale. Neni 15 i Statutit të KUB dhe neni 82 i rregullores së institucionit përcakton si strukturë përgjegjëse “Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës” (ZSKK), e cila organizon, menaxhon, dhe drejton orientimin e studentëve për një mori procesesh brenda institucionit. Ndër të tjera ZSKK mban kontakte dhe merr informacion nga studentët e diplomuar. Për këtë program studimi, departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare do të diplomojë për herë të parë studentë në vitin akademik 2023-2024.</p> <p><b><i>(Dok. Nr.42 Raporti vjetor i veprimtarive të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës; Dok. 44. Studim Tregu për programin e studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare, fq.44)</i></b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Programi bachelor “Marrëdhënie Ndërkombëtare” është një program i ri dhe për herë të parë në proces akreditimi. KUB në tërësi ka infrastrukturën dhe mekanizmat e bashkëpunimit me rrjete profesionistësh, shoqata, dhe institucione publike e private për të marrë feedback që lidhet me nevojat për të përshtatur programet e studimit në përputhje me propozimet e ardhura prej tyre. Në vitin 2023, departamenti ka realizuar një studim tregu tejet kompleks për këtë program studimi, duke evidentuar një mori aspektesh të nevojshme për të ardhmen e tij. <b><i>(Dok. 44. Studim Tregu për programin e studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare)</i></b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se KUB ka strukturat dhe bazën ligjore për përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Stafi i departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare për realizimin e programit të studimit përpiqet të harmonizojë metodat bashkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive (<i>vizita në institucion; Minutat, fq.9 - 10</i>). Rregullorja e programit të studimit dhe programet lëndore parashikojnë se gjatë mësimdhënies, të përfshihen të gjithë elementët formues në funksion të studentit si: leksionet, seminarët, ushtrimet, projektet dhe detyrat e kursit, praktika profesionale, përgatitja e mikrotezës, por edhe leksionet e hapura me personalitete të ftuar. Neni 13 i Rregullores së programit të studimit tregon se mënyra e vlerësimit është në proces të vazhdueshëm dhe se testimi realizohet me shkrim, gojë ose i kombinuar.</p> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënieve Ndërkombëtare).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>KUB në fillim të vitit akademik harton planin vjetor të veprimtarive dhe planin e masave, dhe për këtë ajo informon MAS. (<i>Dok. 50. Plani vjetor i veprimtarive, KUB; Dok. 51. Plani i masave të Kolegjit Universitar "I Biznesit", për vitin akademik 2022-2023</i>) Në këto dokumente flitet dhe për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Për realizimin e objektivave të programit të studimit stafi akademik i departamentit të MN përdorin metoda bashkëkohore të mësimdhënies me synim zhvillimin e mendimit kritik e krijues të studentit me filozofinë e ndërveprimit interaktive me në qendër studentin. Stafi akademik përdor metoda interaktive dhe alternative si power-</p>

	<p>point, video, Portali i Studentit, Microsoft Teams, e-mail, biblioteka online, materiale teorike dhe praktike, etj.</p> <p><i>(Dok. Nr.001 RVB_Programi i ciklit te pare Bachelor ne Marredhenie Nderkombetare, fq.26)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.</p>	<p>Filozofia e institucionit dhe strukturat e tij mbështesin rritjen akademike dhe zhvillimin e metodave të suksesshme mësimore për stafit akademik. Institucioni mbështet financiarisht stafin akademik duke synuar rritjen e vazhdueshme profesionale të pedagogëve dhe ofrimin e stimuljve për përmirësimin profesional. <i>(Dok. 57. Vendim BA për mbështetjen financiare për Kërkimin Shkencor të stafit akademik KUB)</i></p> <p>Në kuadër të marrëdhënive dhe marrëveshjeve të KUB me shumë IAL vendase dhe të huaja, stafi i KUB merr kualifikim të vazhdueshëm, në kuadër të organizimit, mbështetjes dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore, botimeve në revista, vizitave studimore, mobiliteteve, pjesëmarrjeve të leksioneve të hapura etj. Institucioni ka revistën periodike “Scientific Journal of Profesional Studies” me ISSN 2412-5865 (print) dhe ISSN: 2520-0933(online) ku stafi mund të botoj falas.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënive të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Stafi akademik i departamentit është me përvojë në mësimdhënie dhe ka kualifikime shkencore duke qenë kompetent për modulet që zhvillon në dhënien e njohurive në kuadër të këtij programi studimi. Bazuar në Rregulloren e programit të studimit dhe infrastrukturën që ka institucioni, stafi akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin përmes nxitjes së mendimit krijues dhe zhvillimit të përgjithshëm të tij. Pedagogët përpiqen që të ndërtojnë marrëdhënie bashkëpunimi me studentët duke i përfshirë në aktivitete akademike dhe shkencore</p> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënive Ndërkombëtare; Dok. Nr.001 RVB_Programi i ciklit te pare Bachelor ne Marredhenie Nderkombetare, fq.27-8)</i></p> <p><i>(Vizita në institucion; Minutat)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit,</p>	<p>Institucioni ka ndërtuar praktika periodike vlerësimi në nivele të ndryshme me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe ruajtjen e cilësisë. <i>(Dok. Nr.14 Rregullore e Zyrës së NjSBC,</i></p>

<p>vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p><b>neni 4).</b> Bazuar në aktet rregullative bazë të KUB, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton në mënyrë periodike dokumentin me titull “Plani i veprimtarive kryesore për vitin akademik”. NJSBC në muajin nëntor përgatit pyetësoret dhe në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe njësitë bazë, në fund të çdo semestri organizojnë dhe plotësojnë pyetësorin për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi. <i>(Dok. Nr.45 Plani vjetor i NJSBC Viti Akademik 2023-2024; Dok. Nr.46 Raporti vjetor i NJSBC Viti Akademik 2022-2023)</i>. Ky pyetësor realizohet 2 herë në vit në përfundim të çdo semestri, përpara zhvillimit të provimit përfundimtar.</p> <p>Në të njëjtën kohë NJSBC realizon gjithashtu pyetësorë drejtuar pedagogëve për kushtet e punës dhe për studentët. Një instrument tjetër është dhe përdorimi i anketimeve të ndryshme për studentë në lidhje me programin e studimit që ndjekin dhe programet ekstrakurrikulare të ofruara. Në mënyrë rastësore nga anëtarët e NjBSC, zgjidhet kampioni i studentëve, të cilët intervistojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë studentët për problematikat, sugjerimet, opinionet për programin e studimit që ata ndjekin. Rezultatet e këtyre pyetësorëve bëhen pjesë e raporteve që NJSBC përgatit, i shpërndan në departamente dhe fakultete dhe i paraqet në rektorat. Një raport përmbledhës mbi rezultatet dhe gjetjet e pyetësorëve është i publikuar dhe në faqen e institucionit: <a href="https://kub.edu.al/njsbc/">https://kub.edu.al/njsbc/</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin</p>	<p>Procesi i monitorimit të programit të studimit realizohet si në nivel institucional (NJSBC), njësie kryesore dhe atë bazë. Në bazë të Statutit (kreu IX; Neni 81, Neni 82) dhe Rregullores së njësisë, NJSBC operon në nivel institucional si strukturë që monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të stafit akademik dhe realizimit të programeve të studimit. Njësia ka autonomi vepruese dhe akses për të gjitha të dhënat e institucionit. <i>(Dok. Nr.14 Rregullore e Zyrës së NjSBC)</i> Kjo zyrë ka kompetencë të hartojë raportet e vlerësimit të pyetësorëve të realizuar nëpërmjet njësive bazë dhe atyre kryesore, të cilët i paraqet nëpërmjet titullarit të institucionit për diskutim në Senatin akademik, i cili bën vlerësimin dhe cakton detyrat për masat që duhet të merren në bazë të rezultateve të marra. KUB përveç angazhimit dhe raporteve periodike të NJSBC, angazhon edhe agjenci të jashtme të pavarura, IQE, për të realizuar nëpërmjet pyetësorëve dhe raporteve përkatëse të plotësuar nga studentët dhe një tjetër nga stafi akademik.</p>



akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<i>(Dok. Nr.59 Marrëveshje bashkëpunimi KUB-IQE)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni përmes stafit akademik dhe infrastrukturës mbështetëse harmonizon dhe garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin. Për garantimin dhe ruajtjen e cilësisë së programeve të studimit, strukturat respektive realizojnë disa forma vlerësimi, si për studentët, stafet apo edhe vetëvlerësimi për të matur progresin e bërë në drejtim të formave sa më të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Institucioni angazhon edhe agjenci të jashtme të pavarura, IQE, për të realizuar procese vlerësimi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.2

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve, njohurive, si dhe kriteret dhe komponentët e vlerësimit pasqyrohen në rregulloren e programit të studimit si dhe në plan programet e çdo lënde. Dija e studentit kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogu dhe në forma të ndryshme. Testimi dhe vlerësimi i njohurive përbëhet nga dy rubrika: vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin në provim përfundimtar. Në Rregulloren e Programit të studimit përcaktohet e kategorizuar dhe pikëzuar çdo element si vijon:</p> <p>Vlerësimi i vazhduar;</p> <p>Pjesëmarrje: 1-10 pikë;</p> <p>Aktivizim: 1-10 pikë;</p> <p>Teste, detyra kursi: 1-20 pikë;</p> <p>Totali i vlerësimit të vazhduar është 40 pikë ose 40 %;</p> <p>Provimi përfundimtar: 1-60 pikë ose 60 %. Totali i vlerësimit 1-100 pikë. Pedagogu ka të drejtë të organizojë një shpërndarje</p>

	<p>të ndryshme të peshës së elementëve të vlerësimit të vazhduar brenda 20 %-it. Gjithashtu çdo syllabus ka një seksion të veçantë për mënyrën e vlerësimit të lëndës. Testimi mund të realizohet me shkrim, gojë ose e kombinuar. Vlerësimi me notë realizohet nga 4(katër) deri në 10(dhjetë).</p> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, neni 13 “Kontrolli i dijeve dhe elementët)</i></p> <p><i>(Dok. Nr.32. 4 Syllabus-et e LëndëveModuleve të programit të studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët e programit njihen me syllabusin dhe të gjithë elementët e tjerë të kursit, gjatë orës së parë të zhvillimit të lëndës apo modulit. Çdo pedagog ka të publikuar në site-in personal në portalin e KUB, programet e lëndëve ku paraqitet informacioni i plotë mbi elementët e vlerësimit. Gjithashtu rregullorja e programit të studimit ka informacion lidhur me mënyrën e testimit si edhe kriteret e transparencës për një vlerësim sa më objektiv.</p> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, neni 18 “Ankimimi ndaj vlerësimit dhe rezultatit”; Dok. Nr.32. 4 Syllabus-et e LëndëveModuleve të programit të studimit).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i dijeve dhe njohurive që studentët kanë fituar përgjatë lëndës apo kursit realizohet në mënyrë të vazhdueshme. Vlerësimi i vazhduar është 40% i vlerësimit total, dhe është një element nxitës dhe matës i performancës së studentit në disa komponent. Mënyrat e kontrollit të dijeve përcaktohen në syllabusin e lëndës/modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor.</p> <p><i>(Dok. Nr.32. 4 Syllabus-et e LëndëveModuleve të programit të studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Drejtuuesi i Njesisë Bazë mbikqyr dhe monitoron realizimin e procesit mësimor në programet e ofruara nga departamenti i MN Vlerësimi i aftësive të pedagogëve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies dhe transmetimit të dijeve, bëhet edhe nga studentët. Njësia e Sigurimit të Cilësisë përgatit pyetësorë për cilësinë e mësimdhënies së lëndëve të çdo programi studimi dhe i administron ato në fund të çdo semestri. Këto të dhëna përpunohen nga NjSBC, e cila harton raportin përkatës. Ky raport u komunikohet titullarëve dhe në vartësi të vlerësimeve,</p>

	<p>sygjerimeve dhe konkluzioneve të arritura vijohet me marrjen e masave për të bërë përmirësimet e nevojshme.</p> <p><i>(Dok. Nr.6 Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, neni 9 dhe 10).</i></p> <p><i>(Dok. Nr.14 Rregullore e Zyrës së NjSBC)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik pranë Departamentit të MN janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Ky proces udhëhiqet nga Drejtuesi i Departamentit dhe monitorohet dhe vlerësohet me kujdes.</p> <p><i>(Dok. Nr.6 Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, neni 6, 7, 9 dhe 10)</i> Në kuadër të marrëveshjeve dhe programit Erasmus +, nëpërmjet mobiliteteve institucioni mundëson pjesëmarrjen e stafëve akademike në trajnime dhe mësimdhënie. Gjithashtu, trajnimi dhe kualifikimi i stafit akademik realizohet nga KUB nëpërmjet organizimit dhe realizimit të Konferencave Shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare etj. <i>(Dok. Nr.68 Plan i Veprimtarive Akademike e Shkencore 2022-2023)</i> Strukturat përgjegjëse brenda institucionit realizojnë vlerësime periodike të tilla si vlerësimet e studentëve dhe vlerësimet e pedagogëve për monitorimin e procesit mësimorë dhe realizimit të programeve të studimit. Qëllimi është të sigurojë reagime konkrete dhe të prekshme mbi masat që duhen marrë për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>(Dok. Nr.45 Plani vjetor i NJSBC Viti Akademik 2023-2024).</i> Kurrikula është krijuar për të mundësuar një kombinim të ekuilibruar midis metodave të mësimin teoritik me atë praktik.</p> <p><i>(Dok. Nr.32. 3 Planet Mësimore të programit të studimit)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni harton rregullore dhe procedura të testimit e vlerësimit të njohurive në mënyrë të vazhdueshme duke gërshetuar punën përgjatë kursit me testimet përfundimtare. Zbatimi i procedurave të testimit të dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore garantohen nga stafi akademik dhe strukturat përgjegjëse që ka institucioni.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studentit duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit përcakton parimet e kriterëve të vlerësimit për kursin, si edhe tabelën e vlerësimit të notave. Pavarësisht specifikave të lëndës apo fokusit të pedagogut në vlerësimin e komponentëve të caktuar, testimi i njohurive bëhet gjatë të gjithë kursit duke u bazuar mbi elementë të ndyshëm siç janë pjesëmarrja aktive, përgatitja e projekteve apo prezantimeve, testimi me shkrim/gojë apo i kombinuar. Kjo shihet në shpërndarjen e vlerësimit përfundimtar në disa zëra dhe peshën e vlerësimit që ka secili komponent, përcaktuar qartë në rregulloren e programit dhe syllabuseve duke u harmonizuar me kërkesat e lëndës.</p> <p><i>(Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni ka një rregullore dedikuar zhvillimit të provimeve. Mbështetur në Rregulloren e Provimeve (neni 9) tezat e provimit, të përgatitura nga pedagogu përkatës dhe të miratuara nga përgjegjësi i departamentit, shumëfishohen, sekretaria mësimore në sallën e provimit realizon sekretimin e tyre. Tezat e provimit korrigjohen dhe rezultatet dalin brenda javës nga pedagogu i lëndës. <i>(Dok. Nr.64 Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB)</i> Në lëndë specifike dhe aplikative si Teknologji Informacioni, studentët e zhvillojnë testimin dhe vlerësimin e dijeve nëpërmjet aftësive kompjuterike. <i>(RVB)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bazohet në vlerësimin e të mësuarit të studentit përgjatë gjithë kursit, e shprehur në komponentët e cituar me sipër, duke bërë një përlllogaritje të pikëve dhe përqindjes respektive të secilit prej tyre. Vlerësimi del në përputhje me rregulloren e KUB. Komponentët e vlerësimit me pikët dhe përqindjen përkatëse përbëjnë një seksion të veçantë në syllabusin e lëndës, i cili ju shpjegohet studentëve në orët e para të fillimit të lëndës. Kjo mënyrë vlerësimi është parashikuar në statut, Rregulloren e KUB, Rregulloren e Programit, Rregulloren e Provimeve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe</p>	<p>Në kreun IV “Vlerësimi i studentëve”, neni 10 “Kontrolli i dijeve të studentit dhe komunikimi i vlerësimit prej pedagogut” të rregullores së provimeve trajtohen elementët e kësaj procedure. Pedagogu i lëndës i komunikon studentit në javën e fundit të semestrit nivelin e pikëve të vlerësimit të vazhduar të fituara gjatë semestrit. Në kuadrin e vlerësimit të vazhduar çdo</p>




<p>lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>komponent i vlerësimit të njohurive argumentohet nga ana e stafit akademik dhe për këtë njoftohet studentin. <i>(Dok. Nr.64 Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB)</i>. Në korrigjimin që i bëhet tezave të provimit pedagogu komenton dhe evidenton të gjitha plotësimet/mosplotësimet që lidhen me trajtimin e tezës. <i>(RVB, fq.34)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Neni 15 “Rregulla dhe procedura për studentin” i Rregullores së provimeve trajton detyrimet e studentit për procesin e provimit. Studentit nuk i lejohet të hyjë në sallë pa mjet identifikimi si dhe nuk i lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve, etj. <i>(Dok. Nr.64 Rregullore për zhvillimin e provimeve në KUB)</i> Për përgatitjen e temave të diplomave, zbatohet udhëzuesi për punimin e diplomës, me të gjitha kërkesat, kriteret dhe standardet e caktuara nga institucioni. <i>Institucioni nuk ka ndonjë program elektronik anti-plagjaturë për të evidentuar dhe garantuar origjinalitetin e punimeve. GJV sygjeron që në të ardhmen institucioni të planifikojë marrjen e një programi elektronik anti-plagjaturë.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Pikët e fituara përgjatë vlerësimit të vazhduar i komunikohen studentëve javën e fundit të semestrit. Teza e provimit përfundimtar është me 60 pikë. Rezultatet e provimit së bashku me pikët e vlerësimit të vazhduar përbëjnë rezultatin final të lëndës. Notat hidhen në portal nga sekretaria e fakultetit jo më vonë se një javë nga data e zhvillimit të provimit. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të ankimojë rezultatin brenda tre ditëve nga shpallja e rezultatit të provimit (neni 16 i Rregullores së provimeve). <i>(Dok. Nr.64 Rregullore për zhvillimin e provimeve)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Procedurat e ankimit sanksionohen në Rregullore e programit të studimit (neni 18) si edhe në Rregullore për zhvillimin e provimeve (neni 16). Ankesa bëhet me shkrim brenda 3 ditësh nga marrja e rezultatit të provimit. Sekretaria mësimore pasi i mbledh këto kontestime deri në 3 ditë nga shpallja e rezultatit të notave i depoziton në departamentin përkatës. Pedagogu lëndës rishqyrton kërkesën dhe i komunikon sekretarisë qëndrimin dhe vlerësimin mbi pretendimin e bërë në ankimin e studentit.</p>

<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në rastet kur kontestimi i rezultatit nga ana e studentit vijon, kjo ankesë përcillet në department. Procedura vijon me shqyrtimin e saj nga komisionet e ngritura posaçërisht. Komisioni përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendim të formës së prerë. Kur ankesa është e drejtë, njoftohet pedagogu i lëndës për të bërë ndryshimin përkatës, në të kundërt lihet në fuqi vlerësimi i parë. Kopjet e praktikës së ankesës së studentit dhe vendimet e komisionit për rivlerësimin e provimit, depozitohen në sekretarinë mësimore të fakultetit dhe një kopje drejtuesit të njësisë kryesore.</p> <p><i>(Dok. 7. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare; Dok. Nr.64 Rregullore për zhvillimin e provimeve)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Procedurat e vlerësimit janë të drejta dhe bëhen transparente që në fillim të vitit akademik si nëpërmjet rregulloreve respektive, syllabuseve ashtu edhe sqarimit që bëhet përpara çdo testimi nga ana e pedagogut. Vlerësimi bazohet në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit, i cili sigurohet nga legjislacioni i institucionit. Këto informacione u vërtetuan edhe nga bisedat me studentët edhe stafit akademik. Gjithashtu përsa i përket mekanizmave anti-plagjaturë <u>GVJ</u> sygjeron që në të ardhmen institucioni të planifikojë marrjen e një programi elektronik anti-plagjaturë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Standardi III.4</b></p>	
<p><b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Njësia bazë mbështetur në “Planin strategjik” të institucionit ka hartuar dokumentin e titulluar “Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit”. Në këtë dokument paraqiten orientimet e politikave zhvillimore për këtë program studimi për tre vitet e ardhshme.</p> <p><i>(Dok. Nr.32.11 Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit)</i> Kurrikula e programit bachelor në MN është hartuar duke mbajtur në konsideratë zhvillimet bashkëkohore të vendit,</p>

	<p>profilin akademik të pedagogëve si dhe nevojat e tregut të punës.</p> <p><i>(Dok. Nr.44 Studim Tregu për programin e studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare)</i></p> <p>Përditësimi i vazhdueshëm i lëndëve me literaturën dhe me format bashkëkohore të mësimdhënies garanton përfitimin e njohurive në fushën e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>GVJ pas takimit me studentët e programit të studimit vlerëson se ky program studimi ofron zhvillimin e aftësive në fushën specifike të marrëdhënieve ndërkombëtare si fushë studimi e shkencave politike. Aftësitë e veçanta orientohen kah zhvillimit të kapaciteteve analitike të studentëve dhe formimin e tyre, aftësi komunikimi, si dhe zgjeron perspektivën në fushën studimore. Programi i studimit parashikon që transmetimi i njohurive tek studentët, të kryhet nëpërmjet angazhimit të tyre në punë konkrete nëpërmjet detyrave të kursit, punimeve të ndryshme, përgatitjeve për testim etj. Stafi akademik kujdeset që krahas njohurive në kuadër të lëndës, studenti të mbahet aktiv përgjatë gjithë semestrit. Nëpërmjet punimit të diplomës, studenti fiton dhe aftësi në kërkimin shkencor si të shkruajnë një punim shkencor apo si ta prezantojnë atë.</p> <p><i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhënieve Ndërkombëtare).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmyllëse.</p>	<p>Departamenti harton dhe një dokument të titulluar “Raporti vjetor i veprimtarive Departamenti MN” duke strukturuar hap pas hapi objektivat dhe veprimtaritë e stafit në kuadër të realizimit të programeve të studimit. <i>(Dok. Nr.31 Raporti vjetor i veprimtarive Departamenti MN, Viti Akademik 2022-2023)</i> Personeli akademik është përgjegjës për zbatimin e syllabuseve të lëndëve dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit. Njohuritë dhe aftësitë që zhvillon studenti gjatë vitit akademik analizohen përgjatë gjithë semestrit nga pedagogu dhe në përfundim të lëndës jepet vlersimi i përmbledhur në të gjithë komponentët e tij. Kjo analizë e njohurive të përfituara por edhe asaj që mbetet ende për tu bërë ndihmon studentin për ti adresuar sugjerimet në vijim të studimit akademik. Pedagogët kanë takime të vazhdueshme me studentët dhe në këto konsultime ofrohen sugjerimet përkatëse për përmirësimin e punës me studentët <i>(Takim me Stafin Akademik).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë</p>	<p>Baza rregullative ku mbështetet funksionimi i departamentit dhe puna e stafit akademik për realizimin e programeve të</p>




<p>kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>studimit është e plotë dhe me kërkesa të larta në drejtim të cilësisë së mësimdhënies. <b>(Dok. Nr.32.11 Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit; Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare)</b> Stafi akademik për realizimin e procesit të mësimdhënies mbështetet si në aspektin teorik dhe atë praktik. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga leksionet, materialet shtesë, literatura e rekomanduar, apo raste studimore që mund të trajtohen në varësi të lëndës. Përfshirja e praktikës është gjithashtu një komponent i rëndësishëm për gërshtimin e njohurive me praktikën në institucione.</p> <p>Për rritjen e profilit akademik, personeli akademik nxitet nëpërmjet stimuluesh financiarë që të bëhet pjesë e projekteve, të publikojë në revistat shkencore dhe të marrin pjesë në simpoziume apo konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit. <b>(Dok. Nr.57 Vendim BA për mbështetjen financiare për Kërkimin Shkencor të stafit akademik KUB)</b> Stafi i departamentit të MN, diskutojnë brenda departamentit për përdorimin e metodave të reja në mësimdhënie si: përdorimi i mjeteve audio-vizive; ndërthurja e teorive me shembuj praktikë për të rritur nivelin dhe cilësinë; nxitja e ideve nëpërmjet punës në grup, përfshirja në projekte kursi, grup studentësh apo vizitave në zyra profesionale, etj. <b>(RVB, fq.37)</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentin “Plani i Veprimtarive akademike e shkencore 2022-2023” planifikohen një sërë aktiviteteve me karakter akademik dhe shkencor si për institucionin, stafin akademik dhe studentët. <b>(Dok. Nr.68)</b> Pjesa më e madhe e pedagogëve të KUB-it realizojnë gjatë zhvillimit të leksioneve të lëndës, raste studimore, kazuse, konkurse, orë ushtrimore, praktika mësimore në qendra, biznese, partnerë bashkëpunëtorë si edhe leksione të hapura me qëllim përvetësimin e dijeve dhe njohurive në mënyrën më efektive të mundshme. <b>(RVB)</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët nëpërmjet harmonizimit të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies me kërkimin shkencor, studimet në terren, praktikave profesionale. Institucioni ka struktura e mekanizma në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X






**Standardi III.5**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Krahas bazës rregullatore, institucioni ka hartuar dhe Udhëzuesin e Diplomimit ku trajtohen kriteret, procedurat, elementët mbi përfundimin e studimeve dhe realizimin e punimit. Në përfundim të programit të studimit bachelor, studentët realizojnë detyrimet përmbyllëse përmes dy mënyrave: me provim formimi ose punim teme diplome. <i>(Dok. Nr.7 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, neni 19)</i> Studentët duhet që fillimisht të përmbyllin të gjitha detyrimet për çdo lëndë të programit dhe më pas mund të fillojnë punimin përfundimtar për diplomimin. Pragu i notës mesatare në bazë të të cilës studenti ka të drejtë të diplomohet me punim diplome përcaktohet çdo vit me urdhër të drejtuesit të njësisë kryesore. Studenti zgjedh temën dhe pedagogun udhëheqës duke depozituar kërkesë pranë departamentit. Udhëheqësi dhe tema e kërkuar miratohet nga Dekani. <i>(Dok. Nr.32. 6 Udhëzues për përgatitjen e diplomës)</i> Për studentët të cilët realizojnë provim formimi, departamenti përgatit një dokument me bazën e pyetjeve dhe programin e provimit të formimit. Në kalendarin akademik të institucionit përcaktohen afatet kohore për këtë proces. Sekretara mësimore informon studentët rreth procedurave dhe dokumentacionit përkatës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Sekretaria mësimore por edhe pedagogët i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet, afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Sekretaria mësimore i përcjellë përgjegjësit të departamentit dhe dekanit të fakultetit listën e studentëve që kanë plotësuar detyrimet akademike dhe financiare dhe kanë të drejtën e provimit të formimit ose mbrojtje e tezës së diplomës. Studentët që do të nënshtrohen provimit të diplomës ju vendoset në dispozicion një listë me pyetje/ushtrime orientuese nga lëndë të zhvilluara në të gjithë vitet e studimit. Kjo listë disponohet në Sekretarinë Mësimore dhe publikohet për të informuar studentët.</p> <p><i>(Dok. Nr.32. 6 Udhëzues për përgatitjen e diplomës)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit</p>	<p>Në Rregulloren e institucionit (Kreu XIV, neni 104, neni 105) është përcaktuar baza ligjore për "Diplomimin". <i>(Dok. Nr.4 Rregullore e KUB)</i> Në rregulloren e departamentit neni 32</p>

<p>final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>“Provimi i diplomimit” trajtohen elementët e kësaj procedure. Komisioni i vlerësimit të provimit përfundimtar përbëhet nga 3 anëtar, propozohet nga departamenti dhe miratohet nga dekani. Tezat e provimit përfundimtar hartohen në bazë të njohurive të marra përgjatë tre viteve akademike. Procesverbali me rezultatet e Provimit, plotësohet, firmoset nga Komisioni dhe dorezohet ne Sekretari.</p> <p><i>(Dok. Nr.6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Dokumenti i titulluar “Udhëzues për përgatitjen e diplomës” është dokumenti bazë që përcakton hap pas hapi procesin. Studenti zgjedh temën dhe pedagogun udhëheqës duke depozituar kërkesë pranë departamentit. Udhëheqësi shkencor asiston studentin në çdo fazë të punimit, që nga përcaktimi i temës, hartimin e strukturës, materialet mbështetëse, përpunimin, klasifikimi, nxjerrja e rezultateve dhe shkrimin e temës, etj. Komisioni dhe kryetari i saj miratohet nga dekani i fakultetit me propozim të përgjegjës të departamentit dhe përbëhet nga jo me pak se 3 vetë. Mbrojtja e diplomës bëhet e hapur. Në përfundim anëtarët e komisionit, bëjnë secili vlerësim me notë dhe nota përfundimtare del si mesatare e vlerësimit.</p> <p><i>(Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Dok. Nr.32. 6 Udhëzues për përgatitjen e diplomës)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Stafi akademik i departamenti, udhëheqësit, punonjësit e bibliotekës dhe sekretaria mësiore asistojnë studentët në procesin e punës për plotësimin e detyrimeve përmbledhëse. Në dokumentin “Udhëzues për përgatitjen e diplomës; pika 2.3” janë të përcaktuara dhe detyrimet që ka udhëheqësi i diplomës, i cili asiston studentin në çdo fazë të përgatitjes së punimit të diplomës. Ata janë në dispozicion të studentëve me çdo formë komunikimi.</p> <p><i>(Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Dok. Nr.32. 6 Udhëzues për përgatitjen e diplomës; Vizita në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së</p>	<p>Provimi përfundimtar vlerësohet me notë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Gjithashtu dhe komisioni për mbrojtjen e punimit të diplomës duke patur parasysh cilësinë shkencore të punimit, si edhe duke i ofruar studentit feedback lidhur si me aspektet pozitive ashtu dhe me pikat që meritonin më shumë vemendje realizon vlerësim me notë. Nota përfundimtare</p>

<p>diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>llogaritet si mesatare e thjeshtë e vlerësimeve të anëtarëve të komisionit. Në përfundim të ditës së provimit, student njihet me rezultatin e tij. Si minimum i notës kaluese konsiderohet pragu i 50%.</p> <p><i>(Dok. 6. Rregullore e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare; Dok. Nr.32. 6 Udhëzues për përgatitjen e diplomës)</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, institucioni i pajis studentët me Diplomën dhe Suplementin e Diplomës sipas formës të miratuar dhe të regjistruar në QSHA. <i>(Dok. Nr.4 Rregullore e KUB; Dok. Nr.32. 10. Diploma Supplement Bsc MN)</i> Në bazë të legjislacionit në fuqi, studenti pajiset nga IAL brenda 6-mujsh me diplomën përkatëse të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve, si edhe me suplementin e diplomës.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Krahas Rregullores së institucionit, njërive kryesore dhe atyre bazë, ka dhe një rregullore dedikuar punës dhe detyrave të sekretarisë mësimore. GVJ gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore konstatoi se insitucioni ruan dokumentacionin dhe i përgjigjet studentëve kur këta e kanë të nevojshme duke i vënë në dispozicion informacionet e nevojshme. Të dhënat e studentëve ruhen në regjistrin themeltar në formën fizike, edhe në atë elektronike. Studentët pajisen me dokumentat përkatëse sikurse parashikon ligji. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve i cili siguron mbrojtjen e nevojshme të të dhënave përkatëse. Pas mbylljes së studimeve, dosja e studentit arkivohet duke respektuar legjislacionin në fuqi për arkivat.</p> <p><i>(Dok. Nr.66 Rregullore e Sekretarisë Mësimore)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit. Ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, ndërsa ndihmohet në të gjithë procesin nga sekretaria mësimore, stafi i departamenti ashtu edhe nga udhëheqësi i diplomës. Në përfundim të studimeve, KUB e përgatit studentin me dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë diplomën edhe suplementin.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
<p><b>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</b></p>	<p>Nga vëzhgimet në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në RVB-në dhe materialet plotësuese, GVJ konstaton se të dhënat mbi rekrutimin e stafit akademik (PAE dhe PAK) apo dhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ gjenden të arkivuara dhe administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore të KUB. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare pjesë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike, të KUB-it në përputhje me detyrat dhe kompetencat e tij si Njësi Bazë të përcaktuara dhe në Statutin e KUB, në Rregulloren e Njësisë Kryesore dhe në Rregulloren e Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ka parashikuar organizimin e grupe mësimore kërkimore-shkencore, sipas programit të studimit. Personeli akademik (PAE dhe PAK) i angazhuar për realizimin e programit të studimit ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e mësimdhënies, në përputhje me rregulloren e programit të studimit. FDSHP dhe Departamenti i MN në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi ka angazhuar si staf akademik së paku me gradën Doktor, pedagogë, titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë MN. GVJ konstaton se në përputhje me këtë angazhim rezulton se në këtë program studimi janë angazhuar një personel akademik me tituj (kategoria Profesor) dhe grada:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Tituj/grada</th> <th>2021 – 2022</th> <th>2022-2023</th> <th>2023-2024</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>PAE/PAK</td> <td>PAE/PAK</td> <td>PAE/PAK</td> </tr> </tbody> </table>	Tituj/grada	2021 – 2022	2022-2023	2023-2024		PAE/PAK	PAE/PAK	PAE/PAK
Tituj/grada	2021 – 2022	2022-2023	2023-2024						
	PAE/PAK	PAE/PAK	PAE/PAK						

<b>Prof.Dr</b>	0 / 0	0 / 0	0 / 0
<b>Prof.As.Dr</b>	0 / 0	2 / 0	3 / 0
<b>Dr/PhD</b>	2 / 3	6 / 3	8 / 2
<b>Msc/ proces doktorature</b>	4 / 0	4 / 0	4 / 0
<b>Në total</b>	<b>6 / 3</b>	<b>12 / 3</b>	<b>15 / 2</b>

Sipas konstatimeve GVJ ka parë me kujdes dhe të dhënat për personelin akademik të ngarkuar për realizimin e programit BSC në MN, të cilat departamentit i Drejtësisë dhe Shkencave Politike i zotëron, pasqyron në mënyrë të detajuar përfshirë dhe ndryshimet që pa pësuar personeli akademik efektiv dhe me kontratë gjatë vitit akademik në këtë program studimi. Departamenti i MN në dokumentacionin e tij ka të pasqyruar dhe listën e plotë të personelit akademik (PAE dhe PAK) në çdo semestër, si dhe të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ. Nga konstatimet e GVJ rezulton se personeli akademik i ngarkuar për realizimin e këtij programi studimi ka kualifikime, sipas specialiteteve që mbulon dhe në funksion të fushës kërkimore që mbulon ky program studimi. Staf i akademik i ngarkuar për realizimin e këtij programi studimit pothuajse plotësisht është i specializuar sipas fushave akademike dhe kërkimore, të përgjithshme dhe specifike të tyre, në përputhje me specialitetin e ofruar në programin e studimit MN, dhe sipas natyrës dhe specifikave të lëndëve e moduleve që ata zhvillojnë. Kjo është demonstruar edhe në veprimtarinë kërkimore – shkencore, fushat e botimeve të pasqyruara në mënyrë të detajuar në CV e të gjithë stafit të D DSHP, dhe programit të parë të studimit MN.

*(Dok. 116 Tabela 3-Numri i Programeve të studimit në Ciklin e I-rë dhe të II-të, që ofrohen në Njësinë Bazë. Tabela 1-Numri i personelit akademik për Njësinë Kryesore, Tabela 2-Lista e personelit akademik për Njësinë Bazë Titujt/Gradat, Tabela 7-Të dhëna për personelin akademik (Dok 116) Tabela 8-Personeli PAE/PAK sipas Titujve/Gradave dhe Moshës për Programin BSC në MN)*

**Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e

Nga vëzhgimi me kujdes i dokumentacionit të paraqitur dhe nga të dhënat e paraqitura nga GVB, u konstatua nga GVJ se programi i studimit Marrëdhënie Ndërkombëtare është bazuar në strukturimin e tij në përputhje me parashikimet ligjore, aktet ligjore e nënligjore në fuqi si në normën juridike ashtu dhe në ngarkesën mësimore, gjë e cila dhe shpaloset plotësisht në

studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

planin mësimor, sipas ngarkesës në orë dhe kredite në vite akademike sipas semestrave përkatës. Në kuadrin e strukturimit të këtij programi studimi pasqyrohet shtrirja e tij në 3 vite akademike, me 6 semestra dhe 180 kredite. Shtrirja e lëndëve (ngarkesa në orë dhe kreditet (ECTS) për çdo lëndë) përgjatë semestrave të vitit akademik është në përputhje të plotë me strukturimin e këtij programi studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për tre vite akademike është si më poshtë vijon:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2021-2022	617	459	158	74% / 26 %
2022-2023	1226	1068	158	87% / 13%
2023-2024	1154	1026	128	88% / 18%

*(Dok 116-Tabela 6.1 dhe 6.2-Stafi Akademik për Programin e Studimit Bsc. Në MN për 3 vite; Dok 116-Tabela 7-Raporti i Personelit PAE/PAK sipas Titujve/Gradave dhe Moshës për Programin Bsc. MN; Dok. 116 Tabela 8-Personeli PAE/PAK sipas Titujve/Gradave dhe Moshës për Programin Bsc. MN; Dok. 116-Tabela 4-Ngarkesa Totale e Personelit Akademik të Programit BSC. MN)*

**Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit.

Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit gjatë 3 viteve të fundit nuk ka patur ndryshime të mëdha. Kjo vërehet në listën e PAE të tre viteve të fundit, por edhe në kontratat e punës të lidhura midis personelit akademik dhe institucionit, të cilat kanë të parashikuara mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga institucioni sipas ligjeve në fuqi.

*(Dok 116-Tabela 6.1 dhe 6.2-Stafi Akademik për Programin e Studimit Bsc. Në MN për 3 vite; Dok 116-Tabela 7-Raporti i Personelit PAE/PAK sipas Titujve/Gradave dhe Moshës për Programin Bsc. MN; Dok. 116 Tabela 8-Personeli PAE/PAK sipas Titujve/Gradave dhe Moshës për Programin Bsc. MN;)*

	<i>(Dok 78-Kontratë Punë FT_Tip; Dok. 79 Kontratë Pune PT_Tip)</i>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se procedura e rekrutimit dhe vlerësimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten në departament, sipas përcaktimeve statutorë dhe të legjislacionit mbi arsimin e lartë. GVJ pas verifikimeve të dokumentacionit në institucion, kontakteve dhe të dhënave të RVB evidentoi se KUB i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e tij, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Kriteret publikohen në WEBSITE-N zyrtar të KUB, Pra shpallja e vendeve vakante bëhet publike. Dekani i FDSHP ia përcjell këto kërkesa Rektoratit, për të vijuar më tej me procedurat e konkurrimit. GJV konstatoi se Zyra e burimeve njerëzore mban dhe ruan një bazë të plotë dhe të qartë të raporteve të rekrutimit të stafit akademik, njoftimeve për punë, konkurseve, etj. Për vlerësimin e kandidatave ngrihet një komision i posaçëm, i cili shqyrton dosjen e kandidatit të paraqitur dhe zhvillon intervistën me gojë.</p> <p>GVJ konstatoi se rekrutimi i personelit akademik është mbështetur në aktet e brendshme rregullatore përcaktohet dhe bëhet në përputhje me nevojat e departamentit, përmes publikimit të vendeve vakante dhe kërkesave/kritereve të përgjithshme e specifike për plotësimin e tyre. Departamentit në varësi të strukturës, kualifikimit të stafit dhe programeve të studimit që ofron, përcakton dhe kriteret të veçanta shtesë për vendet vakante, mbështetur mbi kategorinë e personelit që kërkohet të punësohet, të cilat miratohen nga rektorati. Të njëjtat kriteret dhe kërkesa për punësimin e PAE zbatohen dhe për punësimin e PAK. Konkurrimi është i hapur transparent dhe kryhet sipas një procedure që përcaktohet qartë në statut dhe rregulloret e brendshme të miratuara.</p> <p><i>(Dok.1. Statuti i KUB, kreu 5, neni 41-53; Dok. 85 –Një praktikë e rekrutimit të stafit akademik në KUB; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi i Punës, neni 19; Ligji i Arsimit të Lartë, Nr. 80/2015, kreu 6, neni 57-68)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për</p>	<p>Referuar RVB, Departamenti i Marëdhënieve Ndërkombëtare, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike në programin e studimit BMN, angazhon dhe personel akademik, në ndihmë të realizimit të veprimtarisë akademike. Departamenti i Marëdhënieve Ndërkombëtare, si njësi përgjegjëse për zbatimin e këtij program studimi, përmbush të gjithë detyrimet</p>




<p>realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike dhe ndihmëse të tij për realizimin e proceseve mësimore laboratorike (labororet e informatikës). Nga verifikimet e kryera nga vizita në institucion dhe nga kontaktet e takimet që patëm me studentë të këtij programi studimi konstatuam se, personeli ndihmës akademik për vetë specifikën që mbart ky program është angazhuar në kryerjen e orëve për realizimin e proceseve mësimore laboratorike, sipas tematikave që ka programi mësimor (syllabus-et e lëndëve/moduleve të përcaktuara në plane kalendarike, e në javë mësimore), mbështetur në nivel kualifikimi.</p> <p><i>(Dok.80-Relacion mbi infrastrukturën e KUB; Dok. 116-Tabela 16- Mjediset e Fakultetit/Njesive Bazë)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga vëzhgimet në institucion dhe nga të dhënat e paraqitura në dokumentacion GVJ konstaton se të dhënat mbi rekrutimin e personelit akademik (PAE dhe PAK) si dhe të personelit ndihmës akademik dhe administrative të angazhuar në programin e studimit Bsc MN, gjenden të arkivuara dhe administrohen në ZBNJ të KUB. Struktura ka përgjegjësinë e mbledhjes, ruajtjes dhe përditësimit të të dhënave të personelit të angazhuar në këtë program dhe në programet e tjera të studimit. Gjithashtu të dhëna mbahen dhe për personelin ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrativ dhe detyrat që realizon. ZBNJ në bashkëpunim me drejtusit e Njesive Kryesore, përpilon dhe dërgon në MAS dhe në ASCAL, listatën e plotë të personelit akademik (PAE/PAK) si dhe të personelit administrativ për të gjithë institucionin të ndarë sipas njësive kryesore dhe në vite akademike. CV e personelit akademik të institucionit përditësohet në dosjet e çdo punonjësi dhe evidentohet e përditësuar dhe në site-n personal të tyre.</p> <p><i>(Dok. 86-Përmbajtja dokumentare e dosjes së stafit FT; Dok. 87-Përmbajtja dokumentare e dosjes së stafit PT; Dok. 6-Rregullore e DMN; Dok 7.-Rregullore e Programit të Studimit MN; Dok. 84-Lista e pedagogëve të KUB për vitin akademik 2022-2023; Dok. 116-Tabela 1-Numri i Personelit Akademik për Njesinë Bazë, Dok. 116-Tabela 2-Lista e Personelit Akademik për Njesinë Bazë)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë,</p>	<p>Nga vizita në institucion, si dhe duke konsultuar bazën dokumentare që DSHP ka paraqitur, GVJ konstaton se rang Institucioni dhe Fakulteti, sipas programeve të studimit që ai mbulon ka lidhur një numër të konsiderueshëm marrëveshjes bashkëpunimi me institucione homologe, me aktorë të biznesit,</p>



<p>përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>vendas apo të huaj të cilët ofrohen për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve si pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e kurrikulës të studimeve. Departamenti në funksion të realizimit të veprimtarive specifike të organizuara prej tij apo institucione të tjera në përputhje me programet mësimore, ka caktuar dhe personelin akademik të specializuar në këto fusha. Qëllimi i ndërmarrjes dhe angazhimit në këto veprimtari është bashkëpunimi me studentët, rritja e numrit të studentëve pjesëmarrës dhe angazhimi i tyre në to. KUB në sferën e veprimtarisë së vet ka ndjekur procedura të tilla që nxisin dhe ofrojnë mundësitë e bashkëpunimit në kuadër të strategjisë së tij dhe të departamentit të MN për përfshirjen në këtë program studimi të personaliteteve të njohura në fushat përkatëse përmes leksioneve të hapura, udhëheqjes së diplomave në kuadër të një bashkëpunimi më dinamik dhe në studime e projekte shkencore si në konferenca dhe workshop.</p> <p><i>(Dok. 27-Udhëzues për përgatitjen e Praktikës Profesionale; Dok. 27. 2 –Marrëveshje bashkëpunimi për Praktikën Profesionale_TIP; Dok. 32.6-Udhëzues për përgatitjen e Diplomës, Dok. 88-Lista e personaliteteve të ftuar për Leksione të Hapura KUB)</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritesë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Nga vëzhgimi i planit mësimor, rezulton se programi i studimit MN është strukturuar në mënyrë të tillë që në vitin e tretë të semestrit të dytë studentët të realizojnë disiplinën praktikë profesionale (8 ECTS)-200 orë mësimore dhe 280 orë individuale. Në përfundim të saj studenti vlerësohet në prani të një komisioni vlerësimi, i krijuar për çdo vit akademik nga drejtuesi i njësive bazë. Vlerësimi nga ana e komisionit mbështetet dhe në vlerësimin e praktikës mësimore (përfaqësuesi i Kompanisë ku kryhet praktika profesionale) mbështetur dhe në një raport përfundimtar nga ana e personelit mbikëqyrës të caktuar për të dhe nga ana e Komisionit të Mbrojtjes së Praktikës për studentin përkatës. Personeli akademik që ndjek dhe monitoron praktikën profesionale, merr pjesë si anëtar i komisioneve të ngritura në Nësinë Bazë në KUB për të kryer dhe vlerësimin përfundimtar të çdo studenti.</p> <p><i>(Dok. 7-Rregullore e Programit të Studimit MN, neni 13; Dok. 27-Udhëzues për përgatitjen e Praktikës Profesionale; Dok. 27.2 –Marrëveshje Bashkëpunimi për Praktikën Profesionale_TIP; Dok. 27.3-Tabela e vlerësimit të Praktikës Profesionale)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga vëzhgimet në institucion dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në RVB-në, GVJ konstaton se:</i></p>

	<p><i>Të dhënat për rekrutimin e stafit akademik (PAE dhe PAK) dhe personelit ndihmës akademik dhe administrativ gjenden të arkivuara dhe administrohen nga ZBNj në KUB. Programi i studimit BMN në strukturim është në përputhje me parashikimet ligjore, aktet ligjore e nënligjore në fuqi që shpaloset plotësisht në planin mësimor. DMN ka burimet, kapacitetet për mbulim të plotë të programeve të studimit që ofron. Procedura e rekrutimit të personelit akademik bëhet transparente dhe publikohet në WEB zyrtar të tij. Në rang Institucioni dhe Fakulteti ekzistojnë marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe, me aktorë të biznesit, vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve pjesë e kurrikulës së studimeve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, duke shqyrtuar infrastrukturën ekzistuese në të cilën kryen veprimtarinë e vet Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, konstaton një infrastrukturë të përshtatshme për çdo personel akademik për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si dhe kushte të mjaftueshme që do të garantonin plotësisht cilësinë dhe performancën në kryerjen e veprimtarisë akademiko-shkencore të çdo anëtari e personeli akademik të departamentit. Në infrastrukturën e FDSHP nën kujdesin e KUB janë marrë masat për të rritur hapësirat ndërtimore duke ulur densitetin e studentëve për metër katror. Nga ana e institucionit është parashikuar dhe e drejta e tyre në përdorimin e infrastrukturës në dispozicion të procesit mësimor, por dhe të pasurit akses në përfitimin e shërbimeve mbështetëse që ofrohen nga Fakulteti FDSHP dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ka ambiente të komode me pajisje teknologjike të nevojshme për programet e që ofrohen në departament. Mjediset ku punojnë pedagogët janë të mira, dhe secili ka hapësirën e vet të punës.</p> <p><i>(Dok. 80-Relacion mbi infrastrukturën e KUB; Dok. 80/1 Kontrata e Qerasë së Godinës në përdorim KUB; Dok. 80/2</i></p>

	<p><b>Relacion i ekspertit të Pavarur për infrastrukturën e godinës në përdorim KUB; link 19-Laboratorët: <a href="https://kub.edu.al/kampusi-ynë/#laboratoret-e-informatikes">https://kub.edu.al/kampusi-ynë/#laboratoret-e-informatikes</a></b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Grupi Vlerësues i Jashtëm gjatë vizitës në institucion dhe bazuar në evidencat e infrastrukturës reale në dispozicion të procesit mësimor teorik dhe praktik, konstatoi mjaftueshmërinë e hapësirës fizike në varësi të numrit të studentëve dhe natyrës së aktivitetit mësimor që zhvillohet në to, por edhe pajisjen e tyre me mjetet e nevojshme bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (mjeteve audio-vizive) që sigurojnë kryerjen me efektivitet të llojeve të aktiviteteve mësimore që parashikohen sipas natyrës së moduleve (syllabus-eve). Njëkohësisht dhe hapësira e vënë në dispozicion të personelit akademik është më se e mjaftueshme qoftë nga pikëpamja fizike ashtu dhe ajo infrastrukturore. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike disponon dy laboratore (për 20 dhe 50 studentë) të pajisur me mjete të teknologjisë digjitale i cili do të ndihmojë procesin cilësor të mësimdhënies dhe hulumtimit individual të studentëve me risitë që nevojiten në aspektin formues profesional dhe të studentëve që do të ndjekin programin e studimit BMN.</p> <p><b>(Dok. 80-Relacion mbi Infrastrukturën e KUB; Dok. 80/1-Kontrata e qerasë së godinës në përdorim KUB; Dok. 80/2-Relacion i ekspertit të pavarur për Infrastrukturën e godinës në përdorim KUB; link 19-Laboratorët: <a href="https://kub.edu.al/kampusi-ynë/#laboratoret-e-informatikes">https://kub.edu.al/kampusi-ynë/#laboratoret-e-informatikes</a>)</b></p> <p><b>Sugjerim:</b> Nga ana e DMN dhe stafit akademik të tij dhe, më konkretisht, të programit të studimit BMN, nga ana e GVJ sugjerohet një shfrytëzim sa më efikas i mjeteve me bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, në kryerjen më së miri të aktiviteteve mësimore, por dhe atyre me natyrë praktike.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të</p>	<p>Laboratorët (2 laboratorë informatike) të dedikuar për programe studimi, në FDSHP, si dhe në programin e ciklit të parë të studimit MN përmban aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve. Studentët kanë akses në internet pa limit dhe në çdo moment mund të lidhen on-line, apo me faqe të ndryshme që mundësojnë qasje të nevojshme për realizimin e detyrave individuale apo projekteve.</p>




objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<p><i>(Dok.80-Relacion mbi Infrastrukturën e KUB; link 19-Laboratorët: <a href="https://kub.edu.al/kampusi-ynë/#laboratoret-e-informatikes">https://kub.edu.al/kampusi-ynë/#laboratoret-e-informatikes</a>)</i></p> <p><i><b>Rekomandim:</b> Departamenti duhet të vijojë me vendosjen e programeve të caktuara të programeve mësimore për të ndikuar në cilësinë e mësimdhënies dhe ndërveprimin online në grupet e punës e hulumtimit online.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konfirmoi se mjedisi logjistik dhe në veçanti infrastruktura didaktike ishte e aksesueshme në çdo kohë, si për studentët ashtu dhe për stafin akademik, në çdo ditë të javës. Departamenti i Marëdhënieve Ndërkombëtare ka në përdorim 2 laboratorë të teknologjisë së informacionit. Laboratori është i pajisur pjesërisht me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit.</p> <p><i>(Dok. 80/2-Relacion i ekspertit të pavarur për Infrastrukturën e godinës në përdorim KUB; link 19-Laboratorët: <a href="https://kub.edu.al/kampusi-ynë/#laboratoret-e-informatikes">https://kub.edu.al/kampusi-ynë/#laboratoret-e-informatikes</a>)</i></p> <p><i><b>Rekomandim:</b> Mbështetur në strategjinë e KUB dhe të FDSHP e më konkretisht të DMN, në laboratorin ekzistues duhet të instalohen dhe programet profesionale sipas natyrës së programit të studimit. Është e kuptueshme që në këtë aspekt në kuadër të ndërkombëtarizimit si pjesë e strategjisë së KUB, duhet të hidhen hapa konkretë sidomos në këtë program studimi, i cili i përshtatet kërkesave dhe tregut të punës në nivel lokal e më gjerë.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, duke shqyrtuar infrastrukturën ekzistuese në veprimtarinë e DMN, konstaton:</i></p> <p><i>- Një infrastrukturë të përshtatshme për personelin akademik për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si dhe kushte të mjaftueshme që do të garantonin plotësisht cilësinë dhe performancën në kryerjen e veprimtarisë akademiko-shkencore. Mjaftueshmëri të hapësirës fizike në varësi të numrit të studentëve dhe natyrës së aktivitetit mësimor që zhvillohet në to, por edhe ekzistencën e pajisjeve të nevojshme elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për kryerjen me efektivitet të llojeve të aktiviteteve mësimore.</i></p> <p><i><b>Sugjerim:</b> GVJ sugjeron se DMN dhe stafi akademik i tij si dhe programi i studimit BMN të bëjnë një shfrytëzim sa më efikas të mjeteve me bazë elektronike dhe të teknologjisë së</i></p>




	<p><u>informacionit për kryerjen e aktiviteteve mësimore dhe me natyrë praktike.</u></p> <p><u>Rekomandim: Departamenti duhet të vijojë me vendosjen e programeve të caktuara mësimore e profesionale për të ndikuar në cilësinë e mësimdhënies dhe ndërveprimin online në grupet e punës e hulumtimit online. Në kuadër të ndërkombëtarizimit si pjesë e strategjisë së KUB, duhet të hidhen hapa konkretë sidomos në këtë program studimi, i cili i përshtatet kërkesave dhe tregut të punës në nivel lokal e më gjerë.</u></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>KUB vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën e Librarinë e KUB garanton të drejtën e çdo studenti për aksesim të bibliotekës përmes procedurës së regjistrimit dhe hapjes së kartelës për shfrytëzimin të literaturës fizike në ambientet e saj. Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë shërbimin e internetit nga mbulimi i gjithë hapësirës së bibliotekës me rrjetin ëireles dhe të aksesohet në biblioteka on-line, për gjetjen e literaturës së nevojshme të parashikuar në programet mësimore të MN.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se programi i studimit mbështetet nga literatura bazë (kryesisht në gjuhën shqipe) dhe ndihmëse (e sugjeruar për çdo program disipline në gjuhën shqipe dhe të huaj-anglisht) e përcaktuar nga stafi akademik (kryesisht botime të stafit të brendshëm) dhe në syllabus-et e lëndëve përkatëse dhe i miratuar nga drejtuesi i njësisë bazë.) Mënyra e ofrimit të literaturës që u vihet në dispozicion studentëve të këtij program studimi është e printuar ose on-line nëpërmjet mënyrës së komunikimit elektronik në Portalin e KUB dhe Platformës Google Class Room.</p> <p><i>(Dok. 89-Model përmbledhje Cikël leksioni nga Libraria e KUB; Dok. 48-Lista e teksteve të reja për programin e</i></p>

	<p><i>studimit MN; Dok. 90-Marrëveshje bashkëpunimi JSTOR/e-biblioteka; Dok. 74-Guida e stafit për përdorimin e Platformësclassroom_KUB; Dok. 116-Tabela 17-Të dhëna për Platformën Online/Struktura e IT/ Biblioteka online; link 8-Hyrje në Portal, link <a href="https://portal.kub.edu.al/hyrje/">https://portal.kub.edu.al/hyrje/</a> )</i></p> <p><i>Konstatim: Nga vizita në bibliotekën e KUB, u evidentua se literatura bazë ishte e aksesueshme, ndërsa në lidhje me literaturën ndihmëse, sidomos ajo në gjuhë të huaj paraqiste vështirësi në aksesimin e saj nga ana e studentëve, pavarësisht mundësive që u paraqiteshin atyre për shfrytëzim.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>KUB, bazuar në objektivat e Planit Strategjik 2021-2026 për zhvillimin e programit të studimit BMN, në projekt buxhetin vlerësuar në nivel akademik, financiar apo dhe burimesh njerëzore, ka krijuar hapësira të rëndësishme dhe në rritjen cilësore dhe funksionale të bibliotekës. FDSHP ndjek një praktikë të pasurimit të fondit të bibliotekës së KUB sipas kërkesave që vinë nga DMN (njësia bazë). Drejtuesit e programeve të studimit përmes kërkesave të marra nga ana e stafit akademik, me titujt e propozuar i përcjellin ato bibliotekës së KUB. Nga takimi që patëm me punonjësen e bibliotekës na u konfirmua fakti që institucioni merr në konsideratë kërkesat e stafit akademik, por procesi i realizimit të pasurimit të fondit realizohet në varësi të buxhetit të hartuar nga ana e IAL-KUB.</p> <p>Koleksioni bibliotekar fizik përfshin burime që plotësojnë deri diku nevojat e përdoruesve të saj si nga përmbajtja ashtu dhe nga forma. Pedagogët e lëndëve depozitojnë nga 2-3 kopje të literaturës/tekstit që kanë në përdorim, shpenzimet financiare të cilëve mbulohen nga financat e KUB. Në bibliotekën e KUB shtohen për çdo vit dhe botimet e stafit akademik në revista me proceedings, revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara nga KUB me ISSN, si dhe publikimet periodike të Bankës së Shqipërisë, Kuvendit të Shqipërisë Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare si dhe nga donacionet e ardhura nga marrëdhëniet e krijuara nga KUB me Kompaninë nga Danimarka "New Era Publications International" si dhe revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Koleksionet bibliotekare përmbajnë edhe librarinë elektronike në gjuhë të ndryshme. Është evidentuar një shtim i vazhdueshëm i librit elektronik me tituj e formate të rinj. Biblioteka siguron hyrje në bazat e të dhënave elektronike në rrjet. Katalogu ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit përmes përshkrimit bibliografik, ofrohet falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e stafit akademik të KUB-</p>




	<p>it. KUB vë në dispozicion të pasurimit të bibliotekës për pasurimin e saj në vit dhe një fond prej 200-300 mijë lekë nga burimet e tij financiare në lidhje me publikimet e reja sipas fushave specifike që shërbejnë si literaturë për programe të ndryshme studimi.</p> <p><i>(Dok. 58 –Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, faqe 65; Dok. 48 –Lista e teksteve të reja për programin e studimit BMN)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>KUB vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën Shkencore e cila është hibride me fonde e vendosur në godinën B e përshtatur për programet e studimit të drejtësisë, ekonomisë teknologjike të informacionit dhe studimeve të larta profesionale. Biblioteka ka një sipërfaqe prej 65-70 m<sup>2</sup> duke ofruar një sallë studimi të përshtatshme me kapacitet prej 80 vendesh. Fondi i librave është 7150 ekzemplarë të disponueshëm në shqip dhe gjuhë të huaj përfshi dhe aksesueshmërinë në bibliotekën elektronike JSTOR. Biblioteka është e pajisur me një sistem dokumentacioni dhe informacioni për një shërbim efektiv ndaj studentëve dhe stafit mësimdhënës. Në vitin 2022-2023 është implementuar dhe një soft aplikativ i ri për administratën automatike të fondit të librave dhe përmirësimin e marrëdhënies me përdoruesin.</p> <p>Mbështetur në të dhënat e marra si në rrugë komunikimi me stafin akademik të DMN, FDSHP dhe Bibliotekës, ashtu përmes tyre bazës së dokumenteve të paraqitura në këtë proces mund të theksojmë se së bashku ato mbulojnë në masën 80-90% nevojat e studentëve për literaturë mësimi dhe kërkim. Biblioteka shkencore e KUB ka në fokus mbështetjen e ecurisë zhvillimore-akademike të stafit, lektorëve dhe studentëve, përmes ofrimit të alternativave akademike bashkëkohore nëpërmjet teknologjisë së informacionit në aktivitetin e tyre akademik-shkencor.</p> <p><i>(Dok. 48 –Lista e teksteve të reja për programin e studimit BMN; Dok. 92-Rregullore e Bibliotekës)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstaton se biblioteka e KUB është e pajisur me një fond librash prej 7150 ekzemplarë të disponueshëm në shqip dhe gjuhë të huaj përfshi dhe aksesueshmërinë në bibliotekën elektronike JSTOR. Biblioteka me literaturën që disponon shërben për sigurimin e literaturës bazë dhe të rekomanduar për programet e studimit të fushave të: Drejtësisë, Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Shkencave Politike, Fozozofisë dhe Informatikës, Ekonomisë dhe Studimeve Profesionale që ofrohen në këtë institucion</p>




<p>përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>(IAL) privat. Biblioteka e KUB është e pajisur me një sistem dokumentacioni dhe informacioni për një shërbim efektiv ndaj studentëve dhe stafit mësimdhënës. Ky sistem mundëson shkëmbimin e të dhënave me Bibliotekën Kombëtare, bibliotekat europiane si dhe vendosjen e partneritetit me institucione brenda dhe jashtë vendit për shkëmbin e huazim informacioni. Në vitin 2022-2023 është implementuar dhe një soft aplikativ i ri për administratën automatike të fondit të librave dhe përmirësimin e marrëdhënies me përdoruesin.</p> <p>Mbështetur në të dhënat e marra si në rrugë komunikimi me stafin akademik të DMN, FDSHP dhe Bibliotekës, ashtu përmes tyre bazës së dokumenteve të paraqitura në këtë proces mund të theksojmë se së bashku ato mbulojnë në masën 80-90% nevojat e studentëve për literaturë mësimi dhe kërkim. Biblioteka shkencore e KUB ka në fokus mbështetjen e ecurisë zhvillimore-akademike të stafit, lektorëve dhe studentëve, përmes ofrimit të alternativave akademike bashkëkohore nëpërmjet teknologjisë së informacionit në aktivitetin e tyre akademik-shkencor. Katalogu on-line i Bibliotekës shërben për përcjellje informacioni në lidhje me literaturën ekzistuese (JSTOR). Ambientet e bibliotekës së KUB dhe literature fizike dhe on-line janë të aksesueshme dhe të vëna në dispozicion të studentëve dhe stafit i antarësuar, pa pagesë.</p> <p><i>(Dok. 80/2-Relacion i ekspertit të pavarur për Infrastrukturën e godinës në përdorim KUB; Dok. 48 –Lista e teksteve të reja për programin e studimit BMN)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KUB ka vënë në dispozicion të studentëve kushte dhe mundësi shfrytëzimi të barabartë e pa pagesë për studentët të literaturave të ndryshme duke përfshirë edhe ato të Drejtësisë, Marrëdhëniesve Ndërkombëtare, Shkencave Politike, Fozozofisë dhe Informatikës, Ekonomisë dhe Studimeve Profesionale që ofrohen në këtë institucion (IAL) privat duke mundësuar ndërlidhjen e shumëfishtë të programit të studimit në BMN si edhe duke ndikuar në rritjen e formimit të studentëve. KUB-i ka vënë në dispozicion të DMN, programit BMN dhe studentëve të këtij programi Bibliotekën e tij, që të shfrytëzohet lirisht nga studentët por dhe mundësi të konsultojnë katalogun e bibliotekës në adresën Web (<i>link. 21, Link. 20, link. 22</i>) me abonin 1 vjeçar ofron për literaturë bazë dhe ndihmëse ofron edhe shërbim në version on-line, duke siguruar lidhje aksesit me anë të IP statike me kod të hapur. Në fokus të punës së KUB, FDSHP, DMN ka qenë dhe pasurimi i</p>



	<p>vazhdueshëm i katalogëve, teksteve që mbështesin procesin mësimor dhe të aktiviteteve të Universitetit.</p> <p>Studentët kanë akses të pakufizuar dhe në adresat e bibliotekave free online (<i>link. 23, link 24, link. 25, link. 26, link. 27, link. 28, link. 29, link. 30, link. 31, link. 32</i>) me anë të të cilave sigurohen informacione edhe jashtë ambienteve të universitetit përmes informimit me anë të katalogut në kërkimin e informacionit dhe përdorimin e literaturës së nevojshme për kërkim shkencor, hartimin e tezave të diplomave dhe disertacionet e stafit akademik.</p> <p><i>(Dok. 80/2-Relacion i ekspertit të pavarur për Infrastrukturën e godinës në përdorim KUB; Dok. 91-Relacion i Bibliotekës së KUB, Dok. 52-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative "GOOGLE APPS", portali KUB; Dok. 90-Marrëveshje bashkëpunimi JSTOR/e-biblioteka)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstaton se Biblioteka e KUB ka në funksion të saj me kapacitet (<b>sipas RVB-50 poste, që nuk përputhet me Dok. 92-i cili thotë për një kapacitet prej 80 vendesh</b>), gjë e cila duhet riparë për të saktësuar të dhënat dhe për transparencë. Në bibliotekë ka dhe një sallë internet/leximi e pajisur me kompjuterë dhe programe kompjuterike si dhe pajisje të tjera të cilat përdoren nga të gjitha kategoritë e frekuentuesve të tyre, edhe ato që janë të regjistruar në programin e studimit BMN, pa kufizime, në përputhje me rregulloren e saj. Nga instalimi falas i Katalogut Online të Integruar, studentët mund të shfrytëzojnë on-line materiale në kohë reale, por mund të aksesojnë lirisht sa herë dëshirojnë në kompjuterët e bibliotekës. Biblioteka ka në funksion fondin on-line JSTOR, GSTOR, AKADEMIA.EDUELIBRARY, EBSCO etj.</p> <p><i>Database e bibliotekës është e disponueshme si në rrugë elektronike ashtu dhe në hardcopy.</i></p> <p><i>(Dok. 92-Rregullore e bibliotekës, neni 6)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të</p>	<p>Biblioteka Universitare qëndron e hapur nga e hëna në të shtunë. Përgjatë javës orari i funksionimit të bibliotekës është nga ora 9.00 – 15.00 dhe 16.00-20.00. Oraret e bibliotekës ishin në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Gjithashtu studentët kishin mundësinë të tërhiqnin literaturë për shfrytëzim jashtë ambienteve të bibliotekës. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët kishin mundësi të shfrytëzonin bibliotekën gjatë hapësirave të lira kohore dhe të</p>




<p>nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>aksesoheshin në biblioteka on-line deri në orarin e mbylljes së saj dhe atë on –line pas tij.</p> <p><i>(Dok. 92-Rregullore e bibliotekës, neni 6; link. 33, Biblioteka online, link:https://kub.edu.al/libraria/fj)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>KUB bazuar në realizimin e objektivave të Planit e Zhvillimit Strategjik 2021-2026 për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit akademik ka si prioritet krijimin e hapsirave dhe alternativave më optimale për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe nivelit akademik të stafit dhe studentëve pjesë e tij. Dhe FDSHP ndjek një praktikë të kërkesave për pasurimin e fondit të bibliotekës sipas kërkesave që vijnë nga njësitë bazë duke ia parashtruar KUB për pasurimin e bibliotekës. Përgjegjësit e programeve të studimit përmes kërkesave të marra nga personeli akademik me titujt e propozuar i përcjellin ato Bibliotekës Shkencore të KUB. Nga takimi që patëm me punonjësen e bibliotekës na konfirmoi se institucioni në një masë të konsiderueshme i merr në konsideratë kërkesat e stafit akademik dhe realizimin e procedurës për pasurimin e fondit në mënyrë periodike. Numri i të antarësuarve fizikë dhe anëtarëve të stafit akademik, studentëve të të gjitha fakulteteve të KUB ishte i konsiderueshëm. Një pjesë e literaturës mundësohet përmes blerjeve nga ana e burimeve financiare të KUB, pjesa tjetër nga dhurimet dhe antarësimeve në biblioteka online nga institucioni. Biblioteka parashikon fondet e caktuara për t'u blerë literaturë shkencore. Burimi për pasurim kryhet përmes blerjes, dhurimit nga biblioteka, apo nga persona të veçantë, studentë, shtëpi botuese, brenda dhe jashtë vendit, përmes botimeve shkencore elektronike, artikujve shkencorë, tezave dhe disertacioneve të stafit akademik dhe studentëve të universitetit, pasurimi periodik me botimet e Bashkimit Evropian si dhe marrëdhënieve të krijuara me kompani botuese jashtë vendit.</p> <p><i>(Dok. 93-Kërkesë për tërheqje librash nga biblioteka_TIP; Dok. 92-Rregullore e Bibliotekës, neni 12l)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në nivel fakulteti KUB vendos në shërbim të studentëve Bibliotekën e institucionit, e cila garanton të drejtën e studentëve për aksesies përmes procedurës së regjistrimit e hapjes së kartelës për shfrytëzimin të literaturës fizike në ambientet e saj. Studentët shfrytëzojnë shërbimin e internetit nga mbulimi i gjithë hapësirës së bibliotekës me rrjetin wireles për akseset në bibliotekat on-line, si literaturë e nevojshme për programet mësimore të BMN. KUB, bazuar në objektivat e Planit Strategjik 2021-2026 për zhvillimin e programit të</i></p>

	<p><i>studimit BMN, në projekt buxhet ka krijuar hapësira të rëndësishme dhe në rritjen cilësore dhe funksionale të bibliotekës. Instirucioni merr në konsideratë kërkesat e stafit akademik dhe realizimin e procedurës për pasurimin e fondit në mënyrë periodike.</i></p> <p><b><i>Konstatim: Nga vizita në bibliotekën e KUB, u evidentua se në lidhje me literaturën ndihmëse, sidomos atë në gjuhë të huaj paraqiten vështirësi në akses nga studentët, pavarësisht mundësive për shfrytëzim.</i></b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohen të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së, GVJ konstaton se institucioni zotëron një sistem menaxhimi përmes të cilit administrohen të gjithë informacionet që kanë të bëjnë me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga hyrja/regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, informacion që mbahet në bazën përkatëse të të dhënave. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit, si dhe shërben për të hartuar statistika. Në përbërje të tij rezultojnë Drejtoria e Kurrikulës, Sektori i Komunikimit Alumnit dhe Karrierës Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike, në të cilin zhvillohet programi i studimit BMN, bashkë me sekretaritë mësimore (në përbërje të të cilës është kryesekretarja dhe sekretaret mësimore, që varen nga drejtuesi i njësisë kryesore), por edhe njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit administrojnë sistemin e menaxhimit të procesit mësimor, organizativ dhe administrative duke ju shërbyer studentëve dhe stafit akademik gjatë zhvillimit të këtij program studimi të ciklit të parë, përmes një strukture bashkëkohore të teknologjisë së informacionit dhe informimit në rrjet.</p> <p><i>(Dok.66-Rregullore e Sekretarisë Mësimore, kreu II; Dok. 94-Regjistri i të dhënave të studentëve/AMZA; Dok. 95-Regjistri i Rezultateve/performancës së studentit; Dok. 20-</i></p>

	<i>Organigrama e Kolegjit Universitar "I Biznesit"&amp; Vendimi i Senatit Akademik)</i>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se informacioni që lidhet me veprimtarinë dhe performancën akademike administrohet nga sistemi i brendshëm i menaxhimit. Kjo e fundit i takon njësisë bazë. Bashkë me këtë informacion mbahen dhe të dhëna lidhur me stafin akademik që angazhohet çdo semestër në këtë program studimi, me lëndën/lëndët përkatëse që mbulon dhe ngarkesën e planifikuar dhe të realizuar nga departamenti për programin e studimit BMN. Ky informacion bëhet pjesë e analizave dhe raporteve në nivel njësie apo institucioni. Dokumentacioni në fjalë ndodhet te Zyra e Burimeve Njerëzore në KUB, e cila ligjërisht përgjigjet për dokumentacionet e stafit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, përmes disponimit të dosjeve të stafit akademik dhe administrative ndër vite. Dosjet përditësohen me çdo dokument të fituar nga anëtarët e stafit përgjatë punës së tyre dhe dokumenti shtohet në dosje. Informacioni mbi stafin e KUB, disponohet edhe në formë elektronike, po ashtu dhe orët mësimore të kryera, ngarkesa mësimore faktike e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, disponohen nga njësia kryesore, njësia bazë dhe nga Zyra e Protokollit për kryerjen e veprimeve që duhen për ndjekjen e akteve administrative por dhe si memorje të KUB, Sekretarinë Mësimore që lidhen me dokumentimin dhe administrimin e veprimtarisë mësimore, Zyrat e Marrëdhënieve me Jashtë e Publikun, Zyrën e Kurikulave dhe ZSKK.</p> <p><i>(Dok. 86-Përmbajtja dokumentare e dosjes së stafit FT; Dok. 87-Përmbajtja dokumentare e dosjes së stafit PT; Dok.1-Statusi i KUB, nenet 15,16; Dok.4-Rregullore e KUB, nenet 5,7; Dok.20-Organigrama e Kolegjit Universitar "I Biznesit"&amp; Vendimi i Senatit Akademik)</i></p> <p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe kontakteve në stafin akademik dhe strukturat drejtuese në KUB rezulton se KUB-i disponon një portal të personalizuar për të siguruar kontakte dhe informim me maturantët, bizneset, institucionet publike/private në lidhje me aktivitetin dhe misionin e tij. Stafit akademik i brendshëm dhe i jashtëm në KUB disponon websitin e vet të personalizuar i cili i shërben për kontakte me studentët, personelin administrativ dhe palët e treta. Në shërbim të stafit akademik është dhe adresa personale e e-mailit si pjesë e unifikuar e domainit të KUB. Përmes tyre sigurohet informimi në kohë i studentëve dhe stafit akademik</p>

	<p>në lidhje me informacione apo shpërndarje dokumentacioni, duke shmangur procedurat e vonesat në lidhje me to.</p> <p><i>(Dok. 52-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative "GOOGLE APPS", portali KUB; Dok. 74- Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB; link, Stafit Akademik, link: <a href="https://kun.edu.al/fakulteti-FDSHP-së">https://kun.edu.al/fakulteti-FDSHP-së</a>;link, Hyrje në Portal, link:<a href="https://portal.kub.edu.al/hyrje/l">https://portal.kub.edu.al/hyrje/l</a>)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ evidenton se sistemi i menaxhimit të FDSHP dhe D MN siguron akses të dedikuar si për stafin, ashtu dhe për studentët, duke dhënë garancitë e nevojshme për transparencën brenda institucionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në mbështetje të detyrimeve që burojnë nga ligji respektiv në fuqi (Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale). Lidhur me informimin e studentëve, mbajtjen e të dhënave personale, dhe koordinimin e procesit mësimor apo aktivitete të tjera në funksion të tij, rol të rëndësishëm luajnë si sekretaria mësimore e fakultetit, si dhe në mënyrë virtuale përmes ëeb-it, mail, zonës së studentit në ëeb-site, si dhe në përdorimin e sistemit elektronik. Platformat Google Classroom, Zoom-Meet, përdoren si një mjet komunikimi i brendshëm për stafin akademik, studentët dhe stafit ndihmës akademik. Në ndihmë të të gjithë studentëve, pedagogëve dhe personelit akademik në lidhje me informacione dhe module në rrugë elektronike shërben dhe Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar, e Bibliotekës, versionet elektronike të Amzës, të Performancës, të Diplomimeve etj.</p> <p><i>(Dok. 53-Rregullore "Për procedurën e mësimdhënies online, në Kolegjin Universitar të Biznesit (KUB), në kushte situatë të jashtëzakonshme dhe fatkeqësie natyrore"; Dok. 74-Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB; Link 34, Manual mësimdhënie online, Staf/Student, link: <a href="https://drive.google.com/file/d/ICPqIzYEcHsZro6MVG-isYdrARLjgUMFN/vieë">https://drive.google.com/file/d/ICPqIzYEcHsZro6MVG-isYdrARLjgUMFN/vieë</a> )</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna</p>	<p>GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit e mundëson aksesin nëpërmjet në Portalit dhe llogarive personale të stafit dhe studentëve për Program BMN (emër.mbiemër@kub.edu.al) duke mundësuar komunikim interaktiv që aksesohet te "zona e studentit" e organizuar nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit. Ky sistem lehtëson komunikimin e drejtpërdrejtë me notat, kalueshmërinë, kurset e regjistruara, orarin, mungesat, provimet etj. Në këtë portal studenti</p>




<p>në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>regjistron online lëndët në ditën dhe orarin. Komunikimi përmes portalit apo formave alternative të vendosura në dispozicion nga KUB bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statusin e KUB, rregulloren e brendshme dhe Kodin e Etikës.</p> <p><i>(Dok. 74-Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB; Dok.96-Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom; Dok. 97-Rregullore për përdorimin e Vieosurvejimit në KUB)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstaton se sistemi i brendshëm siguron dhe garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrative. Në kohë reale dhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit, Faqja zyrtare e KUB-it <a href="http://kub.edu.al">http://kub.edu.al</a> në dy gjuhë (shqipe dhe angleze), në monitorimin e KUB, është një platformë që mundëson e garanton menaxhimin e monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, faqes zyrtare të KUB dhe FDSHPJ, garantohet aktiviteti akademik dhe administrativ. Sistemi mundëson raportime dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët e institucionit si Dekani i Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike, Zv. Dekanët e Fakultetit SHPJ, Sektorin e Teknologjisë dhe Informacionit në KUB, Rektoratin e organet e tjera drejtuese në të, Statuti, Rregullore e Përgjithshme e KUB, Raporti vjetor i institucionit për veprimtarinë akademike e financiare, Plani Strategjik i KUB, Përmbledhje e Raportit vjetor të NJSBC, Raporti i Auditimit të Jashtëm të Pasqyrave Financiare vjetore të KUB, Relacion financiar, Guida e studentit etj., pra gjithçka që lidhet me informimin në kohë dhe transparencën e institucionit, stafit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve, programet mësimore etj. Nëpërmjet Platformës mund të merren të dhëna mbi funksionin, dokumentacionin e zyrave/strukturave të ndryshme, përpunohen dhe reflektohen në raporte të ndryshme që hartohen për autoritetet dhe organet më të larta drejtuese të fakultetit, universitetit, apo dhe raportime institucionale.</p> <p><i>(Link 36, Guida studentore KUB, <a href="https://kub.edu.al/ep-content/uploads/2021/03/Guida_studentore_-2020-2021.pdf">https://kub.edu.al/ep-content/uploads/2021/03/Guida_studentore_-2020-2021.pdf</a>; link 37, Publikime njoftime: <a href="https://kub.edu.al/lajme/njoftim-per-vitin-e-ri-akademik/">https://kub.edu.al/lajme/njoftim-per-vitin-e-ri-akademik/</a>)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga kontaktet me studentët dhe takimet me personelin akademik të DMN në FDSHP rezultoi se informacionet që lidhen me programin e studimit BMN, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme mësimore dhe ekstrakurrikulare, të</i></p>

	<p>organizuar në këtë departament, aktet e brendshme rregullatore etj., janë të publikuara në faqen e internetit të KUB dhe rrjetet sociale të FDSHP dhe BMN. Materialet e publikuara janë të plota dhe përcjellin informacion të bollshëm mbi aktivitetin e KUB dhe FDSHP, të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit dhe ofrohen në gjuhën shqipe, si gjuha kryesore dhe gjuhën angleze në rubrika të caktuara.</p> <p>Synimi KUB është: Informimi dhe ndërgjegjësimi për punën dhe arritjet e KUB-it.</p> <p>Të krijojë imazhin e KUB-së (dhe forcojë atë) si një institucion serioz, partner i besueshëm për institucionet akademike në vend dhe më gjerë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga buxheti i KUB, ku pasqyrohen dhe të ardhurat e shpenzimet për çdo njësi kryesore dhe bazë të tij në Planin Buxhetor Vjetor dhe afatmesëm (3-vjeçar), në të cilat FDSHP i akordohet buxheti i tij në raport me nevojat. KUB në bashkëpunim me Fakultetin dhe departamentet pjesë e tij mbi bazën e nevojave të tyre harton çdo vit akademik planbuxhetin e tij në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit që ai ofron. Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi bazë, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, me qëllim arritjen e objektivave strategjike, si dhe realizimin e misionit të saj.</p> <p><i>(Dok. 58-Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022; Dok. 47-Relacion për Realizimin e Buxhetit 2022 dhe Planifikimi 2023 KUB; Dok. 57- Vendim BA për mbështetjen financiare për Kërkimin Shkencor të stafit akademik KUB)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, si dhe bëhet një vlerësim i ecurisë dhe</p>

<p>e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standartet e vendosura. Në to përfshihen kostot për çdo program studimi, e cila ndryshon nga një program në tjetrin. Burimet financiare në institucion hartohen duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore në KUB, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse në shpërndarjen e tyre. KUB në hartimin e planit financiar përfshin financime në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kualifikimin e stafit akademik nëpërmjet trajnimeve brenda dhe jashtë vendit;</li> <li>- Përmirësimi cilësor i laboratorëve shkencore, me aparatura, programe, mjete teknologjike të domosdoshme për procesin mësimorë-kërkimor;</li> <li>- Trajtim ekonomik të stafit në shërbim të realizimit të programeve; *Shërbime për Bibliotekën dhe Abonimin në revista shkencore dhe biblioteka online;</li> <li>- Përmirësimi i kushteve higjiëno-sanitare;</li> <li>- Rritja e konkurueshmërisë së stafit akademik nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte, konferenca/kongrese kombëtare/ndërkombëtare;</li> </ul> <p><i>(Dok. 47-Relacion për Realizimin e Buxhetit 2022 dhe Planifikimi 2023 KUB; Dok. 98-Pjesëmarrja e stafit në projekte; Dok. 99-Trajnimet e stafit të FDSHP; Dok. 100-Leja e MD që autorizon KUB për realizimin e Trajnimit të detyrueshëm në NPP; Dok. 101-Program trajnimi për Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme &amp; çertifikatë; Dok. 116- Tabela 18-Të ardhurat dhe financimet e ndryshmenë 3 (tre) vitet e fundit)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Referuar RVB KUB kryen një auditim (kontroll të brendshëm) të përvitshëm të brendshëm e të jashtëm mbi situatën financiare me persona të specializuar. Në nivel të brendshëm KUB ka ngritur dhe strukturën e tij Zyrën e Programimit dhe Raportimit Financiar, e cila punon me Program Informatik Kontabiliteti duke funksionuar në bazë të zbatimit të rregullave për dokumentimin dhe plotësimin e kërkesave ligjore harton dhe zbaton Planin strategjik dhe Vjetor të përcaktuar sipas saj. Kjo strukturë është në varësi të Bordit të Administrimit, i cili monitoron funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit nëpërmjet auditimit të brendshëm. Auditimi me natyrë financiare dhe fiskale në KUB kryhet dhe nga ana e strukturave shtetërore të Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe bazës dokumentare për shpenzimet, të ardhurat dhe rezultatet financiare në KUB. Auditimi i pasqyrave financiare në KUB prej disa vitesh kryhet</p>



	<p>nga një Kompani Ndërkombëtare e Auditimit “Grant Thornton”. Të gjitha raportet financiare të paraqitura në kuadër të programit të transparencës pasqyrohen në faqen zyrtare të KUB dhe përmbajnë tabelat mbi të ardhurat dhe ndarjen e burimeve financiare të detajuara, institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimit. Financimi dhe të ardhurat për FDSHP janë pjesë e informacionit dhe të dhënave financiare të KUB. Veprimtaria audituese është e strukturuar në bazë të Ligjit Nr. 10318, datë 16.09.2010 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.</p> <p><i>(Dok. 1-Statuti i KUB, nenet 37,38,39,40 për aktivitetin financiar; Dok. 4- Rregullore e KUB, nenet 25,26,27,28,29,36,37; Dok. 14-Rregullore e NJSBC (KUB), neni 3; Dok. 46-Raporti i NJSBC, Vitin Akademik 2022-2023; Dok. 58-Raporti Vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB 2021-2022, faqe 61-65; Dok. 58.1- Raport Grant Thornton mbi certifikimin e pasqyrave financiare vjetore, 2022)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVI konstaton se KUB ka të dokumentuar raportet financiare (Relacionin e PF dhe Raportin e auditimit financiar), për secilin vit akademik (për vitet e përfshira në akreditim) përmes auditimit të brendshëm, specialistit të pavarur të auditimit dhe si dhe auditimit të Pasqyrave Financiare nga Kompania Ndërkombëtare e Auditimit “Grant Thornton”. Institucioni IAL harton dhe zbaton Planin strategjik dhe të Auditimit të Brendshëm, duke ofruar përmes tij:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguri objektive dhe të pavarur, shërbime konsulence për vlerësimin dhe përmirësimin me efektivitet të proceseve të menaxhimit të riskut,</li> <li>• Planifikim të ndërhyrjeve të posaçme,</li> <li>• Diversifikime eventuale të financimit të programit të studimit, duke garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</li> </ul> <p>Veprimtaria audituese strukturohet në bazë të Ligjit Nr. 10318, datë 16.09.2010 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.</p> <p><i>(Dok. 13- Rregullore e Senatit Akademik të KUB, neni3; Dok. 58-Raporti vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB, 2021-2022, faqe 35; Dok. 58.1- Raport Grant Thornton mbi certifikimin e pasqyrave financiare vjetore, 2022; Dok. 47- Relacion për Realizimin e Buxhetit</i></p>




	<p><i>2022 dhe Planifikimi 2023, KUB; Dok. 62-Vendim SA dhe BA për miratimin e buxhetit 2022)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni dëshmon garanci mbi qëndrueshmërinë financiare për vijimin e aktivitetit akademik dhe kërkimor-shkencor të tij. Burimet e buxhetit të KUB krijohen nga burime të përcaktuara që realizohen në përputhje me rregullat ligjore të detyrueshme përgjithësisht entet publike duke ruajtur autonominë në përdorimin e të ardhurave.</p> <p>KUB financohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ardhurat nga tarifat e studentëve për arsimim;</li> <li>• Investimet e investitorëve;</li> <li>• Veprimtaria kërkimore-shkencore;</li> <li>• Trajnime, kualifikimet (OJF) dhe Projekte lokale, rajonale; kombëtare e ndërkombëtare;</li> </ul> <p>Të gjitha të ardhurat e krijuara nga KUB përdoren prej tij dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës akademik.</p> <p><i>(Dok. 58-Raporti vjetor i Veprimtarisë Akademike dhe Financiare të KUB, 2021-2022, faqe 61; Dok. 22-Raport i Përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerët për Programe e Projekte në kuadër të Erasmus+; Dok. 69- Raporti Vjetor i Punës Kërkimore Shkencore dhe Projektet KUB; Dok. 102- Relacion për Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare që janë zhvilluar në KUB përgjatë viteve akademike 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023; Dok. 23- Rankimi i universiteteve për punën shkencore, 2022; Dok. 47- Relacion për Realizimin e Buxhetit 2022 dhe Planifikimi 2023, KUB)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>- Në buxhetin e KUB, pasqyrohen dhe të ardhurat e shpenzimet për çdo njësi kryesore dhe bazë të tij në Planin Buxhetor Vjetor dhe afatmesëm (3-vjeçar), në të cilat FDSHP i akordohet buxheti i tij në raport me nevojat. KUB në bashkëpunim me Fakultetin dhe departamentet pjesë e tij mbi bazën e nevojave të tyre harton çdo vit akademik planbuxhetin e tij në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit që ai ofron. Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi bazë, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, me qëllim arritjen e objektivave strategjike, si dhe realizimin e misionit të saj.</p> <p>- Institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, si dhe bëhet një vlerësim i ecurisë dhe</p>

	<p>vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihen kostot për çdo program studimi, e cila ndryshon nga një program në tjetrin. Burimet financiare në institucion hartohen duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore në KUB, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse në shpërndarjen e tyre.</p> <p>- KUB kryen një auditim të përvitshëm të brendshëm e të jashtëm mbi situatën financiare. Në nivel të brendshëm KUB ka ngritur dhe strukturën e tij për auditimin e brendshëm, duke monitoruar funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.</p> <p>- KUB ka të dokumentuar raportet financiare, për secilin vit akademik (për vitet në akreditim) duke i pasqyruar për transparencë dhe në faqen zyrtare të tij.</p> <p>- Institucioni dëshmon garanci mbi qëndrueshmërinë financiare për vijimin e aktivitetit akademik dhe kërkimor-shkencor të tij. Burimet e buxhetit të KUB krijohen nga burime të përcaktuara që realizohen në përputhje me rregullat ligjore të detyrueshme përgjithësisht entet publike duke ruajtur autonominë në përdorimin e të ardhurave.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika</b>	GVJ konstaton se pranimi i studentëve në Programi i Ciklit të Parë (bachelor) në Marrëdhënie Ndërkombëtare në FDSHP,

<p>dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>realizohet bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe udhëzimet e përvitshme të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në kriteret e parashikuara në Rregulloren e KUB, si dhe në kriteret dhe kuotat e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga Senati Akademik i KUB. Ai garanton të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët që aplikojnë, si dhe për studentët e këtij programi studimit. Të drejtat dhe detyrat e studentëve parashikohen në Statutin e KUB. KUB harton dhe zbaton politika të bazuara në dispozitat e Ligjit 80/2015, të cilat mbulojnë procesin e zhvillimit akademik të studentëve nga momenti i hyrjes në fakultet deri në diplomim.</p> <p><i>(Dok. 4- Rregullore e KUB, kreu IX, nenet 56-77; Kreu X, nenet 78-83, Kreu XI nenet 84-94; Dok. 104-Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024, Dok. 105-Guida studentore KUB viti akademik 2023-2024)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si dhe nga evidencat e paraqitura, rezulton se programi i studimit të Ciklit të parë B MN është hartuar dhe zbatuar duke u mbështetur në lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe të studentëve bazuar në legjislacionin në fuqi. Për kandidatët e interesuar për vijimësi të programeve të studimit, si dhe për studentët që ndjekin BMN procedurat dhe politikat e ndjekura nga hyrja në dalje të studentëve garantojnë barazinë, gjë e cila pasqyrohet në të gjitha aktet rregullatore të KUB. Kuotat dhe kriteret e pranimit miratohen sipas procedurave ligjore dhe ato janë të shpallura publikisht e janë të aksesueshme nga të gjithë. Informacioni publikohet në faqen zyrtare të KUB dhe të FDSHP (rrjetet sociale). E gjithë procedura bazohet në Statutin e KUB, Rregulloren e Studimeve në KUB, Rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Politike dhe Rregulloren e NJSBC në KUB (Neni 5).</p> <p><i>(Dok. 4-Rregullore e KUB, Kreu XII, neni 93-100, Kreu XIII neni 101-102, Kreu XIV neni 103-111; Dok. 64-Rregullore për zhvillimin e provimeve nenet 3-6; Dok. 105-Guida studentore KUB, viti akademik 2023-2024)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se përzgjedhja e kandidatëve për programin e studimit BMN është kryer nëpërmjet aplikimit të kandidatëve që kanë shfaqur interes, mbështetur në kriteret e vendosura dhe brenda afatit të përcaktuar. Kriteret miratohen me vendim të Senatit akademik të KUB dhe publikohen në Website-in zyrtar të KUB. Kriteret vihen në dispozicion të strukturave të ngritura për zbatimin e maturës shtetërore sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.</p>

<p>bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, KUB vë në dispozicion informacionin e nevojshëm për: studentët lidhur me pranimin e tyre, mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, vlefshmërinë e diplomës së lëshuar, si dhe mundësinë e transferimit të krediteve etj. Kub angazhon potencialisht dhe Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës e cila bashkëpunon me strukturat e drejtorive vendore arsimore për të promovuar përpara maturantëve në vend hapësirat që ofrojnë programet e studimit dhe prioritetet e ndjekjes së studimeve në këtë IAL private. Renditja e kandidatëve fitues për programin e studimit BMN bëhet nga Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe FDSHP përmes shpalljes së listës përpara fillimit të vitit akademik e procesit mësimor.</p> <p><i>(Dok. 4-Rregullore e KUB, Kreu XII, neni 70; Dok. 7-Rregullore e programit të studimit nenet 4-7 dhe 12-26; Dok. 104-Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024, Dok. 106-Vendim i BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit të studentëve 2022-2023; Dok. 106.1-Propozimi i kuotave në MAS 2022-2023; 106.2-Propozimi i kuotave në MAS 2023-2024; Dok. 106.3 Miratimi i kuotave në MAS 2022-2023; link 38 Faqja website zyrtar i KUB, link: <a href="https://kub.edu.al">https://kub.edu.al</a>; link 39-Kriteret e pranimit, link: <a href="https://kub.edu.al/pranime/#tarifat-dhe-transferimet">https://kub.edu.al/pranime/#tarifat-dhe-transferimet</a>),</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstaton se objektivat e programit të ciklit të parë të studimit B MN janë të përcaktuara qartë dhe të hartuara mbi bazën e objektivave institucionale. Kriteret, procedurat e pranimit, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit, por edhe struktura e vitit akademik përcaktohen në Rregulloren FDSHP dhe rregulloren e programit të studimit që janë të kuptueshme për publikun. Dosja e programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare iu përmbahet akteve si: Rregullore e Përgjithshme e KUB-së, Rregulloren e Fakultetit, në të cilat përcaktohen shumë qartë kriteret e përditësuara të pranimit të studentëve në programin e ciklit të parë të studimit Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe ato të transferimit në përputhje me udhëzimet e MAS dhe në versionin on-line në faqen: <a href="https://kub.edu.al">https://kub.edu.al</a> në rrjetet sociale që përdoren në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Politike dhe në Departamentin e MN. Në lidhje njohjen dhe ekuivalentimin e studimeve, për transferimin e studimeve apo të programeve të dyta mblidhet Komisioni për Ekuivalentimin e studimeve, i cili vendos dhe përcakton në detaje lëndët apo modulet e njohura dhe kreditet në mbështetje me kurikulën e</p>

	<p>këtij programi studimi. Vendimi i marrë protokollohet dhe i paraqitet studentin për të shlyer apo jo disiplinat apo modulet të cilat nuk i janë njohur. Vendimi i përcillet dhe sekretarisë së fakultetit për plotësimin e dosjes dhe Regjistrin e Performancës dhe ndjekjen e shlyrjes së detyrimeve.</p> <p><i>(link 38 Faqja web zyrtare e KUB, link: <a href="https://kub.edu.al">https://kub.edu.al</a>; 39-Kriteret e pranimit, link: <a href="https://kub.edu.al/pranime/#tarifat-dhe-transferimet">https://kub.edu.al/pranime/#tarifat-dhe-transferimet</a>; Dok. 4-Rregullore e KUB, nenet 74-76; Dok. 39-Rregullore për Ekuivalentimin e Studimeve, nenet 4-5; Dok. 107-Formulari i vlerësimit të vazhduar_TIP; Dok. 108-Procesverbali i provimit përfundimtar_TIP)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Fakulteti i Shkencave Politike, propozojnë kuotat e pranimit, kriteret e pranimit e të përzgjedhjes se aplikantëve fitues jo më vonë se data e përcaktuar, në bashkëpunim me zyrat përkatëse të KUB-së. Kjo realizohet në çdo fillim viti, përmes nxjerrjes së udhëzimeve, reklamave televizive, radiofonike, pjesëmarrjes në evente dhe panairë, publikimeve në gazeta&amp; revista, postera, prezantime dhe guidave për të interesuarit, gjithmonë bazuar në kriteret që duhet të plotësojnë për ndjekjen e këtij programi studimit. Një procedurë e tillë bëhet në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Kriteret i përcillen rektoratit, i cili më pas ia përcjell MAS. Të gjitha të dhënat më pas bëhen publike në faqen zyrtare KUB dhe rrjeteve të ndryshme sociale në FDSHP dhe në Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.</p> <p><i>(Dok. 105-Guida studentore KUB, viti akademik 2023-2024; Dok. 7-Rregullore e programit të studimit nenet 4-7 dhe 12-26; Dok. 104-Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024; Dok. 57-Vendimi i BA për mbështetje financiare për Kërkimin Shkencor të stafit akademik KUB; link 40-Panairi Work and study: <a href="https://kub.edu.al/panairi-work-study-3/">https://kub.edu.al/panairi-work-study-3/</a>; link 41-Gazeta Panorama: <a href="https://www.panorama.com.al/përvoja-e-kolegjit-universitar-te-biznesit-kub-ne-trajnimin-e-studentëve-të-vitit-të-parë/">https://www.panorama.com.al/përvoja-e-kolegjit-universitar-te-biznesit-kub-ne-trajnimin-e-studentëve-të-vitit-të-parë/</a> ; link 42-Revista Psikologjia, link 43-Fletëpalosje, link 44-Prezantim)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstaton se përzgjedhja e kandidatëve për këtë program studimit është kryer nëpërmjet aplikimit nga kandidatët që kanë shfaqur interes, mbështetur në kriteret e vendosura dhe brenda afatit të përcaktuar. Në çdo fillim viti akademik, KUB vë në dispozicion informacionin e</p>




<p>veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>nevojshëm për studentët lidhur me pranimin e tyre, mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, vlefshmërinë e diplomës, mundësitë për transferime kreditesh etj. Në përputhje me standardet e kërkuara nga legjislacioni për arsimin e lartë në RSH, aktet e brendshme rregullatore të KUB-së, mundësitë reale të njësisë për një mësim normal dhe në bazë të kuotave të miratuara nga Senati Akademik për një vit akademik kryhet dhe numri i pranimeve. KUB ndjek një politikë jo diskriminuese në kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe të shtresave të marginalizuara, mbështetur dhe në rregullore, të cilat lehtësojnë përfshirjen e tyre në procesin mësimor dhe më tej.</p> <p><i>(Dok. 106-Vendimi i BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit të studentëve 2022-2023; Dok. 105-Guida studentore KUB, viti akademik 2023-2024)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>KUB propozon çdo vit akademik kuotat dhe kriteret për përzgjedhjen dhe pranimin së aplikantëve fitues dhe nga shtetet e tjera të rajonit. Në lidhje me këto kuota të caktuara kriteret janë të njëjta si edhe për aplikantët studentë shqiptar.</p> <p><i>(Dok. 106.1-Propozimi i kuotave në MAS 2022-2023; 106.2-Propozimi i kuotave në MAS 2023-2024)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga informacioni i paraqitur nga RVB, evidentohet se Kolegji Universitar i Biznesit mbështetet në një sistem të mirorganizuar të bursave dhe gjysëmbursave e tarifave të reduktuara për studentët ekselentë, si dhe për kriteret e përcaktuara për shtresat në nevojë, dhe studentët me aftësi të kufizuar.</p> <p><i>(Dok. 109-Lista e miratimit të studentëve të cilët përfitojnë bursa për vitin akademik 2022-2023; Dok. 106-Vendimi i BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit të studentëve 2022-2023)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p>- Pranimi i studentëve në Programin bachelor në MN në FDSHP, realizohet bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe udhëzimeve të përvitshme të MAS, në kriteret e parashikuara në Rregulloren e KUB., dhe kuotat e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara në Senatin Akademik. Ky program studimi mbështetet në lirinë akademike, në të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe të studentëve sipas legjislacionit në fuqi.</p>

	- KUB mbështetet në një sistem të mirorganizuar të bursave, gjysmëbursave dhe reduktimit të tarifave për studentët ekselentë dhe kriterëve të përcaktuara për shtresat në nevojë, dhe studentët me aftësi të kufizuar.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Nga vizita në institucion rezultojnë se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike, DMN së bashku me strukturat ndihmëse, sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe sekretarinë e fakultetit, ofron informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe ecurisë së kalimit nga një vit në tjetrin. Ky informacion gjendet i pasqyruar në Rregulloren e KUB, Rregulloren e Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike në Rregulloren e Sekretarisë në FDSHP.</p> <p><i>(Link 45-Portali i sekretarisë, link: <a href="https://sites.google.com/a/uab.edu.al/sekretaria/?pli=1">https://sites.google.com/a/uab.edu.al/sekretaria/?pli=1</a> ; Dok.4-Rregullore e KUB, neni 101; Dok. 7 –Rregullore e Programit të Studimit, neni 3; Dok. 105-Guida studentore KUB, viti akademik 2023-2024; ; Dok. 104-Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024, Dok. 106-Vendimi i BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit të studentëve 2022-2023)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	<p>Në bazë të evidencave të paraqitura, rezultojnë që ekziston një procedurë e lidhur me kriteret dhe procedurat e transferimit të studentëve dhe ekuivalentimeve të mundshme pas transferimit. I gjithë informacioni gjendet në Statutin dhe Rregulloren e KUB, Rregulloren për Njohjen dhe Ekuivalentimin e Studimeve për Transferimet, Programet e dyta apo kualifikimet e kryera më parë nëpërmjet Komisionit të Ekuivalentimit të Studimeve. Duke u mbështetur në dokumentet ligjore, Departamenti i Marëdhënieve Ndërkombëtare disponon një procedurë transparente dhe të rregullt në njohjen e studimeve të mëparshme. KUB dhe</p>



	<p>Fakulteti i DSHP, gjithashtu, përmes sekretarisë dhe zyrave të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, sistemit të menaxhimit të informacionit, vë në dispozicion informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret dhe procedurat në lidhje me kualifikime të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Kriteret specifike publikohen në udhëzues të veçantë.</p> <p><b>(faqja zyrtare të KUB)</b></p> <p><b><i>Dok. 48-Rregullore për Ekuivalentimin e Studimeve, neni 3; Dok. 48.2-Model TIP për Vendimin e Komisionit të Ekuivalentimit)</i></b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni informon studentët në mënyrë të detajuar lidhur me të gjithë elementët dhe procedurat e vlerësimit të tyre në çdo disiplinë si nga ana e personelit akademik përkatës ashtu dhe nga ana e koordinatorit të programit të studimit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Informacionin e duhur e të plotë ata mund ta marrin edhe nga Rregulloret: të KUB, FDSHP, DMN-të programit të studimit, rregulloren e Provimeve, Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, apo syllabus-et e disiplinave që gjenden në faqen web të KUB-it. Studentët informohen në afatet e duhura në ambiente publike lidhur me kohën dhe oraret e provimeve. Për të vlerësuar studentin me pikë, përdoren kryesisht aktivizimi dhe frekuentimi në auditor, testimi me shkrim apo me gojë. Pikët konvertohen me notë mbi bazën e intervaleve të përcaktuara në syllabus-et e lëndëve. Studentit i jepet mundësia të njihet me testin që ka shkruar, me pikët e çdo elementi në vlerësim, por gjithashtu ka dhe të drejtën e ankimit në rast se lind nevoja në afatet e dhëna kohore dhe në mënyrën e përcaktuar në Rregullore.</p> <p><b><i>(Dok.7-Rregullore e Programit të Studimit MN, neni 11; Dok. 107-Formular i vlerësimit të vazhduar TIP; Dok. 108-Procesverbal i provimit përfundimtar TIP; Dok. 32.7-Model Syllabus, elementët sipas VKM Nr. 41/2018)</i></b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rezulton që studentët e vitit të tretë të programit të studimit BMN, informohen që në fillim të vitit akademik dhe gjatë tij, nga koordinatori i programit të studimit, nga drejtuesi i departamentit dhe sekretaria mësimore për rregullat dhe programin e diplomimit, sipas një pakete udhëzuese të miratuar nga SA. Informacioni merret dhe nëpërmjet Statutit dhe Rregullores së KUB, Rregullores së FDSHP, Rregullores së Programit të Studimit si dhe ekzistuese është dhe Rregullorja e diplomimit. Informacioni i përcjellë përmes këtyre hallkave (në rrugë online-websiti i KUB, social media dhe në portalin e sekretarisë mësimore) institucionale i</p>




	<p>informon studentët rreth procedurës së detyrimeve përmbyllëse të parashikuar, sipas mesatares së përcaktuar.</p> <p><i>(Dok. 36.2 Udhëzues për përgatitjen e diplomës; Dok. 4-Rregullore e KUB, Kreu XIV; Dok. 7-Rregullore e Programit të Studimit MN, neni 81)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni në rang universiteti, por edhe njësi kryesore dhe në ato bazë, publikon udhëzues të posaçëm, si broshura dhe fletëpalosje mbi kriteret e pranimit, procedurat, dokumentet e nevojshme, stafin akademik, tarifatat dhe informacione në lidhje me programet e studimit të ofruara nga KUB dhe veçanërisht ato të ofruara nga FDSHP. Pra universiteti organizon përpara fillimit të çdo viti akademik një fushatë informimi dhe mbi mundësitë për rritje në karrierë. Në lidhje me realizimin e një procesi të tillë ngrihet një grup pune me përfaqësues të fakulteteve të KUB, në kuadër të një fushate marketingu përmes së cilës FDSHP dhe DMN, dhe KUB sigurojnë informacione udhëzuese mbi atë çka i ofron studentëve ndjekja e e këtij programi studimit, në përputhje dhe me kërkesat e tregut të punës. Puna e departamentit në këtë aspekt është e lidhur ngushtësisht dhe në bashkëpunimin me kategoritë e institucioneve të interesuara gjatë dhe pas ndërmarrjes nga ana institucionale të fushatës së marketingut. Të gjitha këto bëhen publike dhe pasqyrohen me transparencë për të gjithë studentët e interesuar dhe për publikun.</p> <p><i>(Dok. 7-Rregullore e Programit të Studimit MN, neni 81; Dok. 105-Guida studentore KUB, viti akademik 2023-2024; ; Dok. 104-Fletë palosje informative për vitin akademik 2023-2024; Dok. 106-Vendimi i BA për miratimin e ofertës akademike, financiare dhe programet e pranimit të studentëve 2022-2023; Dok. 110 Programi i panairit Work and Study; link 46-Paketë udhëzuese diplomimi; Link 47-Konferenca Shkencore Ndërkombëtare, Link 48-Konferenca Shkencore Kombëtare, Link 49-Leksione të hapura; link 50-Trajnime&amp;Konkurse)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga vizita në institucion rezulton se FDSHP, DMN së bashku me strukturat ndihmëse, sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe sekretarinë e masterit, ofron informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe ecurisë së kalimit nga një vit në tjetrin. Evidencat e paraqitura tregojnë ekzistencën e një procedure sipas kriteret dhe procedurat e transferimit të studentëve dhe ekuivalentimeve të mundshme pas transferimit. Institucioni informon studentët në mënyrë të detajuar lidhur</i></p>


	me të gjithë elementët dhe procedurw të vlerësimit të tyre në çdo disiplinë. Rezulton që studentët e vitit të tretë të programit të studimit BMN, informohen nga koordinatori i programit të studimit, drejtuesi i departamentit dhe sekretaria mësimor në fillim të vitit akademik dhe gjatë tij, për rregullat dhe programin e diplomimit, por dhe përmes aksesit të faqes zyrtare të KUB.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Rezulton që studentët informohen në mënyrë transparente dhe publike përmes web-it zyrtar të KUB-it lidhur me programet e studimit, organizimin, kohëzgjatjen e tyre dhe organizgramën e strukturën e tij. Gjithashtu studentët informohen që në javën e parë të vitit akademik në javën orientuese në mënyrë të hollësishme lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Këtë informacion e marrin dhe në vijim nga ana e Koordinatorit të programit të studimit, nga zyra e Këshillimit dhe Karrierës dhe nga stafi akademik pjesë e DMN dhe më konkretisht e programit të studimit BMN. Informacionin mund ta aksesojnë dhe përmes faqes web të KUB, FDSHP, DMN, në të cilat mund të njihen gjithashtu dhe për infrastrukturën e ambienteve dhe shërbimet që merren prej tyre. Në mbështetje të studentëve për informacion shërben dhe Sekretaria mësimore (Sekretaria e Fakultetit) dhe dega e IT në FDSHP. GVJ konstatoi nga biseda me ta, që studentët ishin të informuar mbi këto elemente. Këto informacione, por më të detajuara janë të pasqyruara dhe në Rregulloren e Fakultetit të DSHP, si dhe përmes prezantimeve nga ana e Dekanatit dhe drejtuesve të njëjësive bazë në të.</p> <p><i>(Dok.11-Urdhët Nr. 57, datë 16.11.2012 i MASH, Për akreditimin institucional të KUB; Dok. 112-Certifikatë Akreditimi KUB; Dok. 113-Vendimi Nr. 100, datë 10.11.2017 dhe vitit 2022 të BA, Për riakreditimin institucional të KUB; Link 51-Organigrama: <a href="https://kub.edu.al/organigrama/">https://kub.edu.al/organigrama/</a>; Link 52-Kohëzgjatja dhe kreditet:</i></p>

	<p><a href="https://kub.edu.al/fakulteti-FDSHP/">https://kub.edu.al/fakulteti-FDSHP/</a> ; <b>Link 53-Liçensimi:</b>  <a href="https://kub.edu.al/rreth-nesh/#misioni">https://kub.edu.al/rreth-nesh/#misioni</a> )</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi evidencave, GVJ konstaton se departamentit në çdo fillimviti/semestri me anë të pedagogëve të departamentit jep informacion në lidhje me lëndët/modulet, kreditet, syllabuset e përcaktuara në planin mësimor të programit të studimit BMN, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, vlerësimin etj. Syllabuset janë të vlefshëm për studentët në <i>hard copy</i> por edhe elektronikisht dhe përmbajnë literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar si dhe element të nevojshëm për lëndën dhe detyrimet akademike që lidhen me të. Gjithashtu Fakulteti i DSHP, nëpërmjet zyrave përkatëse, sistemit të menaxhimit të informacionit (webfaqet e pedagogëve dhe websit-it të KUB) dhe Sekretarisë së Fakultetit, ka vendosur në dispozicion të studentëve kurrikulat dhe gjithë informacionin e nevojshëm për programin e studimit si dhe veprimtaritë formuese që lidhen me të.</p> <p><i>(Dok. 32.1-Struktura Mësimore e programit të studimit bMN 2022-2023; Dok. 32.2-Kurikula e programit të studimit BMN 2021-2023; Dok. 32.3-Planet mësimore të programit të studimit BMN 2021-2023; Dok. 32.4-Syllabuset e Lëndëve/Moduleve 2021-2024; Dok. 105-Guida studentore KUB, viti akademik 2023-2024;Dok. 52-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative “GOOGLE APPS”, portali KUB)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se studentëve me qëllim motivimin personal dhe orientimin sa më të mirë në tregun e punës, u përcillet informacion periodik lidhur me mundësitë për trajnime, pjesëmarrje në programe shkëmbimi me studentë, mundësi intership-i dhe letër rekomandimi për mbështetje ndaj tyre etj., si dhe mundësimin e hedhjes së hapave të parë drejt punësimit dhe zhvillimit të karrierës profesionale. Kjo e fundit kryhet në sajë të bashkëpunimeve dhe partneriteteve në KUB. Departamenti ndjek politika në funksion të mbështetjes dhe orientimit të studentëve në këto aspekte, e cila zhvillohet sidomos gjatë javës së orientimit. Zyra e studentit dhe Këshillimit të Karrierës mbështet dhe realizon evidentimin e të dhënave të studentëve dhe gjurmimin e tyre në tregun e punës duke bashkëpunuar dhe ne Zyrën e Alumnit në KUB. Staf i Departamentit të MN dhe KUB orienton studentët dhe për mundësitë që u ofron tregu i punës, përmes pjesëmarrjes dhe në panairët e punës, me kompanitë dhe organizatat e studiove profesionale, zyrat kontabël studiot e shërbimeve informatike,</p>




	<p>sipërmarrjet e mesme e të mëdha vendas dhe të huaj në të cilat ata informohen mbi mundësitë e punësimeve. Informacione mbi mundësitë e punësimit publikohen dhe në faqen zyrtare të website të KUB si dhe në rrjetet sociale të departamentit.</p> <p><i>(Dok. 116- Tabela 1-Institucionet dhe Organizatat Bashkëpunuese; Dok. 9-Rregullore e ZSKK, nenet 7, 10; Dok. 42-Raporti vjetor i veprimtarisë të ZSKK 2022-2023; Link 54-Partnerët kombëtare dhe ndërkombëtarë: <a href="https://kub.edu.al/partneret">https://kub.edu.al/partneret</a> )</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se studentëve u vihet në dispozicion informacioni i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, përmes ditëve të orientimit, por edhe përmes udhërrëfyesit informative, mbi programet e studimit në FDSHP, fletëpalosjeve, informacionit on-line që publikohet ne website-in e KUB, FDSHP, DMN. Studentët njihen gjithashtu edhe me infrastrukturën dhe logjistikën e zhvillimit të programeve të studimit apo shërbime të tjera të nevojshme për realizimin e programit të studimit, të cilat janë të aksesueshme nga studentët</p> <p><i>(Dok. 80-Relacion mbi infrastrukturën e KUB; Dok. 91-Relacion i Bibliotekës së KUB; Dok. 116-Tabela 17-Të dhëna për Platformën online/Struktura e MN/Biblioteka online; Dok. 32.5-Model orari mësimor)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Përmes mënyrave të ndryshme përfshi dhe qasjen on-line, në webfaqen e KUB, të FDSHP, përcillen informacione të plota në lidhje me këtë program studimi, të cilat janë të aksesueshme jo vetëm nga ana e studentëve të FDSHP, por edhe nga ata në distancë, kjo e përcaktuar në Rregulloren e sekretarisë mësimore dhe Rregulloren e Fakultetit. Kjo mënyrë e të proceduarit mundëson një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit. Informacioni që përcillet edhe ai në distancë është lehtësisht i arritshëm dhe i ndihmon studentët që të informohen në kohën e duhur në lidhje me programin e studimit, por edhe mbi detyrimet akademik të tyre në tërësi. Informacioni i nevojshëm publikohet herë pas here, në udhëzues dhe faqen zyrtare të KUB-it. Kontakte me studentët kryhen si nga sekretaria mësimore ashtu edhe nga Drejtuesja e Departamentit në lidhje dhe me problematikat e ecurisë së procesit mësimor dhe me procedurat e diplomimit.</p>

	<i>(Dok. 52-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative "Google APPS", portali KUB)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p>- Rezulton që studentët informohen që në javën e parë të vitit akademik në javën orientuese në mënyrë të hollësishme lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Informacion të plotë marrin dhe në vijim nga ana e Koordinatorit të programit të studimit, nga ZKK dhe nga stafi akademik pjesë e DMN pjesë e programit të studimit BMN.</p> <p>- Studentëve me qëllim motivimin personal dhe orientimin sa më të mirë në tregun e punës, u përcillet informacion periodik lidhur me mundësitë për trajnime, pjesëmarrje në programe shkëmbimi me student, mundësi intership-i dhe letër rekomandimi për mbështetje ndaj tyre etj. Në dispozicion i vihet dhe informacioni i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Informacion i hollësishëm u përcillet studentëve dhe në qasjen on-line, në webfaqen e KUB, të FDSHP.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Gjithë baza e të dhënave dhe statistikat përkatëse lidhur me studentët deri në diplomim, administrohen nga Sekretaria Mësimore në FDSHP dhe Zyra e studentit dhe Këshillimit të Karrierës në të gjitha vitet e studimit. Në Sekretarinë mësimore dokumentacioni bazë konsiston në regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomës. Këto të dhëna arkivohen bazuar në ligjin mbi arkivimin e dokumentacionit zyrtar. Sekretaria mësimore administron të gjithë dokumentacionin për çdo student të regjistruar në këtë program studimit, të çregjistruar, të transferuar, të diplomuar, gjatë viteve akademike që nga brezi i parë i diplomimit në vitet 2021-2022. Mbështetur në të dhënat Aneks RVB-Tabelat përmbledhëse, BMN dhe vizitën në

	<p>institucion rezulton se numri i studentëve të regjistruar në tre vite akademike është:</p> <p>2021-2022: 4 studentë;</p> <p>2022-2023: 8 studentë;</p> <p>2023-2024: 1 student;</p> <p>Në total rezulton një numër në rënie studentësh që kanë kryer programin e ciklit të dytë të studimit BMN, gjithsej 13 studentë të diplomuar në vitet 2021-2024.</p> <p><b>Rekomandim:</b> <i>Shoh me vend të rekomandoj angazhimin më të madh dhe fushatë më efikase orientuese të stafit akademik të DMN dhe institucionit KUB në lidhje me rritjen përpjekjeve mbi përthithjen e një numri më të madh studentësh që duan të ndjekin këtë program studimit. Këtë e bazoj në faktin se prioriteti i politikave qeveritare në kuadrin e kthimit të vendit tone në një destinacion turisti shton dhe numrin e kërkesave për specialist të afirmuar të historisë. Rol të rëndësishëm në arritjen dhe garantimin e suksesshëm të punës në këtë program studimit luan dhe bashkërendimi dhe bashkëpunimi mes universitetesh në vend.</i></p> <p><i>(Dok. 116-Tabela 21-Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve) Dok. 116-Tabela 23-Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>KUB zotëron të dhëna për studentët lidhur me ecurinë e tyre sipas programeve të studimit. Sekretaria e FDSHP administron regjistrin themeltar të çdo studenti ku pasqyrohen në mënyrë të detajuar gjithë arritjet akademike të tij, në çdo vit duke respektuar dhe duke u bazuar në Rregulloren e KUB, Rregulloren e FDSHP. Sekretaria Mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të çregjistruar, mbi bazë të Rregullores së KUB. Këto të dhëna dërgohen brenda afateve të përcaktuara pranë drejtorisë së Statistikave në ministrinë e Arsimit, Sportit e Rinisë.</p> <p><i>(Dok. 116-Tabela 21-Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve; Dok. 116-Tabela 22-Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë në tre vitet e fundit)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të</p>	<p>Nga kontrolli në Sekretarinë e FDSHP, sekretarinë mësimore të KUB, të regjistrin themeltar, në regjistrin e rezultateve akademike të studentit, si dhe në Regjistrin e Diplomave, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve janë të pasqyruara në to. Të dhënat rezultojnë të pasqyruara dhe në</p>




<p>informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>databazat përkatëse. Sekretaria mësimore administron të dhënat e studentëve për programin e studimit. Informacioni ruhet në databazat e sekretarisë (sistemi i brendshëm). Vlerësimi i studentëve pasqyrohet në procesverbale, të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve. Studentët lehtësisht mund të njihen me vlerësimet për lëndë/module përmes aksesit të web-it të KUK kub.edu.al dhe adresave personale që ata kanë në këtë web.</p> <p><i>(Dok. 1-Statuti i KUB, nenet 76-78; Dok. 94-Regjistri i të dhënave të studentëve/AMZA; Dok. 95-Regjistri i rezultateve/persormancës së studentit)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se Kolegji Universitar “ I Biznesit” ka të përcaktuar me akte ligjore të gjithë funksionimin dhe mbajtjen e të dhënave statistikore mbi studentët në hyrje dhe në dalje. Institucioni kryen kontrollin periodik në të gjitha njësitet përgjegjëse për menaxhimin dhe ruajtjen e tyre. Gjithashtu KUB vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që ruhet dhe disponohet nga këto njësi përgjegjëse, në lidhje me studentët dhe veprimtarinë e tyre në institucion, fakultet dhe programe studimi. Mbajtja, menaxhimi dhe siguria e tyre është një kërkesë ligjore e normuar nga aktet rregullatore të universitetit.</p> <p><i>(Dok. 114-Procesverbal verifikimi të dhënash regjistër amze/arritje akademike)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ konstatoi se KUB harton raporte analitike (periodike) vjetore që plotësohen sipas një formati të përcaktuar nga rektorati. Përmes tij jepen të dhëna sasiore dhe cilësore që lidhen me veprimtarinë e departamenteve, performancën, të dhëna mbi studentët, aktivitetet dhe veprimtarinë shkencore, ngarkesën mësimore të pedagogëve, publikimet, bashkëpunimet dhe partneritetet, etj. Raporte punësimi kryhen dhe nga ana e ZSKK, e cila e realizon atë krahas kontakteve të vazhdueshme me studentët e diplomuar, ftimit të tyre për orientime, takime, trajnime dhe aktivitete brenda dhe jashtë institucionit. Dhe NSBC në KUB harton raporte periodike semestrale dhe vjetore në lidhje me studentët..</p> <p><i>Sugjerim: Në funksion të raporteve analitike mund të hartohen edhe analiza të tjera, p. sh., analiza e tregut të punës, etj. Përmes të dhënave të pasqyruara në raportet analitike kryhet dhe vlerësimi i performancës dhe identifikimi i nevojave, në</i></p>



	<p><i>funkcion të përmirësimit të punës dhe arritjeve në drejtim të realizimit të objektivave formues të programit të studimit. Kontaktet e vazhdueshme të Departamentit të DSHP dhe Zyrës e studentit dhe Këshillimit të Karrierës me studentët e diplomuar mundësojnë përpilimin e tabelave me të dhëna mbi cilësinë e punësimit.</i></p> <p><b>(Dok. 42- Raporti vjetor i veprimtarisë të ZSKK 2022-2023; Dok. 30-Raporti vjetor i veprimtarisë FDSHP 2022-2023)</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>- Gjithë baza e të dhënave dhe statistikat përkatëse lidhur me studentët deri në diplomim, administrohen nga KUB, Sekretaria e FDSHP dhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit dhe Karrierës në të gjitha vitet e studimit. Në total rezulton një numër në rënie studentësh që kanë kryer studimit e ciklit të dytë të studimit në BMN, gjithsej 13 studentë të regjistruar në vitet 2021-2024. Sekretaria e FDSHP administron regjistrin themeltar të çdo studenti, regjistrin e rezultateve akademike, si dhe Regjistrin e Diplomave të dhënat statistikore të studentëve ku pasqyrohen në mënyrë të detajuar gjithë arritjet akademike të tij, në çdo vit duke respektuar dhe duke u bazuar në Rregulloren e KUB, Rregulloren e FDSHP.</p> <p>- KUB, ZSKK hartojnë raporte analitike (periodike) vjetore që plotësohen sipas një formati të përcaktuar nga rektorati. Përmes tyre jepen të dhëna sasiore dhe cilësore që lidhen me veprimtarinë e departamentit, performancën, të dhëna mbi studentët, aktivitetet dhe veprimtarinë shkencore, ngarkesën mësimore të pedagogëve, publikimet, bashkëpunimet dhe partneritetet, etj.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të	Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, Rregullores dhe Statutit të KUB, studentët marrin pjesë në disa organe kolegjiale dhe vendimmarrëse sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Përfshirja dhe angazhimi i studentëve ose përfaqësuesve të tyre në

<p>tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore mbështetet në: Ligji 20/2015 “Për Arsimin e Lartë“, Statutin e KUB-së, Rregulloren e KUB. Ata janë anëtarë më të drejtë vote njësoj si personeli akademik. Përfaqësimi i tyre është në organe si Senati Akademik i KUB, Këshillin Studentor, Këshillit të Etikës NJSBC, Pjesë e RVB-ve.</p> <p><i>(Dok. 1-Statuti i KUB, neni 17, pika 2, neni 23 pika 2, neni 73 pika5; Dok. 9-Rregullore e ZSKK; Link 55-Zgjedhjet e Këshillit Studentor, Link 56-Takimi me Këshillin Studentor)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton se KUB garanton përfshirje të studentëve përmes përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, kryesisht në përfaqësimin e tyre në organe kolegjiale, në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe proceseve të tjera akademike, përmes pyetësorëve. Përpunimi dhe rezultatet e nxjerra nga këta pyetësor reflektohen në raportet vjetore të institucionit dhe në marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Përfshirja reale e studentëve përmes përfaqësimit studentor në forume apo organizime studentore synon përcjelljen e zërit të tyre në forumet e hallkat me të larta institucionale të KUB. Senati Akademik në KUB përbëhet nga 19 anëtarë, ku 1 prej tyre është student. Këto të drejta përfaqësimi përcaktohen qartësisht në Rregulloren e KUB si dhe në Rregulloren e FDSHP.</p> <p><i>(Dok. 45-Plani vjetor i NJSBC; Dok. 46- Raporti i NJSBC për vitin akademik 2022-2023; Dok. 59-Format pyetësori i studentëve KUB)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>KUB dhe Njësia kryesore FDSHP garanton përfshirjen e studentëve të Këshillit Studentor dhe grupit të studentëve që formojnë Alumnin në nivel institucional në takimet e organizuara në institucion, njësinë kryesore dhe në DMN përmes të cilave ata kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo ndryshimit të kurrikulës, të përmirësimit të programeve të studimit, të përmirësimit të performancës dhe cilësisë së programit, duke dhënë në këtë mënyrë kontributin e tyre me vlerë në të gjitha organet kolegjiale ku ata kanë të drejtë përfaqësimi. Si pjesë e rëndësishme e raporteve që hartohen nga NJSBC luajnë dhe merren dhe sugjerimet dhe kontributet e studentëve në nivel departamenti, në mënyrë të drejtpërdrejtë, për programet e studimit që ato ndjekin. Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare i nisur që në vitin akademik 2021-2022 e në vazhdim në kuadër të ecurisë dhe përmirësimit të programit të</p>

	<p>studimit, është parë nga ana e KUB-it, si një nga prioritetet e tij. Nisur nga një qëllim i tillë në KUB (NJSBC) janë përgatitur pyetësorë, lidhur me problematikat që janë shfaqur tek ato gjatë periudhës së studimit, të dhënat e mbledhura prej tyre janë marrë në konsideratë në punën e mëtejshme të departamentit për përmirësime në këtë drejtim.</p> <p><i>(Dok. 64-Raporti i NJSBC për vitin akademik 2023-2024; Dok. 59-Format pyetësori studentëve në KUB; Dok. 42-Raporti vjetor i veprimtarive të ZSKK 2022-2023)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogu/ët i/e lëndës dhe sekretaria e FDSHP mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, siç është vlerësimi i provimit të lëndës, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi/ese etj. Studentëve u mundësohet si një e drejtë e tyre njohja me: procedurën e zhvillimit të kontrollit të dijeve, tezën e provimit pas korrigjimit dhe mënyrën e vlerësimit (njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë) si dhe të drejtën e ankimit. Studenti ka të drejtë të ankohet për procedurën e zhvillimit të provimit dhe rezultatin e tij përfundimtar. Anketimi në lidhje me problematikat e shfaqura në këtë aspekt i kryer nga ana e departamentit me studentët, ka ndihmuar dhe dhënë mundësi që çdo pedagog përgjegjës për lëndën/modulin të reflektojë mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga anketimet.</p> <p><i>(Dok. 7-Rregullore e Programit të Studimit MN, neni 16; Dok. 64-Rregullore për zhvillimin e provimeve, neni 16)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>- Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Rregullores dhe Statutit të KUB, studentët marrin pjesë në disa organe kolegjiale si: Senati Akademik;; Njësia për sigurimin e standardeve dhe cilësisë, Komisioni i Etikës, etj., duke garantuar përfshirje të tyre përmes përfaqësuesve në vendimmarrje, kryesisht në përfaqësimin e tyre në organe kolegjiale, dhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies dhe proceseve të tjera akademike, përmes pyetësorëve. Njësia kryesore garanton përfshirjen e studentëve si pjesë e takimeve, përmes të cilave ata kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo ndryshimit të kurrikulës, të përmirësimit të programeve të studimit, të përmirësimit të performancës dhe cilësisë së programit, duke dhënë në këtë mënyrë kontributin e tyre me vlerë në to..</p> <p>- Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogu/ët i/e lëndës dhe sekretaria e FDSHP mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, siç është vlerësimi i</p>

	<i>provimit të lëndës, vlerësimi i aktivizimit në seminare, detyra kursi/ese etj.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Bazuar te dokumentacioni kryesor zyrtar ligjor të KUB, Rregullore KUB, nenet 78-84, Rregullore e FDSHP etj., funksionojnë disa njësi të posaçme me kompetenca të përcaktuara për informimin dhe mbështetjen e studentëve si: Rregullore e ZSKK, Njësia bazë, Koordinator i programit të studimit, koordinatori akademik, Këshilli studentor, Biblioteka e KUB (FDSHP), Sekretaria mësimore e fakultetit. Nga biseda e GVJ me studentët rezultoi që të gjitha këto njësi janë funksionale, ku secila prej tyre informon studentët brenda fushës së vet të kompetencës. Njësi përgjegjëse për informimin e studentëve në KUB është dhe ZSKK-ja.  <i>(Dok.4-Rregullore e KUB, nenet 78-84; Dok. 9-Rregullore e ZSKK; Dok. 92-Rregullore e Bibliotekës)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstaton se departamenti, ndihmon studentët që hasin vështirësi në përvetësimin e lëndëve/moduleve apo në plotësimin e detyrimeve të ndryshme akademike të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët, si dhe mbështetjen dhe konsultimin që ofrohet nga pedagogët e departamentit në lidhje me diplomimin në përfundim të këtij cikli përmes koordinorit dhe stafit akademik të tij. Në ndihmë në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë u ofrohet dhe nga ana e departamentit vëmendje dhe suport dhe nga ana e stafit ndihmës-akademik dhe administrativ, me qëllim lehtësimin dhe informimin në kohë. Njoftimet përkatëse dhe këshillimet e studentëve bëhen në fillim të çdo viti akademik nga: Zyra e SKK por dhe nëpërmjet Domain-name dhe domain e-mail, Portalit të KUB, Web page të KUB si dhe Platformave të tilla si Facebook, Instagram, LinkedIn etj., të cilat ruhen në bazë të ligjit të konfidencialitetit.

	<p><i>(Dok.52-Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative “GOOGLE APPS, portali KUB; Dok. 74-Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB; Dok.96-Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se Zyra e SKK, jep informacion të vlefshëm në lidhje me studentët në këtë program studimi, duke i informuar ata sa u përket institucioneve me të cilat fakulteti/departamenti ka marrëveshje, mundësi internshipi etj. Nëpërmjet kontakteve dhe takimeve të vazhdueshme, studentëve u ofrohet shërbimi i duhur në lidhje me programet e studimit, akreditimin e tyre, organizmin dhe kohëzgjatjen e studimeve, praktikën mësimore, mënyrën e zgjedhjes së temës dhe udhëheqësit shkencor të saj. Studentët asistohen për këtë qëllim dhe marrin informacionin e nevojshëm që i vlen atyre për t’u orientuar dhe projektuar më mirë tregun e punës. Zyra u ofron studentëve orientim në tregun e punës, në ndihmë të përgatitjes së CV-ve, letrave të interesit dhe përgatitjet për intervista pune. Ndërsa Sekretaria mësimore e Fakultetit disponon të gjithë materialin e nevojshëm në lidhje me studentin në hyrje e dalje. ZSKK disponon dhe dokumentin e performancës akademike të institucionit që përfshin dhe studentin duke qenë pjesë e kontratës së regjistrimit që nënshkruhet nga ana e studentit. Studenti për informacione të ndryshme ka domain e-mail dhe domain name të cilat janë personale.</p> <p><i>(Dok.9-Rregullore e ZSKK_KUB, neni 9;Dok. 66-Rregullore e Sekretarisë mësimore, neni 3;Dok. 105-Guida studentore KUB, viti akademik 2023-2024)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se ZSKK-ja mban lidhje me të gjithë të diplomuarit (në numër të kufizuar) në këtë program studimi BMN. Mbledhja e të dhënave për të diplomuarit në këtë program studimi nga ana e ZSKK-së është përfshirë dhe në një raport të fundit të tij. Gjurmimi i të diplomuarve në vite akademike (tre vite) është bërë në bazë të zbatimit të strategjisë së zhvillimit të KUB-it. Të dhënat bëhen pjesë e raporteve vjetore të KUB. ZSKK-ja përveç informacioneve që jep dhe vë në dispozicion të studentëve, është gjithmonë në kontakte me aktorë të ndryshëm biznesi apo kompani biznesi e Zyra Noterie për të krijuar hapësira për punësim të studentëve pas mbarimit të studimeve si dhe për të kryer praktikën mësimore gjatë periudhës së studimeve.</p> <p><i>(Dok. 42-Raporti vjetor i veprimtarive të ZSKK 2022-2023; Dok. 116-Tabela 5-Institucionet dhe Organizatat</i></p>




	<i>bashkëpunuese; Dok. 116—Tabela 23-Të dhënat për Diplomimin dhe Punësimin e Studentëve)</i>			
<b>Konkluzione</b>	- Bazuar te dokumentacioni kryesor zyrtar ligjor të KUB, Rregullore, Rregullore e FDSHP dhe Rregullore e ZSKK-së etj., funksionojnë disa njësi të posaçme me kompetenca të përcaktuara për informimin dhe mbështetjen e studentëve si: ZSKK, Njësia bazë, Koordinator i programit të studimit, Dega e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës, Këshilli studentor, Biblioteka e KUB (FDSHP), Sekretaria mësimore. Nga biseda e GVJ me studentët rezultoi që të gjitha këto njësi janë funksionale, ku secila prej tyre informon studentët brenda fushës së vet të kompetencës, ndihmë që konsiston në përvetësimin e lëndëve/moduleve, plotësimin e detyrimeve ndryshme akademike të programit të studimit, orëve të konsultimit me pedagogët dhe konsultime nga koordinatori dhe stafi akademik në lidhje me procesin e diplomimit. ZSKK, jep informacion të vlefshëm në lidhje me studentët në këtë program studimi, përsa i përket institucioneve me të cilat fakulteti/departamenti ka marrëveshje, mundësi internshipi etj. ZSKK mban lidhje dhe zotëron të dhëna kryesisht me një pjesë të të diplomuarve në këtë program studimi bazuar në zbatimin e strategjisë së zhvillimit të KUB.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	


## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për</b>	Mbështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton se Kolegji Universitar i Biznesit, ka jo vetëm në fokus të punës së tij zhvillimin dhe përdorimin e metodave të

<p>zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të nxënit, duke nxitur mendimin krijues e kritik të studentit duke përforur formën interaktive me në qendër studentin, si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme. Në realizimin e këtyre qëllimeve rëndësi iu kushtohet metodave dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies mbështetur në Rregulloren e Statusin e KUB-it, Rregulloren e FDSHP, Rregulloren e DMN dhe të programit të studimit bachelor në MN. Studentët janë në fokus të filozofisë së KUB dhe të FDSHP, në lidhje me realizimin e objektivit kryesor që është përmirësimi i procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>(Dok. 55-Rregullore “Për parandalimin e pandemisë në veprimtarinë akademike në KUB; Dok. 3-Plani i masave të KUB, për vitin akademik 2022-2023; Dok. 52- Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative “GOOGLE APPS”, portali KUB; Dok. 74- Guida e stafit për përdorimin e platformës classroom_KUB; Dok. 96- Guida e studentit për përdorimin e platformës classroom_KUB)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ, nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i evidencave, konstaton se në KUB është ngritur dhe funksionon Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional. Strukturat përgjegjëse përdorin forma nga më të ndryshmet për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Mekanizmat e përdorura për monitorimin e aftësive të sanksionuara në Rregullore janë: vlerësimi i performancës të stafit akademik përmes pyetësorëve periodikë (2 herë në vit), CV e përditësuara të stafit akademik; hartimit të raporteve të vlerësimit të pyetësorëve të njësisë bazë dhe më pas nga Dekanati, të cilët i përcillen institucionit për tu analizuar në Senatin akademik të KUB. Angazhimi i degës mësimore lidhet me matjen e performancës së mësimdhënies, sipas një procesi që ka në bazë vlerësimin e studentëve mbi performancën e lektorëve, i cili maksimizon vërtetësinë e të dhënave apo gjetjeve. Rezultatet e anketimit publikohen nga NJSBC në faqen elektronike të KUB. Gjithashtu KUB angazhon në këtë drejtim dhe agjensi të pavarura të jashtme IQE (Instituti për Cilësi në Arsim) për hartimin dhe kryerjen e pyetësorëve dhe raporteve analitike për studentët dhe stafin akademik në KUB dhe Departamentin e MN. Mbështetur në rregulloren e marrëdhënieve të punës me drejtuesit e njësive kryesore realizohet dhe vlerësimi i performancës së stafit akademik</p>




	<p>sipas raporteve analitike të vetë njësive të institucionit dhe atyre të pavarura të angazhuara në këtë proces.</p> <p><i>(Dok. 46-Raporti i NJSBC për vitin akademik 2022-2023; Dok. 50.3-Raporti i IQE për stafin akademik, 2021 Dok. 50.4—Raporti i IQE për studentët, 2021; Dok. 65.1-Vlerësimi i performacës, staf i personalizuar; Dok. 28-Raporti vjetor i veprimtarisë akademike dhe financiate të KUB 2021-2022; Dok. 69-Raporti vjetor i punës kërkimore shkencore dhe projektet)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Për matjen e cilësisë, përveç instrumenteve të parashikuar e përdoruar nga ana institucionit, vend dhe rol të rëndësishëm luajnë dhe studentët, vlerësim që matet në lidhje me instrumentet që ky institucion dhe agjensi të pavarura përdorin si: Pyetësorë dhe vlerësime të studentëve; Fokus grupe me studentët; raporte vlerësimi i studentëve lidhur me pedagogët për programin e studimit; i pedagogëve për studentët dhe kushtet e punës; i anketimeve të studentëve në këtë program studimi në lidhje me programet ekstrakurikulare etj. Përmes këtij roli synohet përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, që kryhet në fund të çdo semestri ore para provimeve në mënyrë periodike përmes plotësimit të pyetësorëve të NJSBC dhe agjencive të pavarura (fizikë dhe elektronikë), por dhe në të drejtën e tyre për ankim. Të gjitha këto instrumente i referohen bazës ligjore si Rregullores së KUB-it; Rregulloren e FDSHP; dhe Rregulloren e programit mësimor Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare, si dhe Rregulloren e NJSBC.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe në kontaktet që realizoi me grupe të ndryshme sipas agjendës u njoh me këto dokumente: vlerësimin e brendshëm, të hartuara në bazë kriteresh si: vetë-analizën; treguesit e cilësisë; vlerësimin e pedagogëve nga ana e studentëve; vlerësimin e studentëve, vlerësimin e programeve mësimore, kurrikulës së programeve të disiplinave; vlerësimin e pjesëmarrjes në veprimtarinë kërkimore; vlerësimin në zhvillimin e aktiviteteve kombëtare/rajonale, mënyrën e hartimit të pyetësorëve studentorë dhe analizën e të dhënave të marra prej tyre në funksion të vlerësimit e cilësisë së mësimdhënies, nivelit të stafit akademik në këtë program studimit. Këtij procesi vlerësimi i bashkëngjiten dhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm, në lidhje me vlerësimin e punës dhe realizimin e objektivave, mangësitë dhe vështirësitë e hasura, por edhe aspektet sugjeruese në lidhje me programin e studimit BMN.</p>







	<p><i>(Dok. 116- Tabela 24-Të dhëna për anëtarët e NJSBC; Dok. 5-Rregullore e njësisë kryesore FDSHP, neni 16; Dok. 46-Raporti i NJSBC për vitin akademik 2022-2023; Dok. 64-Rregullore për zhvillimin e provimeve)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Një nga dokumentet bazë dhe të rëndësishëm që prodhohen nga mekanizmat e sigurimit të cilësisë, është raporti i veprimtarisë mësimore-kërkimore të njësive bazë, i cili hartohet dhe merret në analizë në fund të vitit akademik, për t'u integruar më tej në raportet në nivel njësie kryesore. Vend të rëndësishëm në të zënë veç të tjerash dhe raportet e Zyrës së Kurikulave dhe NJSBC-së lidhur me pyetësorët e studentëve. Nga vizita e GVJ në institucion dhe nga dokumentacioni i paraqitur evidentohet se Institucioni ka planifikuar dhe organizuar vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, duke angazhuar dhe studentët dhe të gjitha strukturat përgjegjëse në këtë drejtim. Këto struktura në lidhje me monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, në KUB, paraqesin dhe bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të pyetësorit të kryer për çdo semestër akademik. Të dhënat e marra prej tyre i vihen në dispozicion strukturave vendimmarrëse të fakultetit, dhe të gjithë anëtarëve në mënyrë individuale të stafit akademik në programin e studimit përkatës.</p> <p><i>(Dok. 9-Rregullore e Zyrës së Kurikulave, neni 6; Dok. 46-Rregullore e NJSBC për vitin akademik 2022-2023; Dok. 59.3- Raporti i IQE për stafin akademik 2021; Dok. 59-4-Raporti i IQE për student, 2021)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton se në KUB ndërmerren politika për sigurimin e cilësisë, është ngritur dhe funksionon sistemi i menaxhimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe në mënyrë të pavarur përmes agjensive të pavarura; kryhen herë pas here veprimtari monitoruese, vlerësuese dhe përmirësuese. Në politikat e ndjekura për sigurimin e cilësisë si proces përfshihen: rishikimi, përditësimi i parimeve, të standardeve, të treguesve, përmirësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë, të procedurave të vlerësimit, përditësimin dhe përmirësimin e udhëzimeve dhe të instrumenteve të monitorimit dhe të vlerësimit, anketimi. Rezultatet e marra për stafin akademik të fakultetit apo njësisë bazë i bëhen të njohura çdo njërit prej tyre (personalisht) me anë të postës elektronike.</p> <p><i>(Dok. 82-Revista shkencore e studimeve profesionale KUB 2023; Dok. 28-Raporti vjetor i veprimtarisë akademike dhe financiare të KUB 2021-2022; Dok. 50.2-Format pyetësori i studentëve IQE; Dok. 101- Program trajnimi ISAB</i></p>

	<b>SKK/SNK&amp; Certifikatë; Dok. 22- Raporti i përfitueshmërisë të KUB-it nga marrëveshjet e nënshkruara me partnerë për Programe e Projekte në kuadër të Erasmus +)</b>			
<b>Konkluzione</b>	<p>Mështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimin në realitet, rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- KUB-i, ka në fokus të punës së tij zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të të nxënit dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme.</li> <li>- KUB ka ngritur Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik, për monitorimin e aftësive të sanksionuara në Rregullore përmes pyetësorëve të performancës të stafit akademik e studentëve, CV-ve të përditësuara të stafit akademik dhe pyetësorët e realizuar nga agjensi të pavarura si IQE.</li> <li>- Institucioni ka planifikuar dhe organizuar vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, duke angazhuar dhe studentët dhe të gjitha strukturat përgjegjëse në lidhje me monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, në KUB, paraqesin dhe bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të pyetësorit të kryer për çdo semestër akademik. (pra dy herë në vit)</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me	Mbështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton se KUB në zbatim të detyrimeve ligjore që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, në dokumentet e tij zyrtare Statut etj., ka përcaktuar qartë strukturat dhe funksionet e tyre, që mbulojnë sigurimin e cilësisë. Në KUB janë ngritur struktura të sigurimit të cilësisë, por është hartuar dhe një politikë të qartë KUB-ja lidhur me procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron,




<p>aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>mbështetur në rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, vendimet për komisionet për vlerësimin e brendshëm të cilësisë. NjBSC në nivel institucioni ka mision: NjBSC synon planifikimin e përmirësimit të vazhdueshëm të KUB dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. Kjo strukturë në rang institucioni harton strategji dhe ndërton politika dhe procedura për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për programet e studimit që ofrohen në të. NJSBC e institucionit kryen funksione që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe garantimin e standardeve të cilësisë të Fakulteteve dhe programeve të studimit; monitoron dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore në programin e studimit bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare.</p> <p><i>(Dok. 20-Organigrana e KUB &amp; Vendimi i Senatit Akademik; Dok. 116-Tabela 24-Të dhëna për anëtarët e NJSBC; Dok. 1-Statuti i KUB, neni 81, 82; Dok. 4-Rregullore e KUB, neni 112; Dok. 14-Rregullore e zyrës së NJSBC, neni 2)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ, nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i evidencave, konstaton se KUB e ka tashmë të ngritur dhe funksional Sistemin e tij të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC). Si strukturë përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit është NjBSC-ja në nivel institucional që ka si funksion: Mbështetjen dhe ofrimin e ekspertizës me çdo fakultetet dhe departament për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë mbështetet në garantimin e pjesëmarrjes së personelit të personelit akademik dhe studentëve në procesin e vlerësimit dhe në përfitimin prej ekspertizës së jashtme për sigurimin e cilësisë. NjBSC në nivel institucional, si dhe Raportet vlerësuese të agjensive të pavarura të jashtme, konsiderohet e lidhur me funksione të tjera si zhvillimi i personelit dhe mbledhja/analiza e të dhënave institucionale, garanton njohjen dhe përfshirjen që detyrimet të njihen dhe përfshihen nga IAL, monitoron, ofron udhëzime, mbledh informacione, evidenton probleme, administron, organizon dhe përgatit vizitat e vlerësimit të jashtëm, përpunon pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë sipas niveleve të programeve të studimit, lehtëson vendosjen e një klime të favorshme duke vënë në qendër studentin, për një arsim cilësor, rritje të nivelit akademik të stafit, përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve logjistike gjatë procesit të</p>

	<p>mësimdhënies dhe mësimnxënies, evidenton treguesit e cilësisë së institucionit për aktorët e brendshëm e të jashtëm, mbështetur në legjislacionin shqiptar. Zgjidhjet e propozuara nga NJBSC-ja mbi problematikat e evidentuara, në varësi të nivelit të problemit, përmes Rektorit, mund t'i kalojnë për shqyrtim dhe miratim Senatit Akademik.</p> <p><i>(Dok. 1-Statuti i Kub, neni 81, 82; Dok.4- Rregullore e KUB, neni 112; Dok. 14-Rregullore e Zyrës së NJSBC, neni 2; Dok. 50.1- Raporti i IQE për stafin akademik, 2021; Dok. 50.2- Raporti i IQE për studentët 2021)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përdor instrumentet e duhura përmes së cilave vlerëson në mënyrë periodike standardet e cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. KUB-i e realizon sigurimin e cilësisë nëpërmjet procesit të sigurimit të brendshëm NJSBC-ja e të jashtëm të cilësisë ASCAL, ku përfshihen studentë dhe ekspertë të brendshëm dhe ekspertë të jashtëm në këto procese përmes adoptimit të politikave dhe standardeve për sigurimin e cilësisë. Nga vizita e GVJ në institucion dhe nga dokumentacioni i paraqitur evidentohet se institucioni ka planifikuar dhe organizuar vlerësimin e brendshëm të cilësisë të programeve të studimit, si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. Për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, programet e studimit i nënshtrohen procesit të akreditimit, në mënyrë periodike në bashkëpunim me ASCAL. Akreditimi i parë institucional i KUB është bërë me Urdhër të MASH, Nr. 557, datë 16.11.2012, “Për akreditimin institucional të Akademisë Profesionale të Biznesit”, dhe akreditimi periodik, me Vendim të BA Nr. 100 datë 10.11.2017 “Për Akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Akademia Profesionale e Biznesit” sot Kolegji i Universitar i Biznesit, si dhe është bërë akreditimi i pjesëshëm institucional, për shkak të hapjes së Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale, me urdhër të MASR Nr. 139 datë 23.03.2018 “Për hapjen e njësisë kryesore “ Bazuar në ligjin nr 80/2015 “Për Arsimit të Lartë e Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH” dhe misionin e tij. Programi i studimit BMN, në vitin 2022-2023 i është nënshtruar për herë të parë procesit të akreditimit (procesin e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit).</p> <p><i>(Dok. 46.2-Formati pyetësor i stafit të KUB; Dok. 46.3-Formati pyetësor i studentëve të KUB; Dok. 46-Raporti i NJSBC për vitin akademik 2022-2023Dok. 75-Plani i aktiviteteve për përmirësim të rezultateve të pyetësorëve në kuadër të përmirësimit të standardeve të cilësisë në KUB;</i></p>

	<p><b>Dok. 50.1-Raporti i IQE-së për staf akademik 2021; Dok. 50.2-Raporti i IQE për studentët, 2021)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në KUB ndërmerren politika për sigurimin e cilësisë, është ngritur dhe funksionon sistemi i menaxhimit dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional; kryhen herë pas herë veprimtari monitoruese, vlerësuese dhe përmirësuese. Në çdo fund semestri NJSBC-ja organizon pyetësorë për studentët mbi stafin akademik. Në politikat e ndjekura për sigurimin e cilësisë si proces përfshihen: rishikimin, përditësimin e parimeve, të standardeve, të treguesve, përmirësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë, të procedurave të vlerësimit, përditësimi dhe përmirësimi e udhëzimeve dhe të instrumenteve të monitorimit dhe të vlerësimit, mbështetur në sistemin dhe garantimin e transparencës.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përgatit raporte periodike (dy në vit akademik) të vlerësimit dhe performancës, të cilët i propozohen Senatit Akademik për miratim; NJSBC-ja realizon Raportin e vlerësimit dhe performancës për çdo vit akademik; NJSBC monitoron dhe vlerëson procedurat dhe standardet e fakulteteve dhe njësive të tjera të institucionit, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet në bazë të treguesve të cilësisë, në bazë të kriterëve dhe standardeve të paracaktuara në Kodin e Cilësisë dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore;</p> <p>KUB dhe FDSHP analizon arritjet dhe dobësitë përmes analizave të kryera, rezultatet e të cilave ruhen dhe arkivohen për programet e studimit që ky fakultet ofron;</p> <p><b>(Dok. 46.3-Format pyetësori i studentëve KUB)</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Mbështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- KUB në zbatim të detyrimeve ligjore që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, në dokumentet e tij zyrtare Statut etj., ka përcaktuar qartë strukturat dhe funksionet e tyre, që mbulojnë sigurimin e cilësisë dhe ka hartuar një politikë të qartë mbi procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron.</li> <li>- NJSBC në nivel institucional bashkëpunon dhe me njësi të tjera në universitet në funksion të zhvillimit të personelit akademik, mbledhjes/analizës së të dhënave institucionale, garanton njohjen dhe përfshirjen që detyrimet të njihen dhe përfshihen nga IAL, monitoron, ofron udhëzime, mbledh</li> </ul>

	<i>informacione, evidenton probleme, administrojnë, organizojnë dhe përgatit vizitat e vlerësimit të jashtëm, përpunon pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë sipas niveleve të programeve të studimit, lehtëson vendosjen e një klime të favorshme duke vënë në qendër studentin, për një arsim cilësor, evidenton treguesit e cilësisë së institucionit për aktorët e brendshëm e të jashtëm, mbështetur në legjislacionin shqiptar.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se programet e studimit që ofrohen nga departamenti, rishikohen në nivel të brendshëm të kësaj njësie, për t'i përshtatur ato me nevojat specifike të këtij program studimi dhe me nevojat e tregut të punës në mënyrë të herëpashershme. GVJ konstaton se KUB ka përcaktuar metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve. Syllabus-et rishikohen në fillim të vitit akademik, në nivel departamenti, nga pedagogët përkatës. Bashkë me syllabus-et, nëse gjykohet e nevojshme mund të rishikohet edhe kurríkula për programin e 20 % të tij. Ky informacion dokumentohet dhe i dërgohet dekanatit për miratim dhe më pas Rektoratit, Senatit Akademik i cili ia kalon për miratim Bordit të Administrimit. Pas rishikimit të këtij të fundit (miraton e rikthen) për ta përcjellë për miratim final në MAS. Sistemi i sigurimit të cilësisë, si proces i brendshëm në KUB përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese për të cilën ofrohen strukturat e saj si NjBSC dhe realizohet nëpërmjet monitorimeve të përvitshme dhe publikimit të raporteve të analizës mësimore. Sipas periudhave kohore të akreditimit kryhen dhe raportet e vetëvlerësimit të GVB institucionale në funksion të proceseve të akreditimit nga ASCAL. Lektorët në mënyrë të periodike dorëzojnë në njësinë bazë dhe raportet e veprimtarisë së tyre kërkimore shkencore. KUB përdor mekanizma e procese të dokumentuara, për</p>

	<p>shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve sipas rregullores së NJSBC. Kjo e fundit në bashkëpunim me FDSHP hartojnë standardet në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MAS, të cilat përdoren nga departamenti për kryerjen e vlerësimit të programit të studimit. Programet e studimit në Fakultetin e DSHP synojnë të ofrojnë kurrikula bashkëkohore në kuadër të përfitimit nga ana e studentëve të një niveli sa më të mirë akademik dhe te kompetencave të gjëra në përputhje koherente me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit BMN nuk i është nënshtruar më parë një procesi akreditimi.</p> <p><i>(Dok. 46-Raporti i NJSBC-së për vitin akademik 2022-2023; Dok. 32. 11-Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit; Dok. 31-Raporti vjetor i veprimtarive Departamenti i MN 2022-2023)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e analizave vjetore në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe raporti i NJSBC (të matura në raport sasior dhe cilësor) paraqesin përveç rezultateve të pritshme, edhe adresime të mangësive të ndryshme për përmirësimin e cilësisë. Raportet gjenden të publikuara dhe në faqen zyrtare të KUB.</p> <p>Si një element shumë i rëndësishëm i përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, kryhet dhe vlerësimi i performancës së personelit akademik. NJSBC-ja realizon për çdo vit akademik Raportin e Vlerësimit të Brendshëm i cili paraqet një studim të funksionimit institucional të KUB-it dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik. Raporti hartohet duke u bazuar në këto fusha të vlerësimit: Organizimi dhe Menaxhimi; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.</p> <p>Në evidencat e paraqitura në këtë raport vlerësimi gjykohet përmbushja e standardeve të cilësisë e veprimtarive akademike dhe mësimore, analizimi i nevojave dhe vendosja e synimeve për zhvillimin e cilësisë në Fakultetin e DSHP dhe Departamentin e MN. Departamenti realizon analiza vlerësuese, krahasuese në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit si dhe për programin e ofruar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, i cili është në vitin e tretë të hapjes së tij. Gjithashtu NJSBC-ja periodikisht kryen propozime në lidhje me përmirësimin e aspekteve administrative dhe akademike si në informimin e studentëve mbi: praktikat mësimore dhe përmbajtjen e udhëzuesve në lidhje me to; mbi temat orientuese të diplomave, pyetje për</p>

	<p>diplomën (provim formues);unifikimin e syllabuseve në mbështetje të kërkesave dhe udhëzimeve të IAL etj.</p> <p><i>(Dok. 115-Vendimi i SA për miratimin e planit të punës për realizimin e rekomandimeve të IQE, 2021; Dok. 46- Raporti i NJSBC-së për vitin akademik 2022-2023; Dok. 46.2-Formati pyetësor i stafit të KUB; Dok. 46.3-Formati pyetësor i studentëve të KUB)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, teste lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në teste ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta. Në morinë e metodave për procesin e vlerësimit si: vlerësim cilësor i mësimdhënies, metodologjisë së përdorur të mësimdhënies, kurrikulës, rezultateve të të nxëniet; testet etj. KUB-i përfshin të dhënat e raporteve semestrale, siç janë përqindjet e kalueshmërisë, nota mesatare apo realizimi i objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit. Gjithashtu pjesë të këtyre metodave të vlerësimit lidhen me vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës, syllabuse-ve, provimeve. Strukturat e SBSC janë NJBSC-ja në nivel institucional dhe IQE-ja agjenci e jashtme e pavarur. Rol të rëndësishëm luan dhe vlerësimi i performancës së stafit të brendshëm e të jashtëm akademik në programin e studimit, veprimtaria e të cilët kontrollohet përmes: plotësimit në mënyrë periodike të CV-së dhe dosjeve e tyre të vetëvlerësimit si në njësinë bazë ashtu dhe te Zyra e Burimeve Njerëzore. KUB, FDSHP dhe DMN në mënyrë periodike realizojnë monitorimin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së praktikave, leksioneve të hapura etj., në funksion të mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>(Dok. 46- Raporti i NJSBC-së për vitin akademik 2022-2023)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik,</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni, nëpërmjet NJSBC-së përdor metoda të tërthorta vlerësimi si: Pyetësorë të ndryshëm dhe vlerësime të studentëve sipas formateve të përcaktuara për instrumentet e Cilësisë që përdoren në KUB dhe Raporti vlerësimit të aktivitetit shkencor nga vetë stafi akademik. NJSBC-ja dhe IQE-ja zhvillojnë pyetësorë me studentët, duke synuar anonimatin me qëllim vlerësimin e cilësisë të veprimtarisë mësimore dhe të studentëve. Pyetësorët shërbejnë për të marrë mendimin e studentëve për institucionin dhe programin përkatës të studimit BMN që ata ndjekin në funksion të përmirësimit të cilësisë. Të dhënat e përpunuara</p>



<p>ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>nga NJSBC i paraqiten DMN, FDSHP, Rektoratit për vlerësim dhe analizë të mëtejshme.</p> <p>Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senat, Njësinë për Sigurimin e Standardeve të Brendshme të Cilësisë të KUB-it, këshillave studentore, etj. Metoda dhe instrumentet e përdorura në vlerësimi dhe palët që përfshihen në këtë proces janë të përcaktuara në rrugë ligjore në Rregulloren NJSBC-së. Të dhënat e raportit vjetor të NJSBC-së dhe gjetjet e evidentuara përmes tij publikohen të përditësuara në faqen e website të KUB <a href="https://portal.kub.edu.al/hyrje/">https://portal.kub.edu.al/hyrje/</a></p> <p><b>(Dok. 42-Raport vjetor i veprimtarisë së ZSKK, viti akademik 2022-2023; Dok. 28-Raporti vjetor i veprimtarisë akademike dhe financiare të KUB 2021-2022; Dok. 50.2-Format pyetësori i studentëve IQE; Dok. 101-Program trajnimi për NPP&amp;Certifikatë; Dok. 60-Program trajnimi ISAB SKK/SNK&amp; Certifikatë)</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programet e studimit që ofrohen nga DMN, rishikohen në nivel të brendshëm të kësaj njësie, për t'i përshtatur ato me nevojat specifike të programe të studimit dhe me nevojat e tregut të punës. KUB ka përcaktuar metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve.</li> <li>-Sistemi i sigurimit të cilësisë, si proces i brendshëm në KUB kryhet përmes një procedure me aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese për të cilën ofrohen strukturat e saj si NJBSC-ja. Në një periudhë kohore të përcaktuar kryhen dhe raportet e vetëvlerësimit të GVB institucionale në funksion të proceseve të akreditimit nga ASCAL.</li> <li>- KUB-i përfshin të dhënat e raporteve semestrale, siç janë përqindjet e kalueshmërisë, nota mesatare apo realizimi i objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit. Pjesë e metodave të vlerësimit është dhe vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës, syllabuse-ve, provimeve, vlerësimi i performancës së stafit PPAE/PAK në programin e studimit, veprimtaria e të cilit monitorohet në mënyrë periodike. NJSBC-ja përdor dhe metoda të tërthorta vlerësimi si: Pyetësorë të ndryshëm dhe vlerësime të studentëve sipas formateve të përcaktuara dhe Instrumenteve të Cilësisë së KUB-it dhe Raportit të vetëvlerësimit nga stafi akademik.</li> </ul>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në gjithë dokumentacionin zyrtar të tij, KUB parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm e të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Një nga aktorët e rëndësishëm të brendshëm janë studentët, të cilëve ju garantohet dhe pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet, por edhe në struktura si Senati Akademik e deri te GVB, në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, NJBSC të institucionit. Në dokumentet zyrtare si Statuti dhe rregullore të tjera institucionale, KUB ka të sanksionuar një politikë dhe procedurë të brendshme të përcaktuar qartë në funksion të përmirësimin të programit të studimit. Departamenti i MN dhe Fakulteti i DSHP, mundëson dhe është i hapur për përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit, nëpërmjet takimeve, konsultave, ftesave të personaliteteve të fushës etj.</p> <p><i>Dok. 14-Rregullore e zyrës së NJSBC)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ nga baza dokumentare të paraqitura dhe nga vizita në institucion, konstatoi se përgjegjësitë dhe detyrat konkrete janë të përcaktuara në nene të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe në Rregulloren e Fakultetin e DSHP. KUB përcakton përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, por dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë realizohet përmes përfshirjes së tyre në pyetësorët e NJSBC-së, si dhe nëpërmjet ngritjes së grupit të punës së vlerësimit të brendshëm.</p>

	<i>(Dok. 14-Rregullore e zyrës së NJSBC)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Siç rezultoi nga evidencat e vëna në dispozicion për vlerësimin e jashtëm si dhe nga verifikimet nga vizita në institucion, përveç studentëve, aktorët bazë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit janë edhe anëtarët e njësisë bazë dhe njësia kryesore me strukturat e saj. Roli i tyre është i mirëpërcaktuar në aktet rregullatore institucionale në kuadër të përmirësimit të vazhduar të cilësinë në KUB. Fakulteti i DSHP ka përfaqësuesit e saj në Njësinë e Brendshme për sigurimin e Cilësisë dhe Standardeve.  <i>(Dok. 116-Tabela 24-Të dhënat për anëtarët e NJSBC)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në respekt të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale”, gjatë procedurave që kryhen nga strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë për vlerësimin e programit të studimit, respektohet integriteti akademik, etika dhe liria akademike. Në proceset ciklike të vlerësimit, aktivizimi dhe përfshirja e aktorëve të brendshëm shmang çdo lloj diskriminimi kundrejt personelit dhe studentëve. Edhe pyetësorët që kryhen me studentët në mënyrë periodike ruajnë anonimatit dhe konfidencialitetin e tyre.  <i>(Dok. 46-Raport i NJSBC për vitin akademik 2022-2023; Dok. 50.1-Raporti i IQE për staf akademik, 2021; Dok. 50.2-Raporti i IQE për studentët, 2021)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga evidentimi i bërë, rezulton që në aspektet e aktivizimit si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të aktorëve të jashtëm, kryhen dhe takime dhe me përfaqësuesit e institucioneve dhe aktorë të tjerë. Pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, janë dhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, të cilët japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.  <i>(Dok. 50-Marrëveshje bashkëpunimi KUB-IQE; Dok. 25-Marrëveshje bashkëpunimi KUB-Grant Thorton)</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstatoi se:</i>

	<p><i>-KUB parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm e të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Studentëve ju garantohet dhe pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet, por edhe në struktura si Senati Akademik e deri te GVB, në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në Bordin e Administrimit etj.</i></p> <p><i>- KUB përcakton përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, por dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</i></p> <p><i>- Përveç studentëve, aktorët bazë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit janë edhe anëtarët e njësisë bazë dhe njësia kryesore me strukturat e saj duke shmangur çdo lloj diskriminimi kundrejt personelit dhe studentëve. Pjesë e procesit të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë dhe bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, të cilët japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Vlerësojmë se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit nga KUB/FDSHP janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. KUB ka krijuar programin e transparencës e cila është dhe publike në faqen website të tij. KUB ka bërë publike raportet e përvitshme vjetore si dhe ka azhurnuar rregullisht informacione të paanshme dhe objektive, cilësore dhe sasiore të programeve të studimit, në lidhje me informimin publik të funksionimit dhe rezultatet e sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në KUB. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që kanë në fokus Sigurimin e Brendshëm të

	<p>Cilësisë për programin BMN, në mënyrë transparente, janë të publikuara në website zyrtare: <a href="https://portal.kub.edu.al/hyrje/">https://portal.kub.edu.al/hyrje/</a> dhe rrjeteve sociale që janë në funksion të FDSHP dhe DMN.</p> <p><i>(Dok.46-Raporti i NJSBC për vitin akademik 2022-2023; Link 57: <a href="https://kub.edu.al/njsbc/">https://kub.edu.al/njsbc/</a>)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë KUB-i dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimit dhe të akreditimit, i cili bëhet në përputhje me format e miratuara nga Senati Akademik i KUB. KUB garanton se informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë është i përshtatshëm për qëllimin që ka, është i arritshëm, i besueshëm dhe përcillet në një gjuhë të kuptueshme për të gjithë. Në KUB, rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, dhe gjithë informacioni që disponohet për këtë qëllim, publikohet në dokumentacionet përkatëse apo online në websitin e KUB duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale për të gjithë individët e përfshirë në këtë proces.</p> <p><i>(website: <a href="https://portal.kub.edu.al/hyrje/">https://portal.kub.edu.al/hyrje/</a>)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si dhe nga shqyrtimi i evidencave, GVJ konstaton se në fund të vitit akademik, NJSBC harton raportin vjetor, me të gjitha komponentët e rezultateve të arritura vjetore, dhe mbi bazën e së cilës bëhet një analizë e ecurisë dhe për programin e studimit bachelor në MN si dhe të programeve që ofron, me synim përmirësimin e mangësive dhe problemeve të vërejtura. Të dhënat e raportit vjetor i përcillen njësisë kryesore dhe më pas përmes tyre dhe njësisë bazë, për të reflektuar mbi arritjet dhe problematikat e nxjerra prej tij.</p> <p><i>(Dok. 46.1-Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e raportit vjetor të NJSBC-së; Dok. 75-Plani i aktiviteteve për përmbushje të rezultateve të pyetësorëve në kuadër të përmirësimit të standarteve të cilësisë në KUB)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se ekziston një vullnet i mirë nga ana e KUB në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucion i jep këtij procesi. KUB ka praktika të mira në drejtim të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përfshirjes së stafit në trajnime e projekte ndërkombëtare;</li> <li>- Bashkëpunime të cilat kanë sjellë përmirësime në hartimin e kurrikulave;</li> </ul>

	<p>- Mbështet kërkimin shkencor nga lektorët me anë të financimit të pjesëmarrjes së tyre në aktivitete shkencore; kombëtare/ndërkombëtare;</p> <p>- Institucioni mbështet kërkimin shkencor të lektorëve në KUB, dhe i vlerëson në mënyrë periodike përmes vlerësimit të performancës së përgjithshme të lektorit;</p> <p><i>(Dok. 14-Rregullore e NJSBC; Dok. 28- Raporti vjetor i veprimtarisë akademike dhe financiare të KUB, 2021-2022)</i></p> <p><b>Rekomandim:</b> Duhet bërë më shumë përpjekje për mbështetjen e kërkimit shkencor për studentët përmes organizimit të konferencave studentore, workshop, start-up etj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga dokumentacioni i paraqitur GVJ konstaton se KUB kryen një komunikim të vazhdueshëm me stafin akademik dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e programeve të studimit. Në mënyrë periodike janë organizuar disa veprimtari me personelin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. <i>(Raporti i IQE-së për vitin akademik 2022-2023)</i> Me GVB-të e njëjste të KUB-së organizohen trajnime, me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës për informimin e këtyre grupeve të vlerësimit, në lidhje me rëndësinë e procesit të vlerësimit dhe akreditimit të programeve të studimit.</p> <p>Institucioni ka publikuar të gjithë informacionin që lidhet me procesin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në udhëzues, faqen e website të KUB, me qëllim rritjen e transparencës për këtë proces të rëndësishëm, të universitetit, dhe për të ndërgjegjësuar studentët dhe personelin akademik për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit afatgjatë të saj në programin e studimit.</p> <p><i>(Dok. 2-Plani strategjik i zhvillimit të KUB 2021-2022; Dok. 50.1-Raporti i IQE për staf akademik 2021; Dok. 50.2-Raporti i IQE për studentët, 2021)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>-Vlerësojmë se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programet e studimit nga KUB janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p>- GVJ konstaton se në fund të vitit akademik, NJSBC harton raportin vjetor, me të gjitha komponentët e rezultateve të arritura vjetore, dhe mbi bazën e së cilës bëhet një analizë e</p>

	<p><i>ecurisë së tij dhe programeve që ofron, me synim përmirësimin e mangësive dhe problemeve të vërejtura.</i></p> <p><i>- KUB kryen një komunikim të vazhdueshëm me stafin akademik dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e programeve të studimit pwrmes organizimit të veprimtarivë me personelin akademik.</i></p> <p><i>- Me GVB-të e njërive të KUB-së organizohen trajnime, me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës për informimin e këtyre grupeve të vlerësimit, në lidhje me rëndësinë e procesit të vlerësimit dhe akreditimit të programeve të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë bachelor në  
“Marrëdhënie Ndërkombëtare”, ofruar nga Kolegji Universitar “I Biznesit”**

**Pika të forta dhe afirmime:**

1. Kolegji Universitar "I Biznesit" ka hartuar vizione të qarta për zhvillimin e programit mësimor bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare.
2. Kolegji Universitar "I Biznesit" ka një kuadër të plotë ligjor dhe rregullator, që mundëson disiplinimin e procesit mësimor e kërkimor – shkencor.
3. Programi mbulohet nga staf i kualifikuar akademik me tituj dhe grada që garanton cilësi në mësimdhënie.
4. Institucioni ka rreth 182 marrëveshje bashkëpunimi duke mundësuar bashkëpunim me institucione, kompani e palë të treta, në funksion të realizimit të programit të studimit.
5. Strukturat institucionale sigurojnë standartet e cilësisë dhe garantojnë një proces mësimor transparent për studentët dhe subjektet e tjera të interesuara;
6. Institucioni ka një praktikë shumë të mirë të ruajtjes së dokumentacionit sipas standardeve dhe kërkesave ligjore dhe nënligjore në fuqi;

**Pika të dobëta**

1. Pasaktësi në pikët e krediteve në kategorinë C -Lëndë ndërdisiplinore/integruese, (dy kredite më pak). (Fusha 2, Standardi II.1, Kriteri 3 dhe konkluzionet)
2. Institucioni mbështetet kryesisht në tarifat e shkollimit të studentëve dhe është vulnerabël ndaj trendit në ulje të numrit të studentëve për këtë program studimi;
3. Programi i studimit ka numër të ulët të studentëve.

**Rekomandime:**

1. Rekomandohet që institucioni pas akreditimit të programit të studimit të konsiderojë plotësimin me 2 kredite të kategorisë C -Lëndë ndërdisiplinore/integruese të kurrikulës





së programit. Ky rekomandim mbështetet në faktin e përputhshmërisë së plotë me bazën ligjiore në fuqi. (Fusha 2, Standardi II.1, Kriteri 3 dhe konkluzionet)

2. Institucioni të investojë më shumë në kërkimin shkencor dhe projekte për të krijuar një larmishmëri burimesh financimi.
3. Institucioni të ndërmarrë politika proaktive për të rritur numrin e studentëve në këtë program studimin në vitet në vazhdim.
4. Departamenti ka hartuar një studim të tregut të punës për hapjen e këtij programi studimi. Rekomandohet që për të vlerësuar më mirë tendencën e numrit të studentëve, studimi i kryer duhet shtrirë për çdo vit akademik në lidhje me vazhdimësinë e tij.

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "International Relations", provided by the Higher Education Institution University College of "Business"**

**Strengths and affirmations:**

1. College University of "Business" has drawn up clear visions for the development of the Bachelor's program in "International relations".
2. College University "of Business" has a complete legal and regulatory framework, which enables the realization of teaching and research-scientific process.
3. The program is covered by qualified academic staff with degrees and qualifications that guarantee quality in teaching.
4. The institution has about 182 cooperation agreements enabling cooperation with institutions, companies and third parties, in order to realize the study program.
5. Institutional structures ensure quality standards and guarantee a transparent learning process for students and the interested subjects.
6. Institution has a very good practice of preserving documentation according to the standards and legal and by-law requirements in force.

**Weaknesses:**


1. Inaccuracy in credit points in category C - Interdisciplinary/integrative, (two credits less). (Field 2, Standard II.1, Criterion 3 and conclusions).



2. The institution relies mainly on student tuition fees and is vulnerable to the downward trend in the number of students for this study program.
3. The study program has a low number of students.

**Recommendations:**

1. It is recommended that the institution after the accreditation of the program, can consider the supplementing with 2 credits in category C - Interdisciplinary/integrative of the curriculum of the study program. This recommendation is based on the full compliance with the legal framework into force.
2. The institution should invest more in scientific research and projects to create a diversity of funding sources.
3. The institution should undertake proactive policies to increase the number of students in the coming years.
4. The department has compiled a study of the labor market for the opening of this study program. It is recommended that in order to better assess the trend of the number of students; the conducted study should be extended for each academic year in relation to its continuity.



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>			X	
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X